FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 170

Tiranë – E martë, 20 dhjetor 2022

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 75/2022, datë 17.11.2022	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 13, datë 5.10.2022, "Për miratimin e tekstit të amendimit të katërt në marrëveshjen për prodhimin dhe furnizimin nga dhe ndërmjet *Pfizer Export B.V.* dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik", miratuar me aktin normativ nr. 3, datë 18.1.2021, të ndryshuar.....	21603
Ligj nr. 76/2022, datë 17.11.2022	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 14, datë 5.10.2022, "Për marrjen e masave të veçanta gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike".....	21603
Ligj nr. 80/2022, datë 24.11.2022	Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëfinancimin e projektit madhor në albanologji "Enciklopedia shqiptare".....	21603
Dekret i Presidentit nr. 13880, datë 19.12.2022	Për shpallje ligji.....	21606
Ligj nr. 81/2022, datë 24.11.2022	Për një ndryshim në ligjin nr. 61/2012, "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.....	21606
Dekret i Presidentit nr. 13882, datë 19.12.2022	Për shpallje ligji.....	21612
Ligj nr. 82/2022, datë 24.11.2022	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92/2014, "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.....	21612
Dekret i Presidentit nr. 13881, datë 19.12.2022	Për shpallje ligji.....	21614
Dekret i Presidentit nr. 13879, datë 13.12.2022	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	21614

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 799, datë 12.12.2022	Për një shtesë në vendimin nr. 87, datë 9.2.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit/riparimit të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat), në Bashkinë Mirditë"	21614
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 286, datë 5.12.2022	Për miratimin e Programit Kombëtar të Kontrollit të Cilësisë së Sigurisë së Aviacionit Civil.....	21615
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 590, datë 12.12.2022	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Hungarisë.	21644
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 591, datë 12.12.2022	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Italisë.....	21645
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 576, datë 2.12.2022	Për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura për shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Elbasan sh.a.....	21647
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 578, datë 2.12.2022	Për licencimin e shoqërisë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Korçë sh.a.....	21650
Vendim i Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 579, datë 2.12.2022	Për licencimin për herë të parë të shoqërisë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Lezhë sh.a.....	21652
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 603/10, datë 15.12.2022	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ujësjellësi i fshatit Duhanas, fshati Lapardha 1, Otllak dhe Orizaj", Berat.....	21654
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 681/7, datë 14.12.2022	Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti "Rikonstruksioni i linjës 35 kV Korçë–Bilisht".....	21654
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 837/4, datë 14.12.2022	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtim argjinature mbrojtëse nga lumi 'Shkumbin' në Krastë, në kuadër të projektit 'Lungo Fiume', Elbasan".....	21660
Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës nr. 143, datë 20.10.2022	Me objekt: 1. Prishjen e shoqërisë "Dyrrahu Konstruksion" sh.p.k., NIPT L72215501C. 2. Likuidimin e shoqërisë "Dyrrahu Konstruksion" sh.p.k., NIPT L72215501C. 3. Urdhërimin e QKB-së për çregjistrimin e shoqërisë "Dyrrahu Konstruksion" sh.p.k., me NIPT L72215501C.....	21662

Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër nr. 642 (3965), datë 7.10.2022 | Për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetases Valbona Jaliq..... 21667

Kërkesë për shpalljen e zhdukjes së shtetasit Sokol Prendi..... 21667

LIGJ
Nr. 75/2022

PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR. 13, DATË 5.10.2022, "PËR MIRATIMIN E TEKSTIT TË AMENDIMIT TË KATËRT NË MARRËVESHJEN PËR PRODHIMIN DHE FURNIZIMIN NGA DHE NDËRMJET *PFIZER EXPORT B.V.* DHE MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE TË SHQIPËRISË, MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN DHE INSTITUTIT TË SHËNDETIT PUBLIK", MIRATUAR ME AKTIN NORMATIV NR. 3, DATË 18.1.2021, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 13, datë 5.10.2022, "Për miratimin e tekstit të amendimit të katërt në marrëveshjen për prodhimin dhe furnizimin nga dhe ndërmjet *Pfizer Export B.V.* dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik", miratuar me aktin normativ nr. 3, datë 18.1.2021, të ndryshuar.

Miratuar më datë 17.11.2022.

KRYETARE
Lindita Nikolla

LIGJ
Nr. 76/2022

PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR. 14, DATË 5.10.2022, "PËR MARRJEN E MASAVE TË VEÇANTA GJATË KOHËZGJATJES SË GJENDJES SË EMERGJENCËS NË FURNIZIMIN ME ENERGJI ELEKTRIKE"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 14, datë 5.10.2022, "Për marrjen e masave të veçanta gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike".

Miratuar më datë 17.11.2022.

KRYETARE
Lindita Nikolla

LIGJ
Nr. 80/2022

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR BASHKËFINANCIMIN E PROJEKTIT MADHOR NË ALBANOLOGJI "ENCIKLOPEDIA SHQIPTARE"

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëfinancimin e projektit madhor në albanologji "Enciklopedia shqiptare" sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar më datë 24.11.2022.

Shpallur me dekretin nr. 13880, datë 19.12.2022, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR BASHKËFINANCIMIN E PROJEKTIT MADHOR NË ALBANOLOGJI
ENCIKLOPEDIA SHQIPTARE

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, të cilat më poshtë do të quhen *Palë*,

Të nxitura nga përgjegjësia për promovimin e përbashkët të identitetit kombëtar si trashëgimi e pandashme e popullit shqiptar;

Të shtyra nga vullneti për nxitjen e bashkëpunimit të ndërsjellë në shkencën e albanologjisë;

Në funksion të realizimit të marrëveshjes së arritur ndërmjet Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave e Arteve të Kosovës për hartimin e projektit madhor *Enciklopedia shqiptare*;

Duke respektuar legjislacionin e brendshëm në fuqi ndërmjet Palëve,

Bien dakord si vijon:

Neni 1
Qëllimi dhe objekti

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje bashkëpunimi është financimi i përbashkët i projektit madhor në albanologji *Enciklopedia shqiptare*, vepër themelore me karakter njësues dhe promovues.

Enciklopedia shqiptare, objekt i kësaj marrëveshjeje, paraqet në mënyrë të gjithanshme dhe përpjesëtimore, mbështetur në kriterin e rëndësisë objektive historike: personalitete, ngjarje e zhvillime politike, historike, kulturore, sociale e ushtarake, të shënjuara nga gjithë hapësira kombëtare shqiptare; nga ngulmimet e hershme historike dhe nga diaspora; si dhe dukuri e personalitete të huaja me kontribut për promovimin ndërkombëtar të identitetit kombëtar, të gjuhës, kulturës, trashëgimisë dhe historisë kombëtare; si dhe për mbrojtjen e çështjes shqiptare në arenën ndërkombëtare.

Projekti përfshin të gjitha proceset e hartimit të veprës, prej përgatitjes deri tek shtypshkrimi.

Enciklopedia shqiptare hartohet në 10 vëllime, me një numër mesatar prej 400 faqe për vëllim.

Neni 2
Organizimi dhe zbatimi

Palët nënshkruese ngarkojnë për zbatimin e këtij projekti Akademinë e Shkencave të Shqipërisë dhe Akademinë e Shkencave e Arteve të Kosovës (këtu e më tej të cilësuara si *Palë zbatuese*). Për realizimin e Projektit *Palët zbatuese* bashkëpunojnë me institucionet kërkimore-shkencore publike dhe/ose me studiues të tyre. Ato kanë të drejtë të ftojnë për bashkëpunim institucione jopublike e studiues të pavarur në vendet e tyre dhe nga Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe diaspora.

Për zbatimin e kësaj marrëveshjeje *Palët zbatuese* ngrenë bashkërisht dhe me mirëkuptim redaksinë qendrore të *Enciklopedisë shqiptare*, dy redaksi vendore dhe redaksitë e fushave. Redaksia qendrore dhe dy redaksitë përkatëse bëjnë ndarjen e përgjegjësive për paraqitjen enciklopedike të botës shqiptare në Maqedoninë e Veriut, në Mal të Zi dhe vende të tjera. Redaksia qendrore funksionon në Tiranë, dhe mbledhjet zhvillohen në Tiranë dhe në Prishtinë.

Për hierarkinë, ndarjen e detyrave, drejtimin dhe organizimin e punës nga redaksitë, *Palët zbatuese*

veprojnë sipas një Rregullore të përbashkët, e cila miratohet prej tyre jo më vonë se data 30 tetor 2022 (këtu e tutje referuar si "Rregullore").

Neni 3
Modalitetet e financimit

Financimi i projektit bëhet nga buxheti i të dyja Palëve nënshkruese. Shuma e vënë në dispozicion për *Projektin* parashihet në Buxhetet 2023 të Palëve nënshkruese, përfshirë vitet tjera vijuese buxhetore, deri në përfundim të projektit.

Administrimi i fondeve të vëna në dispozicion për Projektin bëhet sipas një Protokolli të veçantë i nënshkruar nga Palët nënshkruese të kësaj Marrëveshje apo të autorizuarit e tyre, jo më vonë se me datën 30 tetor 2022. Kompensimi për personat e angazhuar nga Palët zbatuese të Marrëveshjes do jetë i barabartë.

Neni 4
Realizimi i veprës

Projekti madhor *Enciklopedia shqiptare* zbatohet brenda një periudhe 5-vjeçare, duke filluar prej datës 1 janar 2023.

Enciklopedia shqiptare konceptohet e realizohet si një vepër e hapur, e kështillueshme *online*, në plotësim të vijueshëm. Tirazhi i shtypur i saj u drejtohet bibliotekave publike të institucioneve të arsimit të lartë, institucioneve promovuese të identitetit shqiptar në botë, qendrave albanologjike, e më gjerë.

Neni 5
Raportimi dhe transparenca

Palët zbatuese si rregull raportojnë me shkrim për ecurinë e *Projektit* te *Palët nënshkruese* 1(një) herë në vit. Ato raportojnë gjithashtu jashtë periodicitetit kur u kërkohet nga *Palët nënshkruese*. *Palët zbatuese* i bëjnë të njohura njëra-tjetrës raportet që paraqesin në vendet e tyre.

Neni 6
Rishikimet

Çështjet e diskutueshme që mund të lindin midis *Palëve zbatuese* në realizimin e kësaj vepre zgjidhen me mirëkuptim.

Në rast të mosarritjes së mirëkuptimit, *Palët zbatuese* shqetësimet e tyre i paraqesin pranë *Palëve nënshkruese*.

Neni 7
Pronësia intelektuale

Vepra madhore *Enciklopedia shqiptare* dhe arkivi shkencor që krijohet gjatë punës për hartimin e veprës janë pronësi intelektuale e të dy institucioneve zbatuese të kësaj marrëveshje. Arkivi shkencor i Projektit ruhet pranë Qendrës së Botimeve Albanologjike dhe Enciklopedike dhe *Palët zbatuese* kanë të drejta të barabarta përdorimi shkencor.

Neni 8
Vazhdimësia e Projektit

Palët mund të bien dakord për financimin e përditësimit të botimeve enciklopedike me karakter kombëtar edhe pas përfundimit të veprës *Enciklopedia shqiptare*.

Neni 9
Etika në kërkim

Përgatitja e veprës, objekt i kësaj marrëveshje mbështetet në Kodin Evropian për kërkimin shkencor të miratuar nga ALLEA *(All European Academies*), në ligjin nr. 35/2016, "*Për të drejtat e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me to",* i ndryshuar, në ligjin nr. 04/L-065, datë 21.10.2011, "*Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta"* në Republikën e Kosovës, si dhe në akte të tjera ligjore dhe nënligjorë përkatëse të dy vendeve.

Neni 10
Afati

Kjo marrëveshje është e vlefshme për një periudhë 5-vjeçare (pesëvjeçare), me të drejtë zgjatje, mbështetur në propozimet e dy *Palëve zbatuese*.

Neni 11
Hyrja në fuqi dhe plotësimi i ndryshimeve

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të fundit me shkrim me anë të së cilës Palët njoftojnë njëra-tjetrën, përmes kanaleve diplomatike, për përfundimin e procedurave ligjore për hyrjen në fuqi.

Kjo marrëveshje mund të ndryshojë nëpërmjet negociatave dhe miratimit të ndërsjellë të dy *Palëve*.

Nënshkruar në _____, më ___.___._____, në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe, nga një për secilën Palë, me të njëjtën vlerë.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë	Për Qeverinë e Republikës së Kosovës

DEKRET
Nr. 13880, datë 19.12.2022

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 80/2022, "Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, për bashkëfinancimin e projektit madhor në albanologji 'Enciklopedia shqiptare'".

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

LIGJ
Nr. 81/2022

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 61/2012, "PËR AKCIZAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Shtojca nr. 1, "Mallrat e tatueshme me akcizë në Republikën e Shqipërisë", që i bashkëlidhet ligjit nr. 61/2012, "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, zëvendësohet me shtojcën nr. 1, "Mallrat e tatueshme me akcizë në Republikën e Shqipërisë", që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2023.

Miratuar në datën 24.11.2022.

Shpallur me dekretin nr. 13882, datë 19.12.2022 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj

SHTOJCA NR. 1
MALLRAT E TATUESHME ME AKCIZË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Kategoria	Kodi NK	Përshkrimi	Shkalla taksimit
I. KAFE			
C100 Kafe e papjekur	09 01 11 00 09 01 12 00	Kafe jo e pjekur e dekafeinizuar ose jo	0
C200 Kafe e pjekur	09 01 21 00 09 01 22 00	Kafe e pjekur e dekafeinizuar ose jo	60 lekë/kg
C300 Lëkura, lëvoret zëvendësuesit e kafesë	09 01 90	Lëkura dhe lëvoret e kafesë. zëvendësuesit e kafesë që përmbajnë kafe.	50 lekë/kg
C900 Ekstrakte, esenca, koncentrate kafeje dhe përgatitje prej tyre	21 01 11 00 21 01 12 92 21 01 12 98	Ekstrakte, esenca, koncentrate kafeje dhe përgatitje prej tyre (neskafe etj.).	250 lekë/kg kafe
II. BIRRË, VERË, ALKOOL DHE PIJE ALKOOLIKE			
B000 Birra	22 03	Birra nga malto me shkallë alkoolometrike ndaj volumit më të madhe se 0.5%	710 lekë/HL/shkallë alkoolometrike

W200 Vera e qetë dhe pijet e qeta të fermentuara	22 04 21 22 04 29 22 04 30 22 04 30 10 22 04 30 96 22 04 30 98 22 05 10 10 22 05 90 10 22 06 00 10 22 06 00 59 22 06 00 89	Verë e qetë dhe musht rrushi; Vermuth e verëra të tjera të përgatitura nga bimë ose substanca aromatizuese; Pije të tjera të fermentuara (p.sh. musht molle, musht dardhe, hydromel); përzierje të pijeve të fermentuara dhe përzierje të pijeve të fermentuara dhe pijeve joalkoolike të pagazuara. - nga prodhues vendas e të huaj me sasi < = 10 000 hektolitër/vit - nga prodhues vendas e të huaj me sasi > 10 000 hektolitër/vit	- 3 000 lekë/HL për verërat me forcë alkoolike deri në 12,5 gradë dhe; - 4 000 lekë/HL për verërat me forcë alkoolike mbi 12,5 gradë - 10 000 lekë/HL për verërat me forcë alkoolike deri në 12,5 gradë dhe; - 12 000 lekë/HL për verërat me forcë alkoolike mbi 12,5 gradë
W300 Vera spumante, Shampanja dhe pije të fermentuara dhe të gazuara	22 04 10 22 04 21 06 22 04 21 07 22 04 21 08 22 04 21 09 22 05 10 10 22 05 90 10 22 06 00 39 22 06 00 31 22 06 00 51 22 06 00 81	Verërat spumante, Shampanja; Verë ndryshe nga ato të nënkreut 220410, në shishe me tapa "kërpudhë" që lidhet me mbërthyes apo tela; verë e ndërtuar ndryshe me një presion të pranueshëm në sajë të dyoksidit të karbonit. Vermuth e verëra të tjera të përgatitura nga bimë ose substanca aromatizuese të një force alkoolike ndaj volumit prej 18% apo më pak.	5 200 lekë/HL
		Pije të tjera të fermentuara (p.sh. musht molle, musht dardhe, hydromel); përzierje të pijeve të fermentuara dhe përzierjet e pijeve të fermentuara dhe pijeve joalkoolike të gazuara. Cider dhe cider dardhe me permbajtje alkooli 8,5%	3120 lekë/HL
I000 Pijet alkoolike të ndërmjetme	22 04 21 85 22 04 21 86 22 04 21 87 22 04 21 88 22 04 21 89 22 04 21 90 22 04 21 91 22 04 21 93 22 04 21 94 22 04 21 95 22 04 21 96 22 04 21 97 22 04 21 98 22 04 29 85 22 04 29 86 22 04 29 87 22 04 29 88 22 04 29 89 22 04 29 90 22 04 29 91 22 04 29 93 22 04 29 94 22 04 29 95 22 04 29 96 22 04 29 97 22 04 29 98 22 05 10 10 22 05 10 90 22 05 90 10 22 05 90 90 22 06 00 10 22 06 00 39	Pijet alkoolike të ndërmjetme me një forcë alkooli mbi 15% volum por që nuk e kalon 22% volum; Sipas përcaktimeve të nenit 74 të ligjit.	5 200 lekë/HL

	22 06 00 59 22 06 00 89		
S200 Pije alkoolike (Spirituous Beverages)	22042192 22042193 22042194 22042195 22042196 22042197 22042198 22042992 22042993 22042994 22042995 22042996 22042997 22042998 22051090 22059090 22060010 22060039 22060059 22060089 22082012 22082014 22082026 22082027 22082029 22082040 22082062 22082064 22082086 22082087 22082089 22083011 22083019 22083030 22083041 22083049	Pije alkoolike; të përfituara nga distilimi i verës së rrushit apo të bërsive të rrushit, Whisky. Rum dhe të tjera pije të përfituara nga distilimi i produkteve të fermentuara nga kallami i sheqerit, Gin dhe Geneva. Vodka, likere dhe tonike, Uzo.	84 500 lekë për HL alkool anhidër
	22083061 22083069 22083071 22083079 22083082 22083088 22084011 22084031 22084039 22084051 22084091 22084099 22085011 22085019 22085091 22085099 22086011 22086019 22086091 22086099 22087010 22087090 22089011 22089019 22089033		
S300 Alkooli etilik jo i denatyruar	22071000 22089091 22089099	Alkool etilik jo i denatyruar i një force alkoolike ndaj volumit prej 80% volum apo më shumë	45 000 lekë për HL alkool anhidër

S400 Alkool etilik i denatyruar	22072000	Alkool etilik i denatyruar	0 (zero)
S400 Rakia sipas përcaktimeve të nenit 66 të ligjit	22082029	Raki	20 000 lekë për HL alkool anhidër
S500 Produkte të tjera që përmbajnë alkool etilik	Kapitujt 17 deri 22 të NK	Të gjitha produktet që kanë një Shkallë alkoolometrike efektive mbi 1,2% ndaj volumit dhe pavarësisht klasifikimit në sistemin NK, sipas nenit 64 të ligjit	45 000 lekë për HL alkool anhidër
III. DUHAN DHE NËNPRODUKTET E TIJ			
T300 Puro dhe cigarillos	24 02 10 00	Puro dhe cigarillos që përmbajnë duhan (lekë/kg)	6750 lekë/kg, në 1 janar 2022; 7000 lekë/kg, në 1 janar 2023; 7250 lekë/kg, në 1 janar 2024; 7500 lekë/kg, në 1 janar 2025; 7750 lekë/kg, në 1 janar 2026.
T200 Cigare që përmbajnë duhan	24 02 20	Cigare që përmbajnë duhan (lekë/fije cigare)	6750 lekë/1000 fije, në 1 janar 2022; 7000 lekë/1000 fije, në 1 janar 2023; 7250 lekë/1000 fije, në 1 janar 2024; 7500 lekë/1000 fije, në 1 janar 2025; 7750 leke/1000 fije, në 1 janar 2026.
T500 Puro, cigarillos dhe cigare me zëvendësues duhani	24 02 90	Puro, cigarillos dhe cigare me zëvendësues duhani (lekë/kg)	6750 lekë/kg, në 1 janar 2022; 7000 lekë/kg, në 1 janar 2023; 7250 lekë/kg, në 1 janar 2024; 7500 lekë/kg, në 1 janar 2025; 7750 lekë/kg, në 1 janar 2026.
T400 Duhan tjetër i përpunuar dhe zëvendësuesit e duhanit	24 03	Duhan tjetër i përpunuar dhe zëvendësuesit, duhan me dredhje (lekë/kg)	6750 lekë/kg, në 1 janar 2022; 7000 lekë/kg, në 1 janar 2023; 7250 lekë/kg, në 1 janar 2024; 7500 lekë/kg, në 1 janar 2025; 7750 lekë/kg, në 1 janar 2026.
		Duhan i përpunuar me gjethe duhani të kultivuara në Shqipëri (lekë/kg)	2750 lekë/kg, në 1 janar 2022; 3000 lekë/kg, në 1 janar 2023; 3250 lekë/kg, në 1 janar 2024; 3500 lekë/kg, në 1 janar 2025; 3750 lekë/kg, në 1 janar 2026.
T401 Nikotinë	2404 12	Produktet që përmbajnë nikotinë lëng (lekë/ml)	12 leke/ml në 1 janar 2022 14 leke/ml në 1 janar 2023 16 leke/ml në 1 janar 2024 18 leke/ml në 1 janar 2025 20 leke/ml në 1 janar 2026
	2404 91	Produkte duhani për përdorim oral (lekë/kg)	6750 lekë/kg, në 1 janar 2022; 7250 lekë/kg, në 1 janar 2023; 7750 lekë/kg, në 1 janar 2024; 8250 lekë/kg, në 1 janar 2025; 8750 lekë/kg, në 1 janar 2026.
T402 Duhan me ngrohje	24 04 11	Duhan me ngrohje, pa djegie (lekë/kg)	6750 lekë/kg, në 1 janar 2022; 7250 lekë/kg, në 1 janar 2023; 7750 lekë/kg, në 1 janar 2024; 8250 lekë/kg, në 1 janar 2025; 8750 lekë/kg, në 1 janar 2026
T403 Shisha, nargjile	24 03 11	Shisha, nargjile (përzierje për tymosje) (lekë/kg duhan në produkt)	6750 lekë/kg, në 1 janar 2022; 7250 lekë/kg, në 1 janar 2023; 7750 lekë/kg, në 1 janar 2024; 8250 lekë/kg, në 1 janar 2025; 8750 lekë/kg, në 1 janar 2026
		Shisha, nargjile (përzierje për tymosje) përpunuar me gjethe duhani të kultivuara në Shqipëri (lekë/kg duhan në produkt)	2750 lekë/kg, në 1 janar 2022; 3000 lekë/kg, në 1 janar 2023; 3250 lekë/kg, në 1 janar 2024; 3500 lekë/kg, në 1 janar 2025; 3750 lekë/kg, në 1 janar 2026.
IV. PRODUKTET ENERGJETIKE			
E200	1507 deri 1518	Vajrat dhe dhjamërat prej kafshëve	Sipas përcaktimeve të neneve

Vajrat vegjetale dhe shtazore të klasifikuara në krerët 1507 deri 1518të NKnëse përdoren për ngrohje apo motorë		apo vegjetale dhe produktet prej tyre	50 e 51 të ligjit
E201 Qymyri	2701	Qymyr; briketa, forma vezake dhe lëndë djegëse të ngjashme të forta të prodhuar prej qymyrit	0 lek/kg
E202 Linjiti	2702	Linjit, nëse është apo jo i aglomeruar, duke përjashtuar qelibarin e zi	0 lek/kg
E203 Koks dhe gjysmë koks	2704	Koks dhe gjysmë koks prej qymyrit, linjitit apo prej torfe, nëse është apo jo i aglomeruar; karbon i konvertuar	0 lek/kg
E204 Gaz qymyri, gaz uji, gaz prodhimi	2705	Gaz qymyri, gaz uji, gaz prodhimi dhe gazra të tjera të ngjashme, përveç gazrave të naftës dhe hidrokarbureve të tjera gazoike	0 lek/kg
E205 Katran i distiluar nga qymyri	2706	Katran i distiluar nga qymyri, nga linjiti apo nga torfa, dhe katrane të tjera minerale, nëse janë apo jo të dehidratuara apo pjesërisht të distiluara, përfshirë katranet e rindërtuara	0 lek/kg
E300 Vajra minerale	27071010 27071090 27072010 27072090 27073010 27073090 27075010 27075090	Produktet e vajrave minerale që i përkasin kodeve NK të kreut 2707	50 lekë/litri
E400	27 10 12 11	Naftë që kërkon një proces specifik përpunimi	50 lekë/litri
E410	27 10 12 41 27 19 12 45 27 10 12 49	Vajra të lehta (benzinë dhe benzol) Benzinë dhe benzol pa plumb, me përmbajtje plumbi jo më tepër se 0,013 gr/litër Me më pak se 95 oktan Me 95–98 oktan Me 98 e më shumë oktan	37 lekë/litri
E420	27 10 12 51 27 10 12 59	Benzinë me plumb, me përmbajtje plumbi më tepër se 0,013 gr/litër Me më pak se 98 oktan Me 98 e më shumë oktan	50 lekë/litri
E430	27 10 19 11 deri 27 10 19 29 27 10 19 21 deri 27 10 19 25	Vajguri Karburantet, tip vajguri	20 lekë/litri 20 lekë/litri
E440	27 10 19 31 deri 27 10 19 48	Vajra të rënda (gazoil)	37 lekë/litri
E450	27 10 19 51 deri 27 10 19 69	Vajra të rënda si lëndë djegëse (lëndë djegëse, solar, mazut)	37 lekë/kg
E460	2710 20	Biodiesel me vajra nafte	37 lekë/kg
E470	27 10 19 71 deri 27 10 19 99	Vajra lubrifikante dhe vajra të tjera	40 lekë/kg
E471	27 109 100 deri 27109900	Mbetje vajrash	5 lekë/kg

E472	27 12 10 90	Graso	40 lekë/kg
E480	27 13 11 00 27 13 12 00	Koks nafte	2 lekë/kg
E490	27 13 20 00	Bitum nafte	5 lekë/kg
E490	27 13 90	Mbetje të vajrave të naftës dhe të mineraleve bituminoze (bitumen)	5 lekë/kg
E491	27 15	Përzierje bituminoze të bazuara Në asfaltin natyror, në bitumen e naftës, në katranin mineral, ose në terpentinën e katranit mineral (masticet bituminoze) Vernik Bituminoz (p.sh. asfalto-beton)	5 lekë/kg bitum
E492	27 14 90 00	Zhavor bituminoz	0,3 lekë/kg
E500 Gazet e naftës dhe hidrokarbure të tjera gazoike	27111211 27111219 27111291 27111293 27111294 27111297 27111310 27111330 27111391 27111397 27111400	Gazet e naftës dhe hidrokarbure të tjera gazoike për përdorim si lëndë djegëse për motor automjetesh.	8 lekë/litri në 1 janar 2022 deri 1 korrik 2022 6 lekë/litri nga 1 korrik 2022
		Gazet e naftës dhe hidrokarbure të tjera gazoike për përdorim të ndryshëm nga ai si lëndë djegëse për motor automjetesh.	0 lekë/litri në 1 janar 2022 deri 1 korrik 2022 6 lekë/litri nga 1 korrik 2022
E600 Hidrokarburet aciklike	2901	Hidrokarburet aciklike	37 lekë/kg
E700 Hidrokarburet ciklike	2902	Hidrokarburet ciklike	37 lekë/kg
E800 Metanol (Alkooli metilik)	29051100	Metanol (alkooli metilik)	Sipas përcaktimeve të neneve 50 e 51 të ligjit
L000	34 03 19 10 34 03 99 00	Preparate për lubrifikimin e makinerive, pajisjeve dhe automjeteve	40 lekë/kg
L000 Preparatet antiplasëse, frenues oksidimi; Alkibenzenet e përziera	3811 dhe 3817	Preparatet antiplasëse, frenues oksidimi, stabilizator rrëshire, përmirësues viskoziteti,kundër korrozionit, dhe elemente shtesë të përgatitura për vajrat minerale (përfshirë benzinën) apo lëngje të tjera të përdorura për qëllime të tjera si vajrat minerale Alkibenzenet e përziera dhe Alkinaftalenet e përziera	Sipas përcaktimevetë neneve 50 e 51 të ligjit
E920 Biodiezel	3826 00	Acidet yndyrore/Biodiezel me më pak se 70% vajra nafte të kapitullit 27	37 lekë/litri
V. FISHEKZJARRËT			
F000 Fishekzjarrët	36 04 10 00	Fishekzjarrët	200 lekë/kg
F000	36 04 90 00	Të tjera	200 lekë/kg
VI. GOMAT			
P100 Goma të reja	40 11	Goma të reja pneumatike prej gome	20 lekë/kg
P200 Goma të riveshura	40 12 (përveç 40 12 20 00)	Goma pneumatike të riveshura; goma mishi apo të zakonshme; veshja e jashtme (pjesa me lule) dhe fashetat e gomës	40 lekë/kg

DEKRET
Nr. 13882, datë 19.12.2022

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjin nr. 81/2022 "Për një ndryshim në ligjin nr. 61/2012, 'Për akcizat në Republikën e Shqipërisë', të ndryshuar".

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

LIGJ
Nr. 82/2022

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 92/2014, "PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR[1]

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 92/2014 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Pas shkronjës "p" të nenit 51, "Përjashtimi i disa veprimtarive me interes të përgjithshëm", shtohet shkronja "q" me këtë përmbajtje:

"q) Furnizimi i artikujve të përfshirë në kreun 4401 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, me efekt deri më 31 dhjetor 2023.".

Neni 2

Pas pikës 44 të nenit 56, "Përjashtime të veçanta në import", shtohen pikat 45 dhe 46 me këtë përmbajtje:

"45. Mallrat e destinuara për realizimin e projekteve të financuara me fonde të marra në bazë të një marrëveshje donacioni/granti të lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë/Republikës së Shqipërisë dhe donatorëve të huaj, nëse në marrëveshje është parashikuar se fondet e marra nuk do të përdoren për të paguar tatime.

Kriteret dhe procedurat për zbatimin e kësaj pike përcaktohen me udhëzim të ministrit të financave.

46. Importimi i artikujve të përfshirë në kreun 4401 të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, me efekt deri më 31 dhjetor 2023.".

Neni 3

Pas shkronjës "b" të pikës 1 të nenit 60, "Furnizime të përngjashme me eksportet", shtohet shkronja "c" me këtë përmbajtje:

"c) Furnizimi i mallrave/shërbimeve, të destinuara për realizimin e projekteve të financuara me fonde të marra në bazë të një marrëveshjeje donacioni/granti të lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë/Republikës së Shqipërisë dhe donatorëve të huaj, nëse në marrëveshje është parashikuar se fondet e marra nuk do të përdoren për të paguar tatime.".

Neni 4

Në fund të pikës 2, të nenit 77, "Rimbursimi i TVSH-së", shtohen fjalët "me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikën 45 të nenit 56 dhe germës "c" të pikës 1 të nenit 60 të këtij ligji".

[1] Ky ligj është përafruar pjesërisht me:
- direktivën e Këshillit 2006/112/KE, datë 28 nëntor 2006 "Mbi sistemin e përbashkët të tatimit mbi vlerën e shtuar", e ndryshuar", numri CELEX 32006L0112, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 347, datë, 11.12.2006, faqe 1-118".

Nen 5

Pas nenit 155, "Mbajtja e llogarive", shtohet seksioni 6, "Regjimi i veçantë për Bursën Shqiptare të Energjisë", përfshirë nenet 155/1, 155/2 dhe 155/3 me këtë përmbajtje:

"SEKSIONI 6
REGJIMI I VEÇANTË PËR BURSËN SHQIPTARE TË ENERGJISË

Neni 155/1
Përkufizime

Për qëllime të këtij seksioni, me termat e mëposhtëm kuptohet:

a) "Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike" është struktura përgjegjëse për menaxhimin dhe administrimin e tregut të organizuar ndërmjet platformës së tregut për shitjen dhe blerjen e energjisë elektrike, në bazë të ditës në avancë dhe/ose brenda së njëjtës ditë, si dhe për të gjitha aktivitetet e lidhura me të, duke përfshirë edhe aktivitetin e kompensimit financiar (*clearing*) mes pjesëmarrësve të tregut, në përputhje me rregullat dhe modelin e tregut.

b) "Treg energjie elektrike" është një sistem ku kryhen shitje dhe blerje efektive, përfshirë edhe derivativët e energjisë elektrike, nëpërmjet kërkesave dhe ofertave, të paraqitura në periudha afatgjata dhe afatshkurtra.

c) "Derivativ elektrik" është një instrument financiar që mund të përdoret nga pjesëmarrësit e tregut të energjisë elektrike si mjet sigurie ndaj luhatjeve të mundshme të çmimit të energjisë elektrike në treg.

d) "Pjesëmarrës i tregut të energjisë elektrike" është një person juridik, i regjistruar si pjesëtar i tregut të energjisë elektrike, që përfshin prodhuesit, tregtarët, furnizuesit, klientët, Operatorin e Sistemit të Transmetimit, Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes, sistemet e mbyllura të shpërndarjes dhe operatorin e tregut. Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes janë pjesëmarrës të tregut të energjisë elektrike vetëm për qëllim të sigurimit të energjisë elektrike të nevojshme për mbulimin e humbjeve në rrjet, balancimin dhe shërbimet ndihmëse.

Neni 155/2
Përjashtimi nga tatimi

Përjashtohen nga tatimi mbi vlerën e shtuar importimi dhe furnizimi brenda vendit i energjisë elektrike të destinuar për t'u shitur nëpërmjet Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike.

Neni 155/3
Pagesa e TVSH-së

1. Në rastin e furnizimit të energjisë elektrike të tregtuar nëpërmjet Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike, TVSH-ja bëhet e kërkueshme në momentin kur shpallen rezultatet në tregjet e ankandeve të ditës në avancë ose brenda së njëjtës ditë ose në momentin kur urdhër porositë përputhen në rastin e tregut të vazhdueshëm brenda së njëjtës ditë.

2. Deri më 31 dhjetor 2026 TVSH-ja është e pagueshme nga personi i tatueshëm për të cilin kryhet furnizimi me energji elektrike nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike në përputhje me parashikimet e këtij seksioni dhe përcaktimet e nenit 21. Për efekt të përllogaritjes së TVSH-së blerësi i energjisë elektrike nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike kryen autongarkesën (*reverse-charge*) e TVSH-së në cilësinë e personit përgjegjës për pagesën e TVSH-së.

Procedurat për zbatimin e kësaj pike dhe fillimi i aplikimit të kësaj skeme të veçantë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.".

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga 1 janari 2023.

Miratuar më datë 24.11.2022.

Shpallur me dekretin nr.13881, datë 19.12.2022 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 13881, datë 19.12.2022

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 82/2022, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92/2014, 'Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë', të ndryshuar".

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

DEKRET
Nr. 13879, datë 13.12.2022

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës "c", dhe nenit 93, të Kushtetutës, si dhe të nenit 6, nenit 20 dhe në vijim, të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Besëtar Setki Dibra
2. Fatjon Driton Sokoli
3. Selami Sali Koci
4. Burim Bashkim Devetaku
5. Afijet Ismet Xërxa (Dibra)
6. Afërdita Beslim Berisha
7. Ermal Skënder Çoçaj
8. Valon Setki Dibra
9. Akram Khaled Darrah
10. Florenta Driton Sokoli
11. Hasije Mehdi Sinanaj (Pulaj)
12. Lebibe Selam Kosova (Hoxhaj)
13. Flaka Naser Hashani
14. Euron Faruk Beqa
15. Arianit Jakup Dobroshi
16. Adem Ragip Buqa
17. Devoll Gazmend Haraqija
18. Naser Ismet Rudi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

VENDIM
Nr. 799, datë 12.12.2022

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 87, DATË 9.2.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIKONSTRUKSIONIT/ RIPARIMIT TË MJEDISEVE NË BASHKËPRONËSI OSE TË PËRBASHKËTA NË NDËRTESA (PALLAT), NË BASHKINË MIRDITË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, 'Për buxhetin e vitit 2022', të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2, të vendimit nr. 87, datë 9.2.2022, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

"2/1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 210 393 360 (dyqind e dhjetë milionë e treqind e nëntëdhjetë e tre mijë e treqind e gjashtëdhjetë) lekë, për financimin e

rikonstruksionit/riparimit të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat), në Bashkinë Mirditë, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit miratuar, për vitin 2022, dhe i transferohet Bashkisë Mirditë, në formën e transfertës së pakushtëzuar.".

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Mirditë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

URDHËR
Nr. 286, datë 5.12.2022

PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT KOMBËTAR TË KONTROLLIT TË CILËSISË SË SIGURISË SË AVIACIONIT CIVIL

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 116, të ligjit nr. 96/2020, datë 23.7.2020, "Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Miratimin e Programit Kombëtar të Kontrollit të Cilësisë së Sigurisë së Aviacionit Civil, bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil për mbikëqyrjen dhe zbatimin e këtij programi.

3. Urdhri i ministrit të Punëve Publike dhe Transportit nr. 19, datë 26.2.2013, "Për miratimin e Programit Kombëtar të Kontrollit të Cilësisë së Sigurisë në Aviacionin Civil të Republikës së Shqipërisë", shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR DHE
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

PROGRAMI KOMBËTAR I KONTROLLIT TË CILËSISË SË SIGURISË SË AVIACIONIT CIVIL

Tabela e përmbajtjes

KREU I. HYRJE
1.1 Objekti dhe përmbajtja e Programit Kombëtar të Cilësisë së Sigurisë së Aviacionit Civil
1.1.1 Sistemi i modifikimit dhe i rishikimit
1.1.2 Përgjegjësia për trajtimin e këtij dokumenti
1.1.3 Subjektet zbatuese
1.1.4 Parimet
1.2 Objektivat e Programit
1.3 Elementet kryesore
KREU II. REFERENCAT LIGJORE
2.1 Rregulloret ndërkombëtare dhe rekomandimet
2.1.1 Legjislacioni kombëtar
2.2 Kualifikimi dhe konfidencialiteti
2.3 Pavarësia
2.4 Fushëveprimi dhe mjetet
KREU III. PËRKUFIZIME
KREU IV. AUTORITETI PËRGJEGJËS DHE PËRGJEGJËSITË
4.1 Autoriteti përgjegjës
4.1.1 Ndarja e kompetencave/detyrave
4.2 Organizimi, përgjegjësitë dhe burimet
4.2.1 Mekanizmat dhe metodat
4.3 Inspektorët/audituesit kombëtarë dhe kompetencat e tyre
4.3.1 Autorizimi dhe ushtrimi i kompetencave të tyre
4.4 Entitet e tjera
4.5 Kontrolli i brendshëm i cilësisë
KREU V. KUALIFIKIMET, EMËRIMI DHE DETYRAT E INSPEKTORIT/AUDITUESIT KOMBËTAR
5.1 Inspektorët/audituesit kombëtarë
5.2 Kriteret e nevojshme për kualifikim
5.3 Procesi i përzgjedhjes
5.4 Trajnimi dhe emërimi i inspektorëve/ audituesve kombëtarë
5.5 Përshkrimi i detyrave
KREU VI AKTIVITETET OPERACIONALE TË MONITORIMIT
6.1 Administrimi në tërësi i programit
6.2 Aktivitetet e planifikuara/të programuara
6.3 Aktivitetet monitoruese
6.4 Veprimet monitoruese që ndërmarrin operatorët

6.5 Metodologjia e përgjithshme
6.6 Mbledhjet/takimet
6.7 Seancat shpjegimore dhe raportimi
6.8 Përbërja e grupit të monitorimit
6.9 Klasifikimi i përputhshmërisë
KREU VII. AKTIVITETET E TRAJTIMIT TË MANGËSIVE DHE MASAT KORRIGJUESE
7.1 Kuadri ligjor
7.2 Procesi i korrigjimit dhe etapat e këtij procesi
7.3 Këshillim dhe bindje
7.4 Paralajmërimi formal
7.5 Ndëshkimi me gjobë
7.6 Kallëzim penal
KREU VIII. KOMUNIKIMI DHE RAPORTIMI
8.1 Komunikimi i brendshëm
8.2 Sistemi i jashtëm i raportimit
ANEKSI A. METODOLOGJIA E NJË AUDITIMI TË SIGURISË
1. Përkufizimi dhe objektivat e auditimit
2. Përshkrimi
2.1 Sfera e auditimeve
2.2 Autoriteti dhe kompetencat e audituesve të sigurisë në aviacion
2.3 Kryerja e auditimit
2.4 Mangësitë/të metat
3. Raportimi dhe procedurat pas auditimit
3.1 Raportimi
3.2 Raporti i kontrollit
3.3 Procedurat pas auditimit
3.4 Rekordet/arkivimi
ANEKSI B. METODOLOGJIA E NJË INSPEKTIMI TË SIGURISË
1. Përkufizimi dhe objektivat e inspektimeve të sigurisë
2. Përshkrimi
2.1 Sfera e inspektimeve
2.2 Autoriteti dhe kompetencat e inspektorëve të sigurisë në aviacion
2.3 Kryerja e inspektimeve
2.4 Mangësitë/të metat
3. Raportimi dhe procedurat "postinspektim"
3.1 Raportimi
3.2 Procedurat "postinspektim"
3.3 Rekordet/arkivimi
ANEKSI C. METODOLOGJIA E STUDIMEVE TË SIGURISË
1. Përkufizimi dhe objektivat e anketimeve të sigurisë
2. Përkufizimi/përshkrimi
2.1 Sfera e sondazheve/anketimeve/studimeve
2.2 Kryerja e sondazheve/anketimeve/studimeve
2.3 Mangësitë/të metat
3. Raportimi dhe procedurat "postanketim"
3.1 Raportimi
3.2 Procedurat "postanketim"
3.3 Rekordet/arkivimi
3.4 Analizimi
ANEKSI D. METODOLOGJIA E TESTIMIT TË SIGURISË
1. Përkufizimi dhe objektivat e testimeve të sigurisë
2. Përshkrimi
2.1 Sfera e testimeve
2.2 Kryerja e testimeve
2.3 Mangësitë/të metat
3. Raportimi dhe procedurat "posttestim"
3.1 Raportimi
3.2 Procedurat ndjekëse/pasuese
3.3 Rekordet/arkivimi
ANEKSI E. METODOLOGJIA E NJË HETIMI TË SIGURISË
1. Përkufizimi dhe objektivat e hetimit të sigurisë
2. Përshkrimi
2.1 Kryerja e hetimeve të sigurisë
3. Raportimi dhe procedurat "posthetim"
SHTOJCA 1. Formati i raportit të inspektimeve /auditeve

KREU I
HYRJE

1.1 Objekti dhe përmbajtja e Programit Kombëtar të Kontrollit të Cilësisë së Sigurisë së Aviacionit Civil

Programi Kombëtar i Kontrollit të Cilësisë së Sigurisë së Aviacionit Civil ("PKKCSAC") përmban aktivitetet e monitorimit të masave të marra për vlerësimin e vazhdueshëm të zbatimit të Programit Kombëtar të Sigurisë së Aviacionit Civil, përfshirë dhe politikat ku bazohet.

PKKCSAC-ja është një komponent thelbësor i sistemit mbikëqyrës të sigurisë me objektiv vlerësimin e zbatimit efektiv të masave të kontrollit të cilësisë. Masat e kontrollit të cilësisë

mund të përcaktohen si teknika dhe aktivitete të përdorura për të vlerësuar sistemin e sigurisë në aviacion nëse kërkohet të zgjidhë mangësitë e identifikuara.

1.1.1 Sistemi i modifikimit dhe i rishikimit

AAC-ja në përputhje me kërkesat e përditësuara që burojnë nga PKSAC-ja në lidhje me zhvillimet në sigurinë e aviacionit civil, merr masa për rishikimin, përditësimin dhe ndryshimin e PKKCSAC-së, i cili miratohet nga ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë.

1.1.2 Përgjegjësia për trajtimin e këtij dokumenti

Të gjitha kopjet e këtij programi janë individuale dhe përgjegjës për kopjet janë personalisht mbajtësit/përdoruesit e tij.

1.1.3 Subjektet zbatuese

Të gjitha subjektet e përfshira dhe përgjegjëse për zbatimin e të gjitha aspekteve të PKKCSAC-së duhet të jenë të pajisura me këtë program. Programi është i zbatueshëm për të gjithë stafin e përfshirë në aktivitetet e sigurisë së aviacionit civil. Shpërndarja e këtij programi bëhet vetëm me miratim të AAC-së.

Ky program zhvillohet dhe mirëmbahet në bashkëpunim me të gjitha entitetet e përfshira në zbatimin e masave të sigurisë në aviacion. Trajnimet e duhura i ofrohen çdo entiteti dhe/ose personi që duhet të jetë subjekt i aktiviteteve të kontrollit të cilësisë.

Programi i kontrollit të cilësisë është përshtatur për të reflektuar ndryshimet sipas kushteve lokale, duke marrë në konsideratë natyrën e aeroportit dhe të operimeve të avionit. Prioritetet dhe shpeshtësia e monitorimit do të vendosen mbi baza të vlerësimit të rrezikut të ndërmarra nga autoritetet përkatëse.

1.1.4 Parimet

Programi Kombëtar i Kontrollit të Cilësisë së Sigurisë së Aviacionit Civil, i referuar si "PKKCSAC" në këtë dokument, përcakton strukturën, përgjegjësitë, proceset dhe procedurat që promovojnë dhe krijojnë një mjedis dhe kulturë të përmirësimit të vazhdueshëm dhe forcimit të sigurisë së aviacionit.

Ky program përfshin elementet vijuese, duke ofruar udhëzime apo procedura të mjaftueshme, sipas rastit, për zbatimin efektiv të tyre:

a) objektivin e programit;

b) autoritetin që është caktuar për të zhvilluar, mbajtur dhe mbikëqyrur PKKCSAC-në;

c) menaxhimin operacional të programit të nivelit të lartë, duke përfshirë parimet e planifikimit dhe zbatimit të aktiviteteve të kontrollit të cilësisë;

d) përgjegjësitë e AAC-së dhe entiteteve të tjera të përfshira në kontrollin e cilësisë;

e) burimet financiare, njerëzore dhe materiale;

f) kriteret e përzgjedhjes dhe trajnimit (trajnimi fillestar, në punë dhe rifreskues) të personave përgjegjës për aktivitetet e kontrollit të cilësisë;

g) autoritetin e personave të ngarkuar me detyrat e kontrollit të cilësisë për të verifikuar pajtueshmërinë dhe për të kërkuar veprime korrigjuese;

h) kodin e sjelljes për personat përgjegjës për aktivitetet e kontrollit të cilësisë;

i) konfidencialitetin e raporteve dhe rezultateve të veprimtarisë së kontrollit të cilësisë;

j) klasifikimin e papajtueshmërisë;

k) metodologjinë e aktiviteteve të monitorimit të pajtueshmërisë, duke përfshirë planifikimin, afatet dhe fushëveprimin e auditimeve të sigurisë, inspektimet dhe testet, frekuencat për auditimet e sigurisë dhe inspektimet;

l) metodologjinë e kryerjes së hetimeve, duke ndjekur një shkelje aktuale ose të mundshme të sigurisë dhe nëse ka arsye për të rivlerësuar nevojat e sigurisë;

m) raportimin: procesi i paraqitjes dhe miratimit të raportit të aktivitetit të kontrollit të cilësisë;

n) mbajtjen dhe analizën statistikore të rezultateve të aktivitetit të kontrollit të cilësisë, duke përfshirë gjetjet dhe rekomandimet, mjetet për grumbullimin dhe analizimin e informacionit të lidhur me përputhshmërinë, tendencat dhe identifikimin e problematikave sistematike;

o) përmbledhjen vjetore dhe raportin e analizës;

p) veprimet shtrënguese: plani i masave korrigjuese, veprimet administrative, penalitetet administrative dhe veprimet e tjera shtrënguese;

q) përcjelljen dhe vlerësimin e masave korrigjuese për të siguruar që mangësitë e identifikuara përmes mekanizmave të kontrollit të cilësisë, janë korrigjuar;

r) kërkesat lidhur me masat e kontrollit të brendshëm të cilësisë të subjekteve përgjegjëse për programin e sigurisë ose për zbatimin e masave të sigurisë; dhe

s) procesin e monitorimit të masave të kontrollit të brendshëm të cilësisë të subjekteve përgjegjëse për programin e sigurisë ose për zbatimin e masave të sigurisë.

AAC-ja do të zhvillojë procedurat, format, *check-list* dhe protokollet e duhura për inspektorët e sigurisë të aviacionit për t'i ndihmuar ata në kryerjen e kontrolleve të sigurisë, inspektimeve dhe testeve në mënyrë të standardizuar dhe efektive, duke përfshirë udhëzime, mbi:

a) përgatitjen, kryerjen dhe raportimin e aktiviteteve të kontrollit të cilësisë;

b) ndjekjen "*follow-up*" të mospërputhjes dhe veprimeve shtrënguese siç kërkohet; dhe

c) zgjidhjen e shqetësimeve të sigurisë.

1.2 Objektivat e programit

Objektivi primar i Programit Kombëtar të Kontrollit të Cilësisë është monitorimi i efektivitetit të masave të sigurisë të zbatuara nga të gjitha entitetet që zbatojnë funksione sigurie dhe të vendosë nivelin e përputhshmërisë me rregullat të aplikuara të këtij programi.

Objektivat e Programit kanë qëllim:

a) të identifikojnë mangësitë në sistemin e sigurisë dhe zbatimin e masave të duhura korrigjuese; dhe

b) të identifikojnë të gjitha aspektet e masave të sigurisë që mund të kërkojnë ndryshim në legjislacionin e sigurisë në aviacion, PKKCSA-ja dhe/ose mënyrat e zbatimit;

c) të përcaktojnë nivelin e përputhshmërisë me dispozitat e Programit Kombëtar të Sigurisë së Aviacionit Civil (nga këtu "PKSAC") me metodën e aktiviteteve monitoruese të përputhshmërisë;

d) të vlerësojnë mjaftueshmërinë dhe efikasitetin e PKSAC-së.

1.3 Elementet kryesore

Programi Kombëtar i Kontrollit të Cilësisë në Sigurinë e Aviacionit Civil është hartuar veçanërisht për të përshkruar angazhimet organizative dhe praktike në aktivitetet e kontrollit të cilësisë, konkretisht:

a) përshkruan strukturën organizative, përgjegjësitë dhe burimet;

b) përshkruan llojin e punës, dhe kualifikimet e kërkuara për inspektorët/ audituesit;

c) qartëson përgjegjësitë respektive të të gjitha entiteteve të përfshira në Program;

d) kontrollon veprimtarinë e monitorimit të pajtueshmërisë, duke përfshirë qëllimin për auditimet e sigurisë, inspektimet, testet dhe ndjekjen e një plani veprimi në rast të një boshllëku të mundshëm të sigurisë, investigimet, frekuencat për auditimet dhe inspektimet e sigurisë dhe gjithashtu klasifikimin e pajtueshmërisë;

e) përshkruan procedurat për aktivitetet monitoruese për t'u ndërmarrë nga AAC-ja;

f) përshkruan aktivitetet e korrigjimit të mangësive të konstatuara, duke përfshirë sistemin e raportimit dhe të aktiviteteve ndjekëse;

g) shpjegon regjimin e ushtrimit të kompetencave;

h) përshkruan masat zbatuese dhe aty ku është e nevojshme penalitetet.

KREU II
REFERENCAT LIGJORE

2.1 Rregulloret ndërkombëtare dhe rekomandimet

Programi është hartuar duke konsideruar dhe përshtatur dokumentet e mëposhtëm:

- Aneksi 17 i ICAO-s, standardet dhe praktikat e rekomanduara;
- Manuali i Sigurisë në Aviacion i ICAO-s, Dok. 8973 – i kufizuar, volumi i NCASQCP;
- Dokumenti 30 i ECAC, (pjesa II "Siguria"), rekomandimet, pjesa III.

2.1.1 Legjislacioni kombëtar

Programi është në përputhje me:

- Kodin Ajror të Republikës së Shqipërisë, ligji nr. 96/2020, datë 23.7.2020;
- Programin Kombëtar të Sigurisë së Aviacionit Civil, miratuar me VKM-në nr. 1115, datë 24.12.2020;
- Standardet Bazë për Ruajtjen e Aviacionit Civil nga Aktet e Ndërhyrjes së Paligjshme që Rrezikojnë Sigurinë e Aviacionit Civil, miratuar me VKM-në nr. 821, datë 24.12.2021;
- Programin Kombëtar të Trajnimit për Sigurinë e Aviacionit Civil, miratuar me urdhrin në fuqi të ministrit përgjegjës për transportin ajror;
- Masat e detajuara për zbatimin e standardeve themelore të përbashkëta në fushën e sigurisë së Aviacionit Civil, miratuar me urdhrin e ministrit përgjegjës për transportin ajror nr. 163, datë 26.3.2021;

2.2 Kualifikimi dhe konfidencialiteti

Masat e kontrollit të cilësisë duhet të kryhen nga inspektorët/ audituesit kombëtarë të sigurisë në

aviacion të cilët janë trajnuar në fushat që ata do të ndërmarrin aktivitetet monitoruese. Një nivel i lartë i ekspertizës do t'u mundësojë atyre të kryejnë detyrat në një mënyrë më efektive dhe efikase duke rritur besueshmërinë e sistemit të monitorimit të sigurisë së aviacionit.

Inspektorëve/ audituesve kombëtarë të sigurisë të aviacionit u kërkohet nga AAC-ja që të ruajnë në masën më të rreptë konfidencialitin në lidhje me informacionin e mbledhur gjatë aktiviteteve të tyre të monitorimit.

Përveç kësaj, ata duhet të autorizohen me fuqinë e nevojshme ligjore për të kryer aktivitetet e tyre.

2.3 Pavarësia

Masat e kontrollit të cilësisë duhet të jenë të drejta, të paanshme, të qëndrueshme, të besueshme dhe mund të përsëriten vazhdimisht, në mënyrë që të nxisin bashkëpunimin me subjektet që janë subjekt monitorimi e mbikëqyrjeje dhe për të siguruar që rezultatet të pranohen. Kjo ndihmon që të sigurohet që çdo plan veprimi korrigjues të zbatohet në mënyrë efektive. Pavarësia është një tipar thelbësor i procesit të monitorimit.

Menaxhimi, caktimi i prioriteteve dhe organizimi i PKKCAC-së është operacionalisht i pavarur nga subjektet dhe personat përgjegjës për zbatimin e masave të marra sipas PKKSAC. Për më tepër, inspektorët e kontrollit të cilësisë duhet të jenë të pavarur nga entitetet që monitorohen dhe pa ndonjë ndikim tregtar ose operacional.

2.4 Fushëveprimi dhe mjetet

Ky program mbulon lloje të ndryshme të aktiviteteve monitoruese, përfshirë auditimet, inspektimet dhe testet e sigurisë, që kanë për qëllim përcaktimin e nivelit të përgjithshëm të pajtueshmërisë me kërkesat kombëtare dhe për të vlerësuar nevojat e sigurisë në fusha të ndryshme.

Aktivitetet e kontrollit të cilësisë do të mbulojnë të gjitha aspektet e PKSAC-së, duke përfshirë organizimin e sistemit kombëtar të sigurisë së aviacionit dhe masat e sigurisë të vendosura për të gjitha organizatat shtetërore ose subjektet e tjera të përfshira në zbatimin e këtyre masave.

Të gjitha njësitë me përgjegjësi të sigurisë së aviacionit duhet t'u nënshtrohen aktiviteteve të monitorimit, duke përfshirë operatorët e avionëve të huaj që veprojnë për dhe nga aeroportet brenda Republikës së Shqipërisë, për të siguruar përputhjen e tyre me rregullat kombëtare dhe PKKSAC-së.

KREU III
PËRKUFIZIME

Për qëllimin e këtij Programi, përkufizimet e mëposhtme do të aplikohen:

1. "**Akt i ndërhyrjes së paligjshme**" janë akte apo tentativë aktesh që rrezikojnë aviacionin civil, duke përfshirë, por pa u kufizuar, në:

- rrëmbimin apo marrjen në mënyrë të paligjshme të avionit;
- shkatërrimin e një avioni gjatë shërbimit;
- pengmarrjen në bord të avionit apo në aerodrome;
- futjen me forcë në bordin e avionit, në ambientet e aerodromit apo në objekte të tjera të aeronautikës;
- futjen në bordin e avionit ose në aeroport të armëve, pajisjeve të rrezikshme apo materialeve që kanë për qëllim të përdoren për akte kriminale;
- përdorimin e avionit si armë me qëllim shkaktimin e vdekjes, plagosjes së rëndë apo dëmtimeve të pronës dhe mjedisit;
- dhënien e informacionit të rremë, i cili rrezikon avionin në fluturim apo në tokë, jetën e pasagjerëve, të ekuipazhit, të personelit apo publikut në një aeroport apo në objekte të aviacionit.

2. "**Autoriteti përkatës**" është Autoriteti i Aviacionit Civil, i përcaktuar si autoriteti kombëtar përgjegjës për koordinimin dhe monitorimin e implementimit të programit kombëtar të sigurisë, përkatësisht;

***3. "*Auditues kombëtar**" është çdo person që drejton veprimtaritë kombëtare të monitorimit të pajtueshmërisë në emër të autoritetit përkatës;

4. "**Auditues i pavarur**" është çdo person që drejton veprimtaritë e monitorimit të pajtueshmërisë në emër të vet apo për llogari të një subjekti;

5. "**Audit i sigurisë**" është një kontroll i detajuar i vazhdueshëm i zbatimit të të gjitha aspekteve të Programit Kombëtar të Sigurisë së Aviacionit Civil;

6. "**Aktivitete të monitorimit të përputhshmërisë**" është çdo procedurë ose proces i përdorur për vlerësimin e zbatimit të Programit Kombëtar të Sigurisë së Aviacionit Civil

dhe të të gjitha dispozitave ligjore në fuqi në lidhje me sigurinë e aviacionit civil;

7. "**Dobësi**" nënkupton dobësi në zbatimin e masave dhe procedurave të cilat mund të shfrytëzohen për të kryer një akt të ndërhyrjes së paligjshme;

8. "**Hetim i sigurisë**" është një mbledhje të dhënash dhe faktesh në rastet e: i) akteve të ndërhyrjes së paligjshme ndaj Aviacionit Civil; dhe ii) shkeljeve apo dhunimit të masave të sigurisë, të standardeve dhe praktikave të rekomanduara në Aviacionin Civil, të pranuara ndërkombëtarisht;

9. "**Inspektim i sigurisë**" është një kontroll dhe një vlerësim i një apo më shumë masave të sigurisë të parashikuara në Programin Kombëtar të Sigurisë së Aviacionin Civil, për të përcaktuar nëse këto masa janë zbatuar efektivisht, në standardin e duhur dhe për të identifikuar nëse ka mangësi;

10. "**Incident i sigurisë**" është situatë me implikime negative për sigurinë e personave dhe të pronës;

11. "**Intervistë**" është një intervistim verbal nga një auditues për të vërtetuar nëse masat dhe procedurat specifike të sigurisë janë zbatuar;

12. "**Mangësi ose papajtueshmëri"** është një dështim në përmbushjen e një kërkesë të sigurisë së aviacionit civil;

13. "**Operator**" është Operatori i një Avioni apo Aeroporti;

14. "**Vlerësim i sigurisë**" është një studim i hollësishëm, i cili duhet të njoftohet në kohë përpara kryerjes, i operimeve të aeroporteve dhe operimeve të transportuesve ajror apo të entiteteve apo organizmave që kanë të bëjnë me sigurinë në aviacionin civil, për identifikimin e pikave të dobëta të cilat mund të shfrytëzohen për kryerjen e akteve të ndërhyrjeve të paligjshme, dhe masave të sigurisë të domosdoshme për të përmbushur politikat aktuale.;

15. "**Test**" është një testim i masave të sigurisë së aviacionit, ku AAC-ja stimulon tentativë për të kryer një veprim të ndërhyrjes së paligjshme me qëllim ekzaminimin e efektivitetit të implementimit të masave ekzistuese të sigurisë;

16. "**Verifikim**" është një veprim i kryer nga një auditues për të vërtetuar nëse masa specifike të sigurisë janë në zbatim;

17. "**Vëzhgim**" është një kontroll vizual nga një auditues për të vërtetuar nëse masat dhe procedurat e sigurisë janë zbatuar;

18. "**ZPEA**" është marrëveshja shumëpalëshe midis Komunitetit Evropian dhe shteteve anëtare, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Islandës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Serbisë, Republikës së Malit të Zi, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Mbretërisë së Norvegjisë, Republikës së Rumanisë dhe Misionit Administrativ të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, mbi krijimin e një zone të përbashkët evropiane të aviacionit.

KREU IV
AUTORITETI PËRGJEGJËS DHE PËRGJEGJËSITË

4.1 Autoriteti përgjegjës

Autoriteti i Aviacionit Civil është Autoriteti përgjegjës për zhvillimin e politikave, koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të Programit Kombëtar të Sigurisë, nëpërmjet:

a) zhvillimit të propozimeve dhe zbatimit të politikave kombëtare, Programit Kombëtar të Sigurisë dhe rregulloreve në fuqi;

b) kryerjes së aktiviteteve monitoruese për zbatueshmërinë e standardeve.

Në zbatim të ligjit për organiyimin dhe funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil:

a) inspektorëve të sigurisë së aviacionit do t'u delegohet autoritet i mjaftueshëm, për të marrë masa të menjëhershme shtrënguese; dhe

b) inspektorët e sigurisë së aviacionit do të kenë akses të pakufizuar dhe të palimituar në avionë dhe objekte të aviacionit (si brenda dhe jashtë aeroportit), dhe do të marrin dhe inspektojnë dokumentacionin përkatës të sigurisë së aviacionit për kryerjen e funksioneve dhe detyrave të tyre;

c) personeli përgjegjës për aktivitetet monitoruese duhet të jetë formalisht i autorizuar për të kryer detyrat që vijojnë:

i. të hyjë dhe të inspektojë çdo pjesë të çdo aeroporti në Republikën e Shqipërisë, facilitetet ose ndërtesë në çdo aeroport në ndonjë ambient jashtë aeroportit që përdoret nga bizneset që operojnë në aeroport ose që është i lidhur me një aeroport ose operator ajror ose subjektet e tjera përgjegjëse për zbatimin e masave të sigurisë;

ii. të hyjë dhe të inspektojë çdo avion që operon në RSH me qëllim të vlerësimit të çdo procedure sigurie;

iii. të inspektojë dhe testojë efektivitetin e masave dhe procedurave të sigurisë dhe performancën e pajisjeve të kontrollit të sigurisë;

iv. të kërkojë nga operatori ajror, operatori i aeroportit, organizata qeveritare ose subjekte të tjera të përfshira në zbatimin e masave të sigurisë së aviacionit ose të shfrytëzuesit të tokës jashtë aeroportit të përdorur për qëllime biznesi të lidhura me aeroportin, për të ofruar informata relevante për çdo auditim, inspektim, test ose hetim;

v. të ketë akses në dokumentacionin dhe regjistrimet përkatëse të sigurisë;

vi. të intervistojë cilindo person me qëllim të vlerësimit të standardit të sigurisë ose zbatimit të procedurave të sigurisë;

vii. të marrë në një aeroport, zonë ajrore ose ndonjë zonë të caktuar të sigurisë të kufizuar dhe të përdorin çdo pajisje të nevojshme për kryerjen e detyrave të tyre, duke përfshirë radiot, kamerat, pajisjet e regjistrimit (audio dhe video) dhe artikuj të veçantë të autorizuar ose të ndaluar, siç janë armë kopje ose mjetet simuluese shpërthyese;

viii. të lëshojë njoftime për gjetjet, mangësitë dhe/ose rekomandimet, sipas rastit;

ix. të forcojë veprime korrigjuese, duke përfshirë korrigjimin e menjëhershëm të çdo gjetjeje dhe/ose të zbatojë masat përforcuese; dhe

x. të zbatojë të gjitha kërkesat përkatëse të sigurisë kombëtare të aviacionit.

AAC-ja duhet të pajisë me kredencialet zyrtare inspektorët e saj të sigurisë për të lehtësuar aksesin e tyre në objekte, avionë dhe dokumentacion për kryerjen e detyrave të inspektimit dhe marrjen e masave shtrënguese. Kredencialet e tilla duhet të përfshijnë referimin në legjislacionin në fuqi, duke përfshirë çdo veprim të deleguar për masat shtrënguese ndaj mospërputhjes me politikat dhe kërkesat kombëtare të sigurisë së aviacionit.

4.1.1 Ndarja e kompetencave/detyrave

Autoriteti i Aviacionit Civil ka për detyrë monitorimin e implementimit të PKSAC-së.

Menaxhimi, vendosja e prioriteteve dhe organizimi i Programit ndërmerren në mënyrë të pavarur nga sektorët specifikë të cilët trajtojnë sigurinë, përgjegjës për implementimin e masave të sigurisë sipas dispozitave të Programit.

4.2 Organizimi, përgjegjësitë dhe burimet

Autoriteti i Aviacionit Civil do të ketë struktura të specializuara të përbërë nga inspektorët/ audituesit e sigurisë, përgjegjës për kryerjen e aktiviteteve monitoruese dhe ndjekjen e procedurave të mëtejshme, siç përcaktohet më poshtë në këtë Program.

Në këtë kuadër, AAC-ja:

a) zhvillon dhe përditëson një plan vjetor të aktiviteteve monitoruese në bazë të vlerësimit të rrezikut. Ky vlerësim do të bazohet në rezultatet dhe procesin e korrigjimit të mangësive nga aktivitetet monitoruese të vitit paraardhës;

b) të ruajë listat e personave të kualifikuar për kryerjen e aktiviteteve të monitorimit;

c) të sigurojë që stafi i monitorimit të trajnohet në mënyrë të përshtatshme në lidhje me trajnimin fillestar, në vendin e punës, përsëritjen dhe specializimin në përputhje me planin e trajnimit i cili përcakton afatet kohore për zbatimin e programit të trajnimit;

d) të përcaktojë skedën e raportimit;

e) të caktojë personelin për secilin aktivitet monitorues;

f) të sigurojë personat përgjegjës për një aktivitet monitorimi me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm;

g) të mbajë të gjithë dokumentacionin që lidhet me aktivitetet e monitorimit duke përfshirë raportet, anekset etj.;

h) të sigurojë relevancën dhe standardizimin e formatit të raportimit;

i) të zhvillojë një raport vjetor të aktiviteteve të kontrollit të cilësisë, duke përmbledhur numrin dhe llojin e aktiviteteve të kontrollit të cilësisë të ndërmarra në vitin raportues, nivelin e pajtueshmërisë me kërkesat kombëtare të sigurisë së aviacionit, gjendjen e përgjithshme të mangësive të identifikuara, statusin aktual të veprimeve korrigjuese dhe statusin e burimeve financiare dhe njerëzore në lidhje me zbatimin e PKKCSAC-së;

j) të sigurojë marrjen e të gjitha planeve të masave korrigjuese dhe të sigurojë që menaxhohen në mënyrë korrekte gjatë gjithë ciklit; dhe

k) të prezantojë, sipas nevojës, modifikime të metodologjisë së standardizuar.

Autoriteti i Aviacionit Civil do të marrë masa, për:

a) sigurimin që burime të mjaftueshme njerëzore ofrohen për zhvillimin, zbatimin dhe përditësimin e programit, duke përfshirë burimet e mjaftueshme për menaxhimin dhe administrimin e tij dhe zbatimin e aktiviteteve të monitorimit në përputhje me operacionet aktuale të aviacionit civil;

b) burime materiale të mjaftueshme duhet të vihen në dispozicion nga AAC, për kryerjen e aktiviteteve të kontrollit të cilësisë dhe personat që kryejnë aktivitetet monitoruese. Shembujt përfshijnë pajisje të tilla si laptop, mobilje zyre, duke përfshirë njësitë e magazinimit adekuat për mbrojtjen e informacionit të ndjeshëm, artikujt e duhur të përcaktuar si pjesë të provës së fshehtë, dokumente dhe publikime, përfshirë legjislacionin dhe rregulloret ndërkombëtare, kombëtare dhe/ose rajonale material udhëzues si manuali i një inspektori dhe material udhëzuese.

4.2.1 Mekanizmat dhe metodat

Autoriteti i Aviacionit Civil siguron mekanizmat për të garantuar dhe krijuar kushtet dhe mundësitë e mjaftueshme për kryerjen e aktiviteteve të përmendura më lart.

4.3 Inspektorët/audituesit kombëtarë dhe kompetencat e tyre

a) Inspektori /audituesi kombëtar ka autoritet ligjor për të kryer detyrat, si dhe për të pasur akses në çdo pjesë të aeroportit dhe pjesëve ngjitur, me qëllim kryerjen, e:

- inspektimeve;
- auditimeve;
- studimeve;
- testimeve;
- hetimeve të sigurisë.

Përveç sa përshkruhen më lart, inspektorët/ audituesit kombëtarë të AAC-së kanë të drejtën e raportimit të mangësive dhe të kërkojnë korrigjimin e mangësive të identifikuara brenda afateve të përcaktuara.

b) Inspektorët /audituesit kombëtarë kanë të drejtën të ndalojnë operimin në çdo moment që e shikojnë se cenohen standardet e sigurisë, nëse vlerësohet se ky cenim rrezikon jetën e pasagjerëve apo të punonjësve të subjektit përkatës.

4.3.1 Autorizimi dhe ushtrimi i kompetencave të tyre

Inspektorëve/audituesve kombëtarë mbi bazën e përshkrimit të detyrave u mundësohet ushtrimi i kompetencave si më poshtë:

a) për të inspektuar një avion që është i regjistruar brenda shtetit ku ata kryejnë detyrën;

b) për të inspektuar një avion të një operatori të huaj kur operon brenda shtetit shqiptar;

c) për të kryer aktivitete monitorimi në çdo seksion apo pjesë të aeroportit;

d) për të kryer aktivitete monitorimi në çdo vend jashtë aeroportit ku aplikohen masa të sigurisë si p.sh. kompanitë që furnizojnë avionin me ushqime (furnizues të njohur të furnizimeve në fluturim), dërguesit e njohur, ngarkesat me mallra, vendet e regjistrimit jashtë aeroportit (*off airport check-in*);

e) për t'i kërkuar çdo operatori apo entiteti të përfshirë në sigurinë e aviacionit që të sigurojë informacion që mund të jetë i vlefshëm për aktivitetet e monitorimit;

f) për të regjistruar/ incizuar çdo lloj operimi, procedure apo instalimi, në formë të shkruar, fotografike apo çdo lloj forme tjetër elektronike. Për më tej, inspektorët/audituesit kombëtarë mund të mbajnë dhe të përdorin në zonat e kufizuara të sigurisë së aeroportit, çdo lloj pajisjeje e domosdoshme për kryerjen e detyrave të tyre duke përfshirë këtu, si p.sh., aparate fotografike, videokamera etj.

Përveç asaj që përshkruhet më lart, një inspektor/auditues kombëtar nga Autoriteti i Aviacionit Civil ka në kompetencë të tij/saj që të kërkojë korrigjim të menjëhershëm të mangësive të konstatuara, si dhe të ndërmarrë veprime zbatuese.

4.4 Entitet e tjera

Operatorët e aeroportit, subjektet e tjera, qofshin këto kontraktorë apo nën kontraktore që ofrojnë shërbime në aeroport (ato që merren me sigurin, si dhe ato që nuk merren me sigurinë), janë të detyruar të hartojnë dhe të mirëmbajnë një Program të Sigurisë, në përputhje me udhëzimet dhe dispozitat e Programit Kombëtar të Sigurisë. Këto programe dorëzohen pranë Autoritetit të Aviacionit Civil për miratim, dhe implementimi i tyre monitorohet në mënyrë të vazhdueshme nga AAC-ja.

Çdo operator i aeroportit duhet të planifikojë, zbatojë dhe mirëmbajë një program sigurie në të cilin do të përshkruhen metodat dhe procedurat të cilat duhet të ndiqen nga operatori i aeroportit, në mënyrë që të jetë në pajtueshmëri me PKSAC-në. Ky program duhet të përshkruajë metodat dhe procedurat të cilat duhet të ndiqen nga operatori i aeroportit, në mënyrë që të pajtohet me programin kombëtar të sigurisë së aviacionit civil në lidhje me operimet e tij në fushën e aviacionit civil. Programi duhet të përfshijë parashikime kontrolli të brendshëm të cilësisë që përshkruajnë se si

pajtueshmëria me këto metoda dhe procedura duhet të monitorohet nga operatori i aeroportit.

Sipas kërkesës, programi i sigurisë së operatorit të aeroportit duhet të paraqitet tek AAC-ja, e cila mund të ndërmarrë veprime të tjera aty ku nevojitet.

Çdo operator ajror duhet të planifikojë, zbatojë dhe mirëmbajë një program sigurie, në të cilin do të përshkruhen metodat dhe procedurat të cilat duhet të ndiqen nga operatorët ajrorë, në mënyrë që të jetë në pajtueshmëri me PKSAC-në. Ky program duhet të përshkruajë metodat dhe procedurat të cilat duhet të ndiqen nga operatorët ajrorë, në mënyrë që të pajtohet me programin kombëtar të sigurisë së aviacionit civil në lidhje me operimet e tij në fushën e aviacionit civil. Programi duhet të përfshijë parashikime kontrolli të brendshëm të cilësisë që përshkruajnë se si pajtueshmëria me këto metoda dhe procedura duhet të monitorohet nga operatorët ajrorë.

Sipas kërkesës, programi i sigurisë së operatorit ajror duhet të paraqitet tek Autoriteti i Aviacionit Civil (AAC), i cili mund të ndërmarrë veprime të tjera aty ku nevojitet.

Kur një program i një operatori ajror të licencuar dhe certifikuar në një nga shtetet e ZPEA-së është vlerësuar nga autoriteti përkatës i atij shteti, duke i dhënë licencën e operimit, operatori ajror do të njihet nga AAC-ja si një operator që i ka përmbushur kërkesat, sipas parashikimeve të Marrëveshjes shumëpalëshe. Kjo nuk cenon të drejtën e AAC-së të kërkojë nga ndonjë operator ajror detaje të zbatimit të:

a) masave të sigurisë të zbatuar nga ai shtet i ZPEA-se; dhe/ose

b) procedurat vendore që zbatohen në aeroportet ku operohet.

Çdo enti të cilit i kërkohet sipas Programit Kombëtar të Sigurisë së Aviacionit civil për të aplikuar standardet e sigurisë së aviacionit duhet të planifikojë, zbatojë dhe mirëmbajë një program sigurie. Ky program duhet të përshkruajë metodat dhe procedurat të cilat duhet të ndiqen nga entiteti, në mënyrë që të pajtohet me programin kombëtar të sigurisë së aviacionit civil në lidhje me operimet e tij në fushën e aviacionit civil. Programi duhet të përfshijë parashikime kontrolli të brendshëm të cilësisë që përshkruajnë se si pajtueshmëria me këto metoda dhe procedura duhet të monitorohet nga vet enti.

Sipas kërkesës, programi i sigurisë së entit duhet të paraqitet tek autoriteti përkatës (AAC), i cili mund të ndërmarrë veprime të tjera aty ku nevojitet.

Çdo subjekt që operon në fushën e aviacionit civil është i detyruar t'u përgjigjet të gjitha kërkesave të AAC-së në lidhje me aktivitetin e tyre në aeroport për çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë.

4.5 Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Autoriteti i Aviacionit Civil e konsideron të domosdoshëm kontrollin e brendshëm të cilësisë të entiteteve të përfshira në masat e sigurisë në aviacion për implementimin më të saktë dhe në mënyrë të vazhdueshme të këtyre masave.

Krahas aktiviteteve monitoruese që kryen AAC-ja, kjo e fundit imponon operatorët e aeroportit, operatorët ajrorë dhe entitetet e tjera që merren me masat e sigurisë, të aplikojnë dhe implementojnë në mënyrë vazhdueshme programe për kontrollin e brendshëm të cilësisë për të garantuar efikasitet dhe efektshmëri të masave të tyre të sigurisë si pjesë e gjithë sistemit të tyre të kontrollit të cilësisë.

Në fillim të çdo viti të ri, operatorët e aeroportit, operatorët ajrorë dhe entitetet e tjera të përfshira në çështje të sigurisë dhe që aplikojnë kontrollin e tyre të brendshëm të cilësisë, duhet të vënë në dispozicion të AAC-së rezultatet e kontrolleve të brendshme për vitin paraardhës, si dhe plan-veprimin e tyre në rast të konstatimit të mangësive apo të metave.

KREU V
KUALIFIKIMET, EMËRIMI DHE DETYRAT E INSPEKTORIT / AUDITUESIT KOMBËTARË

5.1 Inspektorët/audituesit kombëtarë

Aktivitetet e monitorimit dhe të zbatueshmërisë, të përshkruara në këtë Program, aplikohen vetëm nga inspektorët/audituesit kombëtarë të cilët janë të përzgjedhur sipas kritereve të përcaktuara nga AAC-ja. Statusi i inspektorëve/audituesve kombëtarë përfshin autoritetin ligjor për të ndërmarrë aktivitete monitoruese duke përfshirë këtu ndërmarrjen e veprimeve për zbatueshmërinë e sanksioneve dhe masave administrative.

Rishikimi i kritereve dhe përzgjedhja e personelit duhet të ndërmerret nga ose nën mbikëqyrjen e AAC-së.

Personeli i përfshirë në kryerjen e aktiviteteve monitoruese duhet të plotësojë kërkesat e kompetencës të përcaktuara në kriteret e përzgjedhjes, të kryejnë trajnime specifike dhe të kalojnë me sukses një provim lidhur me teknikat e përdorura në aktivitetet monitoruese.

Inspektorët/ audituesit duhet gjithashtu të kenë njohuri të mira të një nga gjuhët ICAO-s për të shpjeguar dhe zbatuar saktësisht materialin udhëzues të aneksit 17 të ICAO-s.

AAC-ja ndërmerr hapat e nevojshëm për të garantuar një numër të mjaftueshëm dhe eficientë të inspektorëve/ audituesve kombëtarë, të disponueshëm për të ndërmarrë dhe kryer të gjitha aktivitetet monitoruese.

5.2 Kriteret e nevojshme për kualifikim

Inspektorët/ audituesit kombëtarë, të cilët kryejnë detyrën në funksion të Autoritetit të Aviacionit Civil duhet të kenë njohuritë e duhura, të cilat duhet të përfshijnë përvojë teorike dhe praktike të mjaftueshme në fushën e sigurisë në aviacion, për të kryer aktivitetet monitoruese dhe për të ndërmarrë veprime për zbatueshmërinë e masave shtrënguese dhe sanksioneve.

Kualifikimet e kërkuara për kryerjen e monitorimit, përbëhen nga kriteret e mëposhtme:

a) një nivel të përshtatshëm arsimor, diplomë universitare;

b) njohuri të mira të rregulloreve kombëtare dhe ndërkombëtare, aneksin 17, si dhe një njohje të thellë të këtij programi;

c) njohje e mirë e operimeve të transportit ajror, duke përfshirë një ndërgjegjësim rreth mjedisit kërcënues;

d) njohje e mirë të praktikave, procedurave dhe pajisjeve të përdorura në zbatimin e masave të sigurisë së aviacionit;

e) atributet e duhura fizike, të tilla si shikimi dhe dëgjimi adekuat;

f) të mjaftueshme për të shkruar dhe për të folur, edhe të gjuhës angleze; dhe

g) aftësi të mjaftueshme ndër personale, të tilla si integriteti, diplomacia dhe përshtatshmëria;

h) njohuri të parimeve të monitorimit të pajtueshmërisë, procedurat dhe teknikat;

i) njohuri mbi rolin dhe kompetencat e audituesit;

j) certifikatë trajnimi si auditues kombëtar nga AAC-ja ose nga një organizatë e njohur ndërkombëtare.

Me qëllim për të verifikuar që aplikanti përmbush kushtet e mësipërme të vendosura për fazën e përzgjedhjes, një CV e detajuar e aplikantit duhet të dorëzohet pranë Autoritetit të Aviacionit Civil, në të cilën duhet të pasqyrohen të gjitha përvojat e mëparshme që dëshmojnë njohuri të sigurisë së aviacionit dhe përvojë të gjatë në kryerjen e aktiviteteve monitoruese të sigurisë.

5.3 Procesi i përzgjedhjes

Objektivat e procesit të përzgjedhjes janë për të garantuar që personat e përzgjedhur për të ndërmarrë aktivitete monitoruese për kontrollin e cilësisë në sigurinë e aviacionit, janë të përshtatshëm për t'u punësuar dhe gjithashtu, janë kompetent në kryerjen e detyrave në mënyrë efektive. Ky konsiderohet kriter themelor për ngritjen e nivelit të përbashkët të njohurive dhe komunikimit dhe për t'iu lejuar këtyre personave të ushtrojnë detyrat e tyre në mënyrë eficiente.

AAC-ja është përgjegjëse për procesin e përzgjedhjes së kandidatëve për inspektor/ auditues kombëtar, proces i cili ka si synim të përcaktojë nëse këta kandidatë përmbushin kriteret dhe kushtet themelore për të qenë inspektor/ auditues kombëtar.

Audituesit që kryejnë funksione në emër të AAC-së, duhet:

a) të jenë të lirë nga çdo detyrim kontraktor apo financiar me aeroportin, operatorët apo entitetin që monitorohet; dhe

b) të kenë kompetencat e përshtatshme, që përfshijnë eksperiencë të mjaftueshme teorike dhe praktike në fushën përkatëse.

Audituesi duhet të kryejnë trajnime të vazhdueshme në një frekuencë të tillë, të mjaftueshme për të siguruar që kompetencat ekzistuese të ruhen dhe kompetenca të reja përfitohen (të paktën një herë në dy vjet), duke pasur parasysh zhvillimet në fushën e sigurisë.

Autoriteti i Aviacionit Civil ka të drejtën ekskluzive ligjore për të refuzuar çdo aplikant që nuk përmbush plotësisht kriteret e mësipërme.

5.4 Trajnimi dhe emërimi i inspektorëve/ audituesve kombëtarë

Çdo person i zgjedhur në përputhje me kriteret e vendosura nga AAC-ja duhet të trajnohet nga AAC-ja ose një palë e tretë e miratuar, në përputhje me politikën dhe programin e trajnimit të përcaktuar nga AAC-ja. Politika e trajnimit duhet të angazhohet për të ofruar trajnime për të gjithë

inspektorët e sigurisë të aviacionit dhe duhet të adresojë:

a) trajnimi fillestar;

b) trajnim në vendin e punës;

c) trajnim periodike; dhe

d) trajnime të specializuara/teknike.

Instruktorët e certifikuar duhet të kenë përvojë adekuate për trajnim të sigurisë së aviacionit ose përvojë ekuivalente pune në fushën e kontrollit të cilësisë së sigurisë në nivel ndërkombëtar, rajonal ose kombëtar.

Objektivat e një kursi trajnimi fillestar të kontrollit të cilësisë duhet të jenë:

a) të promovojë një kuptim të përbashkët për të vlerësuar zbatimin e PKKCSAC-së;

b) të standardizojë praktikat e punës për të arritur qëllimet e PKKCSAC-së;

c) të sigurojë informacion dhe dokumentacion që lejon personelin e trajnuar për kryerjen e misioneve të tyre;

d) t'u ofrojë të trajnuarve aftësi të kontrollit të cilësisë, të tilla si njohuri të parimeve, procedurave dhe teknikave që lidhen me grumbullimin e informacionit përmes shqyrtimit të dokumentacionit, vëzhgimit të masave të sigurisë dhe intervistave të personelit; dhe

e) të sigurojë trajnime të posaçme në kryerjen e auditimeve të sigurisë, inspektimeve dhe testeve të fshehta/të hapura.

Trajnimi i kontrollit të cilësisë duhet të konsistojë gjithashtu në *trajnime-në-punë* të mbikëqyrura nga një inspektor kombëtar me përvojë, i emëruar si instruktor mbikëqyrës nga AAC-ja. Trajnimi i tillë duhet të përfshijë një ose më shumë aktivitete monitorimi gjatë së cilës trajnuesi duhet të demonstrojë një aftësi për të kryer detyrat. Performanca e kandidatit duhet të jetë nën kontroll të vazhdueshëm nga instruktori mbikëqyrës.

Personat që posedojnë një apo më shumë nga certifikatat e mëposhtme mund të konsiderohen të kualifikuar dhe që përmbushin kushtet e mësipërme për të qenë inspektor/auditues kombëtar:

a) inspektor i sigurisë së Aviacionit Civil;

b) auditues për sigurinë e Aviacionit Civil i/e certifikuar nga AAC-ja;

c) auditues për sigurinë i/e certifikuar nga Organizata Ndërkombëtare të Aviacionit Civil.

Si rrjedhim, personat e mësipërm zakonisht nuk është e nevojshme që të ndjekin të gjitha etapat e procesit të përshkruara më lart, duke përjashtuar rastet kur këta persona mund të kenë nevojën e rifreskimit të njohurive të tyre. Për këta persona, procedura konsiston vetëm në një intervistë me një përfaqësues të autoritetit dhe një auditues kombëtar të emëruar. Qëllimi i intervistës është vlerësimi i përshtatshmërisë së kandidatit dhe për të vendosur nëse ai/ajo ka nevojë t'i nënshtrohet trajnimit fillestar.

5.5 Përshkrimi i detyrave

Roli kryesor i inspektorëve/audituesve kombëtarë është implementimi i këtij Programi në përputhje të plotë me detyrat dhe përgjegjësitë e tyre. Pas programimit të aktiviteteve monitoruese, detyrat kryesore do të jenë:

a) planifikimi dhe përgatitja e aktiviteteve monitoruese;

b) mbledhja e informacionit të nevojshëm, në terren, me metodat e vëzhgimit, intervistimit, bisedave informale me punonjësit e sektorit ku planifikohet aktiviteti monitorues, rishikimi i dokumentacionit, dhe në raste të veçanta, mund të kryhet dhe test;

c) raportimi i rezultateve në formë të standardizuar, sipas shtojcës 1 të aneksit të këtij programi, në përputhje me kriteret dhe kërkesat e vendosura nga AAC-ja, si dhe evidenca/prova dokumentare që kërkohen (shih pikën "e" më poshtë);

d) implikimi në proceset e korrigjimit/ratifikimit të të metave dhe mangësive të konstatuara; dhe

e) sigurimi i gjithë informacionit të nevojshëm për AAC-në në mbështetje të marrjes së masave ndëshkimore ndaj shkelësve të përsëritur.

Personave të përfshirë në aktivitetet monitoruese duhet t'u kërkohet që të ruajnë konfidencialitetin e rreptë në lidhje me vëzhgimet dhe gjetjet e tyre. Një kod i sjelljes, që përcakton rregullat që duhet respektuar dhe detyrat që duhet të kryhen gjatë dhe pas një aktiviteti monitorues, duhet të dakordësohen nga secili pjesëmarrës para një aktiviteti.

KREU VI
AKTIVITETET OPERACIONALE TË MONITORIMIT

6.1 Administrimi në tërësi i programit

Autoriteti i Aviacionit Civil është përgjegjës për menaxhimin dhe administrimin në tërësi të këtij programi. Siç është shpjeguar dhe më lart, AAC-ja mund të përfshijë në procesin e tërësishëm të monitorimit dhe një pjesë të auditimeve të brendshme të kryera nga strukturat e operatorëve apo entiteteve të ndryshme të implikuara në masat për sigurinë e Aviacionit Civil.

6.2 Aktivitetet e planifikuara/të programuara

AAC-ja është përgjegjëse për të garantuar që aktivitetet monitoruese ndërmerren/ implementohen në mënyrë të rregullt dhe periodike. Në këtë kontekst, AAC-ja duhet të konsiderojë planifikimin paraprak të të gjitha aktiviteteve monitoruese që do të ndërmerren.

Çdo aktivitet monitorues duhet të verifikojë pajtueshmërinë rregullative me një ose më shumë aspekte të PKSAC-së, si:

a) organizimin e përgjithshëm të operatorit/ entit që vlerësohet;

b) statusi i operatorit të aeroportit, operatorit ajror dhe entiteteve të tjera (duke përfshirë edhe institucione të tjera qeveritare) përgjegjës për zbatimin e programeve të sigurisë dhe masave të sigurisë;

c) zbatimin e një programi të brendshëm të kontrollit të cilësisë dhe masave që lidhen me kontrollin e brendshëm të cilësisë;

d) funksionimin e komiteteve të sigurisë në aeroport;

e) masat që lidhen me: kontrollin e hyrjes, duke përfshirë kontrollet e sigurisë ndaj zonave të kufizuara të sigurisë; personelin e aeroportit dhe sistemeve të kalimit të automjeteve; kontrollet e pastërtisë së figurës të personelit të sigurisë dhe personave të tjerë përveç pasagjerëve që kanë akses të pashoqëruar në zonat e kufizuara të sigurisë; sigurinë e avionëve, duke përfshirë mbrojtjen e avionëve dhe kontrollet dhe kërkimet e sigurisë së avionëve; skanimin dhe kontrollin e personave të tjerë përveç pasagjerëve, së bashku me artikujt e transportuar përpara hyrjes në zonat e kufizuara të aeroportit; kontrolle të tjera të përshtatshme të sigurisë për automjetet që u jepet akses në zonat e kufizuara të sigurisë, së bashku me artikujt që përmbajnë ato; pasagjerët, skanimi dhe mbrojtja e bagazheve të kabinës; kategori të veçanta udhëtarësh; mbikëqyrjen dhe mbrojtjen e bagazheve; operatorët ajrorë, dyqanet dhe furnizimet; operatorëve të pastrimit të avionëve, dyqanet dhe furnizimet; operatorit të avionëve për postë dhe materiale; kargo, postë dhe mallra të tjerë, duke përfshirë sigurimin e zinxhirit të furnizimit dhe lëshimin e statusit të sigurisë për kargo dhe postë; masat e sigurisë për operimet e brendshme, nëse është e aplikueshme; sigurisë në tokë dhe shqyrtimin e sigurisë në projektimin dhe infrastrukturën e aeroportit;

f) masat specifike të sigurisë të bazuara në një vlerësim të riskut të sigurisë të kryer nga autoritetet përkatëse kombëtare për të zbutur kërcënimin;

g) reagimi ndaj akteve të ndërhyrjes së paligjshme, duke përfshirë ushtrimet në shkallë të plotë dhe të pjesshme të sigurisë;

h) trajnimi i personave që zbatojnë kontrollet e sigurisë, duke përfshirë certifikimin e operatorëve të skanerit dhe instruktorëve; dhe

i) burime mbështetëse dhe pajisjet që kërkohen nga shërbimet e sigurisë të aviacionit, duke përfshirë mirëmbajtjen dhe testimin e performancës së pajisjeve të sigurisë.

6.3 Aktivitetet monitoruese

Autoriteti i Aviacionit Civil kryen këto veprime:

a) auditime të sigurisë;

b) inspektime të sigurisë;

c) studime/anketime/sondazhe të sigurisë;

d) testime të sigurisë;

e) hetime të sigurisë.

6.4 Veprimet monitoruese që ndërmarrin operatorët

Monitorimi i aktiviteteve, të implementuara nga operatorët apo edhe ndonjë entitet tjetër i përfshirë në sigurinë e Aviacionit Civil, duhet të ndjekë të njëjtat parime që ndiqen nga AAC-ja. Programimi i këtyre aktiviteteve monitoruese është e drejtë ekskluzive e tyre për t'i përcaktuar.

Operatorët apo entitetet e tjera që ndërmarrin masa të sigurisë, janë të detyruar që të dërgojnë pranë AAC-së programet e tyre vjetore, në përputhje me kriteret e vendosura nga AAC-ja, për të evidentuar që detyrimet e tyre në termat e kontrollit të brendshëm të cilësisë janë përmbushur.

Një raport përmbledhës i aktiviteteve monitoruese nga operatorët dhe entitetet e tjera

duhet t'i përcillet AAC-së jo më vonë se një muaj pas një periudhe operacionale një vjeçare në aeroport.

6.5 Metodologjia e përgjithshme

Standarde të përbashkëta mund të hartohen dhe implementohen, pavarësisht kategorive të ndryshme të aktiviteteve monitoruese të përputhshmërisë.

Cilado që të jetë sfera e aktivitetit monitorues, duhet të kryhet duke iu referuar implementimit të një apo më shumë aspekteve të rregulloreve kombëtare, Programit Kombëtar të Sigurisë së Aviacionit Civil dhe politikave rrjedhëse. Në çdo rast, aktiviteti monitorues duhet të mbulojë një apo më shumë nga aspektet e mëposhtme:

a) organizimi në tërësi i entitetit nën monitorim (d.m.th., Programin dhe Komitetin Aeroportual të Sigurisë, Planin Aeroportual të Emergjencës, trajnimi dhe rekrutimi i personelit etj.);

b) sigurinë e aeroportit (masat e sigurisë në pikat e hyrjes);

c) sigurinë e avionit;

d) bagazhet e pasagjerëve: të kabinës dhe të hambarit të avionit;

e) kontrolli dhe mbrojtja e bagazheve;

f) bashkërendimi pasagjerë/bagazh;

g) kargon dhe postën ajrore;

h) shërbimi postar;

i) materialet dhe posta e operatorit me destinacion stacionet brenda rrjetit të tij të operimit (*co-mail* dhe *co-mat*);

j) shërbimi ushqimor, magazinat dhe furnizimet e ndryshme;

k) shërbimi i pastrimit të avionit, magazinat dhe furnizimet e ndryshme për këtë qëllim;

l) menaxhimi i situatës në rastet e akteve të ndërhyrjeve të paligjshme në Aviacionin Civil.

m) Qendra e Kontrollit të Trafikut Ajror (ATC), kontrolli i aksesit në ambientet e qendrës, procedurat në rast peng marrjeje etj.

Për sa i përket dokumentacionit referues, të gjitha aktivitetet monitoruese u referohen ligjeve në fuqi, akteve nënligjore, rregulloreve dhe programeve të sigurisë.

6.6 Mbledhjet/takimet

Në rastet kur konsiderohet e domosdoshme, aktivitetet e lajmëruara mund të përfshijnë një apo më shumë takime/mbledhje në fillim të aktivitetit në terren, për të prezantuar dhe për të shpjeguar metodologjinë, për të finalizuar agjendën e propozuar dhe për të marrë shpjegimet e nevojshme për ndonjë informacion të paqartë.

Në një situatë të tillë, mund të organizohen takime të tilla si më poshtë:

a) një takim paraprak dhe parapërgatitor me drejtuesit e nivelit të lartë të subjektit që do t'i nënshtrohet monitorimit; dhe

b) si një variant i dytë, nëse konsiderohet i domosdoshëm, një takim parapërgatitor për shkëmbim opinionesh apo informacioni, me një panel më të zgjeruar duke përfshirë ente të tjera rregullatore. Të dyja, "a" dhe "b" mund të kombinohen me njëra-tjetrën.

6.7 Seancat shpjegimore dhe raportimi

Në fund të aktivitetit/ veprimtarisë monitoruese, një seancë shpjeguese duhet të zhvillohet me qëllim paraqitjen/prezantimin e gjetjeve/konstatimeve, si dhe theksimin e masave shtrënguese në rastet e mos ratifikimit dhe mos korrigjimit të mangësive të konstatuara. Objektivi është për të siguruar personat dhe entitetet në fjalë që kanë kuptuar nivelin e tyre të përputhshmërisë me Programin Kombëtar të Sigurisë së Aviacionit Civil. Përmbajtja, audienca dhe kohëzgjatja e seancës shpjeguese janë në varësi të numrit të aktiviteteve monitoruese që ndërmerren dhe llojit/tipit të mangësive të konstatuara.

Pas seancës shpjeguese, një raport me mangësitë përkatëse duhet të përgatitet dhe dërgohet entit të kontrolluar për një periudhë jo më shumë se dy javë. Ky raport duhet të përfshijë: përshkrimin e aktivitetit monitorues të kryer, konstatimet dhe të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me procedurat e ratifikimit të mangësive dhe sanksioneve në rastet e mosratifikimit të mangësive të konstatuara, nëse konsiderohet e domosdoshme.

6.8 Përbërja e grupit të monitorimit

Në varësi të sferës së aktivitetit monitorues të përputhshmërisë, një grup i inspektorëve/ audituesve kombëtarë emërohet nga AAC-ja. Secili grup udhëhiqet nga një inspektor/auditues kombëtar me përvojën më të gjatë, përgjegjës për përgatitjen dhe menaxhimin e aktiviteteve monitoruese. Përgjegjësi i këtij grupi duhet të jetë nga AAC-ja.

6.9 Klasifikimi i përputhshmërisë

Klasifikimi i mëposhtëm për përputhshmërinë duhet të aplikohet për të bërë vlerësimin e implementimit të Programit Kombëtar të Sigurisë së Aviacionit Civil:

	Auditimi i sigurisë	Inspektimi i sigurisë	Testimi i sigurisë
Papajtueshmëri e lartë (kategori 1)	✓	✓	✓
Papajtueshëri e ulët (kategori 2)	✓	✓	✓
Në përputhje, por kërkohet Përmirësim (kategori 3)	✓	✓	✓
Në përputhje të plotë (kategori 4)	✓	✓	✓
Nuk aplikohet	✓	✓	✓
Nuk konfirmohet	✓	✓	✓

KREU VII
AKTIVITETET E TRAJTIMIT TË MANGËSIVE DHE MASAT KORRIGJUESE

7.1 Kuadri ligjor

Autoriteti i Aviacionit Civil ka forcë ligjore dhe kompetencë për ndjekjen e zbatimit të masave korrigjuese dhe marrjen e masave shtrënguese për të kërkuar apo detyruar entitetet me mangësi të konstatuara, që këto të fundit të korrigjohen brenda afateve kohore të përcaktuara. Kjo forcë ligjore garantohet dhe mbrohet nga ligjet dhe rregulloret në fuqi si më poshtë:

a) ligji nr. 96/2020, "Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë";

b) vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1115, nr. 1115, datë 24.12.2020, "Për miratimin e Programit Kombëtar të Sigurisë së Aviacionit Civil".

Autoriteti i Aviacionit Civil ka fuqinë ligjore për vendosjen e sanksioneve të karakterit administrativ, përfshirë ndëshkimin me gjobë, për kundërvajtjet që nuk përbëjnë vepër penale. Mekanizmi i sanksioneve bazohet në:

- ligjin nr. 96/2020, "Për Kodin Ajror të Republikës së Shqipërisë", (neni 160);
- urdhrin në fuqi të ministrit përgjegjës për transportit ajror, "Për procedurën dhe funksionimin e Komisionit të Shqyrtimit të Kundërvajtjeve Administrative në fushën e Aviacionit Civil".

Në rastet kur konstatohet mangësi në lidhje me përputhjen me Programin Kombëtar të Sigurisë së Aviacionit, masa duhet të jetë e tillë që të detyrojë entitetin në fjalë që të korrigjojë mangësitë në mënyrë të menjëhershme.

Sidoqoftë, në shumë raste, korrigjimi i të gjitha mangësive të konstatuara kërkon më shumë kohë dhe nuk mund të arrihet në mënyrë të menjëhershme. Si pasojë, entitetit i kërkohet që të dorëzojë pranë AAC-së një plan-veprimi brenda dy javësh nga marrja e Raportit nga AAC-ja, në të cilin të adresohen të gjitha mangësitë e konstatuara dhe të përcaktohen afatet kohore për korrigjimin e tyre. Pas miratimit të planit të veprimit për korrigjimin dhe përmirësimin e të metave të konstatuara, AAC-ja monitoron zbatimin e veprimeve korrigjuese. Në varësi të implementimit efikas dhe cilësor të veprimeve korrigjuese, AAC-ja vendos nëse duhet të merren masa apo sanksione të mëtejshme. Në raste kur masat e sigurisë nuk zbatohen si rezultat i neglizhencës nga ana e operatorit, masat administrative janë të pashmangshme.

7.2 Procesi i korrigjimit dhe etapat e këtij procesi

Një proces me etapat e tij specifike ndërtohet në lidhje me aktivitetin e korrigjimit të mangësive të konstatuara, si dhe me masat ndëshkimore administrative apo gjyqësore. Ky proces konsiston në 4 etapa të cilat janë:

a) këshillim dhe bindje;

b) paralajmërim formal;

c) ndëshkim me gjobë;

d) kallëzim penal.

7.3 Këshillim dhe bindje

Objektivi i kësaj etape është shpjegimi në mënyrën më të dobishme dhe informuese tek operatori apo entiteti në fjalë se si ka dështuar në përmbushjen e detyrimeve të tij dhe diskutimi mbi format apo mënyrat me anë të të cilave mangësitë e konstatuara mund të korrigjohen brenda afateve kohore të pranueshme.

Kjo procedurë aplikohet vetëm për mangësi apo të meta të vogla dhe si masë e parë për korrigjimin e tyre.

Bazuar në procedura, një takim apo një mbledhje shpjeguese verbale zhvillohet me përfaqësuesit e operatorit apo entitetit në fjalë. Takimi duhet të regjistrohet (këshillimet e bëra dhe veprimet e ndërmarra, sugjerimet e dhëna etj.), që në rast se situata/problemi përshkallëzohet, atëherë ka prova zyrtare të mjaftueshme për veprimet e ndërmarra apo këshillimet e dhëna.

7.4 Paralajmërimi formal

Objektivi i këtij paralajmërimi është përshkrimi në mënyrë të saktë dhe të detajuar i aspektit/ fushës/ lëndës në të cilën operatori apo entiteti ka dështuar në përmbushjen e detyrimeve të tij, dhe t'i kujtojë operatorit apo entitetit në fjalë detyrimet e tij ligjore për korrigjimin e mangësive të konstatuara brenda afateve kohore të përcaktuara.

Kjo procedurë aplikohet për mangësi serioze si hap i parë ose për mangësi më të vogla, por që "këshillimi dhe bindja" nuk kanë dhënë efekt.

Bazuar në procedura, drejtuesve të lartë të operatorit apo entitetit në fjalë u dërgohet zyrtarisht një dokument i shkruar, i cili përmban përshkrimin e hollësishëm të mangësive, masat/ veprimet që duhet të ndërmerren, si dhe i kërkon konfirmimin për korrigjimin e këtyre mangësive. Për çdo veprim apo masë të ndërmarrë, duhet të regjistrohet dhe të ruhet që në rast se problemi përshkallëzohet, ekzistojnë prova zyrtare për veprimet apo masat e marra.

7.5 Ndëshkimi me gjobë

Qëllimi është që t'i kërkohet operatorit apo entitetit në fjalë të ndërmarrë veprime apo masa korrigjuese bindëse brenda afateve kohore të përcaktuara nga AAC-ja.

Kjo procedure aplikohet për rastet me mangësi serioze pas dhënies së paralajmërimit formal i cili nuk kanë dhënë efekt, ose për raste të mangësive shumë serioze si hap i parë. Ndëshkimi me Gjobë duhet të konsiderohet si hap apo etapë e fundit para procedimit ligjor.

Bazuar në procedura, një dokument ligjor zyrtar u dërgohet drejtuesve më të lartë të operatorit apo entitetit në fjalë.

Në rast kur operatori nuk merr masa për korrigjimin e mangësive apo nuk kontakton AAC-në brenda afateve kohore, AAC-ja ka të drejtën e ndëshkimit me gjobë.

Operatori i audituar/ inspektuar duhet të njoftojë AAC-në me shkrim brenda 15 ditëve në lidhje me masat e marra nga ana e operatorit apo me komentet nga data e marrjes së raportit të auditimit/inspektimit nga AAC-ja.

7.6 Kallëzim penal

Për sa i përket procesit të korrigjimit të mangësive dhe procesit të masave për zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve, kallëzimi penal konsiderohet si masë e fundit, që i dedikohet dështimeve dhe shkeljeve më të rënda dhe në vazhdimësi të ligjeve dhe rregulloreve kombëtare. Kur ekzistojnë prova të mjaftueshme që një operator ka dështuar në përmbushjen e detyrimeve ligjore pas ndëshkimit me gjobë dhe nuk ka korrigjuar mangësitë, atëherë AAC-ja bën kallëzim penal për operatorin apo entitetin në fjalë duke dërguar të gjithë dokumentacionin pranë institucionit të Prokurorisë së Rrethit për procedim penal.

KAPITULLI 8
KOMUNIKIMI DHE RAPORTIMI

8.1 Komunikimi i brendshëm

Autoriteti i Aviacionit Civil raporton dhe komunikon rregullisht për arritjet e këtij Programi. Bazuar në këtë perspektivë, përgatitet një raport vjetor që shtjellon statusin e kryerjes të aktiviteteve monitoruese, i cili mund të përfshijë një përmbledhje të përgjithshme të konstatimeve. Raporti përfshin një analizë të shkaqeve dhe modeleve/shembujve të mospërputhjes apo shkeljeve, si dhe një vlerësim të efikasitetit të masave korrigjuese që janë ndërmarrë gjatë aktiviteteve monitoruese.

8.2 Sistemi i jashtëm i raportimit

Me qëllim mbështetjen e këtij programi, AAC-ja duhet të krijojë një mekanizëm për të mbledhur dhe analizuar informacion mbi sigurinë, informacion ky i siguruar nëpërmjet burimeve të ndryshme, si p.sh., pasagjerët, ekuipazhet, personeli në tokë etj. Ky mekanizëm garanton konfidencialitetin e personave dhe entiteteve që sigurojnë informacion të tillë.

ANEKSI A
METODOLOGJIA E NJË AUDITIMI TË SIGURISË

1. Përkufizimi dhe objektivat e auditimit

Një auditim i sigurisë është një ekzaminim i hollësishëm i të gjitha aspekteve të procedurave dhe masave të sigurisë me qëllim për të përcaktuar nëse këto masa dhe procedura janë implementuar në vazhdimësi dhe në standardet e kërkuara.

Objektivat e auditit të sigurisë janë si më poshtë:

a) analizimi i implementimit efektiv dhe eficient i Programit Kombëtar të Sigurisë së Aviacionit Civil, si dhe për të garantuar që masat dhe procedurat e kërkuara në sigurinë e aviacionit civil

janë implementuar në vazhdimësi dhe në mënyrë standarde.

b) identifikimi për ndonjë të metë apo mangësi në masat dhe procedurat e sigurisë së aviacionit dhe për të garantuar korrigjimin e tyre;

Për të identifikuar fushat ku nevojitet përmirësim dhe t'i garantohet subjektit nën auditim këshillim dhe ekspertizë teknike

2. Përshkrimi

Sipas përkufizimit, një auditim i sigurisë duhet të përfshijë, në masën që lejon ligji, të gjitha aspektet e masave dhe procedurave të sigurisë që mbulon Programi Kombëtar i Sigurisë së Aviacionit Civil. Për rrjedhojë, auditimi duhet të aplikohet kryesisht në aeroporte, dhe monitorimi nuk mund të kufizohet/përqendrohet në një fushë të caktuar apo një sferë/lloj të caktuar operimi etj.

Si pasojë, kjo kategori e aktiviteteve monitoruese do të kërkonte një periudhë më të zgjatur kohore (d.m.th. numër ditësh, javësh dhe ndoshta dhe muajsh).

Një auditim i sigurisë duhet të njoftohet paraprakisht. Kështu që një njoftim paraprak të paktën 10 ditë përpara fillimit duhet t'i dërgohet subjektit që do t'i nënshtrohet auditimit. Një përfaqësues i subjektit duhet gjithmonë të shoqërojë grupin e auditimit.

Një auditim i sigurisë nuk përfshin ndonjë testim (shih aneksin E).

2.1 Sfera e auditimeve

Auditimet duhet të ekzaminojnë, brenda normave të lejuara, implementimin e të gjitha aspekteve të Programit Kombëtar të Sigurisë së Aviacionit Civil, duke përfshirë politikat tek të cilat ato janë bazuar. Me qëllim arritjen e objektivit, një auditim duhet të jetë sa më i hollësishëm që të jetë e mundur. Për pasojë, një auditim duhet të mbulojë minimalisht aspektet/fushat e mëposhtme:

- organizimin në tërësi të subjektit (p.sh. Programin dhe Komitetin Aeroportual të Sigurisë; ndarja e përgjegjësive për implementimin; plani aeroportual i kontigjencës; trajnimi dhe rekrutimi i stafit);
- sigurinë në aeroport;
- sigurinë e avionit;
- pasagjerët dhe bagazhet e tyre të kabinës;
- bagazhet e hambarit;
- dërgesat postare, shërbimi "korrier" dhe pakot "ekspres";
- kargoja dhe posta ajrore;
- materialet e transportuesit ajror (*co-mail dhe co-mat*);
- materialet e pastrimit, magazinat dhe furnizimet me këto materiale;
- furnizimet ushqimore, magazinat dhe artikuj të kësaj natyre;
- aviacioni i përgjithshëm;
- menaxhimi i përgjigjes kundrejt akteve të ndërhyrjes së paligjshme në Aviacionin Civil.

Për sa kohë që auditimi do të kryhet në një shtrirje kohore relativisht të gjatë, audituesit duhet të përpiqen maksimalisht të verifikojnë nëse masat dhe procedurat e sigurisë nën monitorim/vëzhgim janë implementuar:

- Në mënyrë të vazhdueshme/të përhershme (në regjistrat e posaçëm të rekordeve, rekordet e trajnimit etj.);
- Në formë standarde të njëjtë: si praktikë e mirë mund të konsiderohet vëzhgimi i një operimi në dy momente të ndryshme të ditës; njëri moment mund të jetë skanimi i pasagjerëve dhe momenti tjetër bashkërendimi i pasagjerëve me bagazhet.

2.2 Autoriteti dhe kompetencat e audituesve të sigurisë në aviacion

Si audites kombëtar, audituesit e sigurisë kanë kompetenca të ndërthurura, duke përfshirë mundësinë, që:

- të kryhet inspektimi i një avioni të regjistruar në atë shtet ku kryhet auditimi;
- të kryhet inspektimi i një avioni që operon në shtetin ku kryhet auditimi;
- të vëzhgojë në çdo seksion të aeroportit;
- të kryhen vëzhgime kur në vendndodhjen e çdo aeroporti aplikohen masa të sigurisë, (kompaninë e ushqimeve, dërguesin e njohur, transportuesin e mallrave, agjentin e rregullt, si dhe regjistrimin në hotel *(check-in)*;
- t'i kërkojë një operatori ajror, një drejtuesi aeroporti apo edhe ndonjë entiteti tjetër të implikuar në çështje të sigurisë, për të dhënë informacion të vlefshëm për qëllime monitorimi;
- regjistrojë çdo operim, procedure apo instalim, në formë të shkruar, të fotografuar apo dhe elektronike. Përveç këtyre, auditët kombëtarë duhet të kenë të mundur që të përdorin në zonat e kufizuara të sigurisë çdo lloj mjeti pune, aparature apo ndonjë pajisje tjetër që është e domosdoshme për përmbushjen e detyrave, duke përfshirë aparate fotografike, regjistrues video, pamje filmike gjatë

operimit, rekorde nga CCTV në periudha të ndryshme etj.

Përveç sa u përmend më lartë, audituesit e sigurisë kanë kompetencë, për të:

- kërkuar korrigjim/riparim të menjëhershëm të mangësive;
- lëshuar njoftime të zbatimit të detyrueshëm;
- ndaluar/izoluar një avion për qëllim inspektimi.

Aktivitete auditimi duhet të ndërmerren në çdo kohë, duke përfshirë këtu festat publike, fundjavat apo dhe gjatë orëve të "qeta" (d.m.th., pa shumë aktivitet apo dyndje).

Në vijim të kompetencave ligjore të audituesve të sigurisë, do të përbënte një shkelje, nëse:

- audituesi në mënyrë të qëllimshme dëmton ose ndërpret punën e auditit të sigurisë;
- refuzohet t'i jepet informacion një audituesi kombëtar të sigurisë;
- i jepet informacion të rremë apo shkatërrues një audituesi kombëtar të sigurisë;
- një punonjës hiqet si audites sigurie kur nuk është i tillë (audit i rremë).

2.3 Kryerja e auditimit

2.3.1 Hapat kryesorë të procesit të auditimit

Siç është përshkruar në kapitullin 6, procesi në tërësi i auditimit duhet të përmbajë elementet e mëposhtme:

- takime me përfaqësues të aeroporteve, operatorëve ajrorë etj., para fillimit të aktivitetit të monitorimit në terren;
- aktivitete operacionale të monitorimit: mbledhja e informacionit në terren;
- shkëmbimi i informacionit dhe raportimi;
- njoftimin e kryerjes së auditimit së paku 10 ditë para dhe dërgimin e pyetësorit paraauditimit (nëse aplikohet);
- faza përgatitore që përfshin analizimin e pyetësorit paraauditimit (nëse aplikohet) dhe dokumentacionit të nevojshëm;
- takimi hapës me përfaqësuesit e aeroportit, operatorit ajror apo entiteti që do të monitorohet, përpara kryerjes së aktivitetit mbikëqyrës;
- aktiviteti mbikëqyrës në terren;
- takimi mbyllës me prezantimin e rezultateve të aktivitetit dhe raportimi;
- në rast se janë konstatuar mangësi, ndjekja e procesit të korrigjimit të mangësive.

Kryerja e auditimit të sigurisë do të përqendrohet në mbledhjen sistematike të informacionit sipas metodave:

- shqyrtimit të dokumentacionit;
- vëzhgimeve në terren;
- intervistimit;
- verifikimeve.

Një auditim i sigurisë nuk përmban testim për sigurinë.

Një auditim i sigurisë duhet të bazohet në mbikëqyrjen e zbatimit të masave të sigurisë në aeroport, me sa më pak paragjykim që të jetë e mundur me qëllim që grupi i auditimit të jetë sa më objektiv.

2.3.2 Detyrat e audituesve kombëtarë

Audituesit kombëtarë i kanë të gjitha kushtet dhe mundësitë për kryerjen e detyrave të tyre. Sidoqoftë, ata duhet të marrin parasysh disa elemente, në mënyrë që të shmanget apo minimizohet ndërhyrja/interferenca në aktivitetin operacional të aeroportit, transportuesit ajror, subjekteve të tjera që operojnë në fushën e sigurisë. Për rrjedhojë, gjatë kryerjes së një auditimi të sigurisë, është detyrë e audituesve të sigurisë që:

a) të vëzhgojnë kriteret e sigurisë në aeroport (duke përfshirë operatorët ajrorë dhe ndërmarrjet e tjera të përbashkëta), dhe të shfrytëzojë rrugët e posaçme të aksesit dhe të daljeve, dhe të jenë gjatë gjithë kohës të shoqëruar me shoqërues të akorduar nga autoritetet vendore;

b) të zbatojnë të gjitha rregullat e sigurisë;

c) të mos përdorin forcë për të garantuar aksesin tek avioni, godinat, punimet apo te sipërfaqja tokësore;

d) të mos hapin dyert e jashtme të avionit, të mos prekin me dorë asnjë nga dyert e jashtme apo të futen brenda në avion përveç rasteve kur janë të shoqëruar nga përfaqësuesit e duhur të operatorit ajror;

e) të mos ngasin automjete në zonën ajrore, pa autorizimin e domosdoshëm;

f) të mos përdorin/shfrytëzojnë kompetencat për të vonuar apo izoluar një avion përveç rasteve kur ka arsye të forta për të ndërmarrë një veprim të tillë (në raste të tilla, një bashkëpunim i plotë i autoriteteve të aeroportit dhe operatorëve duhet të zhvillohet);

g) të marrin të gjitha masat e arsyeshme për të mos tërhequr në mënyrë të panevojshme

personelin nga detyrat e tyre primare gjatë kryerjes së intervistave.

Në situata të emergjencës, p.sh. pengmarrje e avionit apo kërcënimi për bombë, procesi i auditimit pezullohet sipas kërkesës së autoriteteve ligjzbatuese.

Për të shmangur keqkuptimet mbi rolin e grupit të auditimit, audituesit e sigurisë nuk duhet këshillojnë, korrigjojnë apo udhëzojnë personelin gjatë procesit të auditimit, në veçanti personelin e sigurisë. Sidoqoftë, nëse konsiderohet e domosdoshme, audituesit duhet të informojnë supervizorët në lidhje me të metat e konstatuara, kjo në bashkëpunim me autoritetet lokale.

Përveç kësaj, ata nuk duhet të ndërmarrin ndonjë veprim të karakterit operacional, si p.sh., të merren me pasagjerët, me personelin apo të ndihmojnë trafikun.

Audituesit nuk duhet të jenë asnjëherë dhe për asnjë moment të pashoqëruar gjatë kryerjes së detyrës së tyre të auditimit.

2.4 Mangësitë/të metat

"Mangësi" ose "e metë" do të thotë një mospërputhje me kërkesat dhe dispozitat e Programit Kombëtar të Sigurisë së Aviacionit Civil.

Objektivi thelbësor i një auditimi të sigurisë është identifikimi e mangësive dhe adresimi i tyre në mënyrën e duhur.

Ka dy mënyra për informimin e përfaqësuesve të entiteteve që janë objekt i auditimit:

- komunikimi verbal në terren gjatë një seance postaudit;
- raportet me shkrim në të cilët paraqiten më të detajuara mangësitë konstatuara.

Për të analizuar nivelin e përputhshmërisë së procedurave dhe masave të sigurisë me dispozitat e Programit Kombëtar të Sigurisë së Aviacionit, të observuara gjatë auditimit, grupi i auditit do të përdorë sistemin e vlerësimit të përshkruar në kapitullin 6, për të përcaktuar:

- **në përputhje të plotë (kategori 4)**: që do të thotë se nuk është konstatuar asnjë mangësi. Fusha/aspekti i analizuar përmbush plotësisht kërkesat dhe dispozitat e Programit Kombëtar të Sigurisë;
- **në përputhje, por kërkohet përmirësim (kategori 3)**: që do të thotë se nuk është konstatuar asnjë mangësi. Fusha/aspekti i analizuar përmbush kërkesat dhe dispozitat e Programit Kombëtar të Sigurisë. Sidoqoftë, megjithëse asnjë masë zbatuese nuk ndërmerret, përmirësimi është i dëshirueshëm dhe praktikat më të mira duhet të konsiderohen;
- **papajtueshmëri e ulët (kategori 2)**: që do të thotë se janë konstatuar mangësi të vogla. Një konstatim i tillë përfaqëson një fushë/aspekt të vogël që kërkon korrigjim dhe përmirësim. Në këtë rast veprimi korrigjues duhet të ndërmerret nga entiteti i audituar për të riparuar apo korrigjuar mangësinë apo mangësitë e konstatuara. Masat për zbatueshmërinë mund të konsiderohen;
- **papajtueshmëri e lartë (kategori 1)**: që do të thotë se mangësi janë konstatuar serioze. Në ndryshim nga rasti i mësipërm, ky rast paraqet një mangësi serioze dhe mospërputhje me standardet e sigurisë të përshkruara në Programin Kombëtar të Sigurisë, dhe si i tillë ka ndikim të madh dhe të drejtpërdrejt në siguri. Për këtë rast, masa shtrënguese të zbatueshmërisë, në raport të njëjtë me rëndësinë dhe përmasat e shkeljes së procedurave të sigurisë, duhet të ndërmerren;
- **nuk konfirmohet**: që do të thotë një objekt i paverifikuar apo i paverifikueshëm (p.sh. kontrolli i dokumentacionit), ose i pavëzhguar (masë sigurie).
- **"nuk aplikohet"**: që do të thotë një masë apo procedure e sigurisë nuk ekziston ose nuk /aplikohet nga entiteti nën auditim (p.sh. regjistrimi jashtë aeroportit (*off-airport check-in*).

3. Raportimi dhe procedurat pas auditimit

3.1 Raportimi

Siç është shpjeguar dhe më lart, ecuria e auditimeve duhet të raportohet sipas mënyrës së interpretimit verbal përmes një seance shpjegimore "post audit" dhe raportimit me shkrim.

Pas përfundimit të auditimit, organizohet një seancë dëgjimore shpjeguese me përfaqësuesit e lartë të entitetit që është audituar. Gjatë këtij takimi, audituesit do të paraqesin konstatimet, pozitive dhe negative, dhe theksi vihet tek aspektet apo fushat e mospërputhjes që ndiqen nga aktet për zbatueshmërinë e dispozitave për sigurinë.

Pas kësaj faze, hartohet një raport i detajuar me konkluzionet përkatëse. Në këtë raport do të përfshihen të gjitha konstatimet e hasura, si dhe i tërë informacioni në lidhje me procedurat mbi korrigjimin e mangësive të konstatuara dhe masave shtrënguese për zbatueshmërinë, nëse konsiderohet e pashmangshme.

Raporti duhet të përmbajë dhe një përshkrim të shkurtër të objektivit të masave dhe procedurave të

sigurisë, të monitoruara nga grupi i auditimit. Në rastet kur hasen mangësi serioze audituesit kërkojnë korrigjim të menjëhershëm. Forma standarde e raportit të aktiviteteve monitoruese është detajuar në shtojcën nr. 1.

3.2 Raporti i kontrollit

a) Brenda 4 javësh nga përfundimi i auditit, operatorit të inspektuar i duhet paraqitur nga AAC-ja një raport auditi.

b) Raporti do të përmbajë gjetjet dhe mangësitë që kanë rezultuar gjatë auditit dhe mund të përmbajë rekomandime për veprime korrigjuese.

3.3 Procedurat pas auditimit

Entitetit do t'i kërkohet që të dorëzojë pranë AAC-së një plan veprimi për të adresuar mangësitë e konstatuara të përshkruara në raportin e auditimit, brenda një afati jo më të gjatë se 15 ditë nga marrja e raportit. Së bashku me korrigjimet e bëra, një afat kohor për implementimin e masave të propozuara, në formën e një programi, duhet të përcaktohet dhe të dorëzohet tek AAC-ja për miratim. Në varësi të aprovimit të programit dhe agjendës së tij përkatëse, AAC-ja do të monitorojë implementimin e planeve korrigjuese.

3.4 Rekordet/arkivimi

Një kopje e shkruar e raportit i dorëzohet një personi të caktuar që përfaqëson entitetin e audituar në nivel drejtuesish. Pas kësaj, është në dorë të këtij personi që të vendosi mbi shpërndarjen brenda për brenda entitetit të tij të raportit apo ndonjë pjese të tij, duke pasur parasysh që shpërndarja është e kufizuar në minimum e kërkuar për të realizuar korrigjimet e propozuara.

AAC-ja duhet të ruajë të gjitha përmbledhjet e auditimeve dhe analizimet e rezultateve, të cilat mund të jenë të disponueshme për organizata të tjera apo shtete të huaja, atëherë kur konsiderohet e lejueshme dhe e domosdoshme të veprohet në këtë mënyrë.

ANEKSI B
METODOLOGJIA E NJË INSPEKTIMI TË SIGURISË

1. Përkufizimi dhe objektivat e inspektimeve të sigurisë

Një inspektim i sigurisë është një ekzaminim i hollësishëm i një apo më shumë aspekteve të procedurave dhe masave të sigurisë me qëllim për të përcaktuar nëse këto masa dhe procedura janë implementuar në vazhdimësi, korrektësi dhe në standarde të qëndrueshme.

Objektivat e inspektimeve të sigurisë janë si më poshtë:

a) për të garantuar implementimin efektiv dhe eficient të Programit Kombëtar të Sigurisë së Aviacionit Civil, si dhe për të garantuar që masat dhe procedurat e kërkuara në sigurinë e aviacionit civil janë implementuar në vazhdimësi dhe në mënyrë standarde;

b) për të identifikuar ndonjë të metë apo mangësi në masat dhe procedurat e sigurisë së aviacionit dhe për të garantuar korrigjimin e tyre;

c) për të gjykuar thellë se sa janë arritur standardet dhe efikasiteti i politikave të sigurisë dhe masave të tjera bashkëlidhur me këto politika.

2. Përshkrimi

Një inspektim i sigurisë është zakonisht i një sfere të kufizuar, përqendruar më shumë në një lloj të veçantë operimi, në një pjesë të kufizuar të aeroportit apo në një operator të veçantë/specifik ajror etj.

Kjo kategori e veçantë monitorimi mund të ndërmerret brenda një periudhe të shkurtër (p.sh. brenda orësh ose brenda një dite).

Koment: sfera e inspektimit mund të zgjerohet deri në monitorim të përgjithshëm të operimeve në një aeroport dhe në këtë rast mund të emërtohet apo konsiderohet si "auditim".

Inspektimet e sigurisë janë të panjoftuara. Në këtë mënyrë, asnjë njoftim paraprak normalisht nuk duhet t'i jepet entitetit par procedurat e sigurisë të të cilit do të inspektohen. Kur konsiderohet e domosdoshme, një njoftim mund të jepet te një numër shumë i kufizuar personash brenda entitetit që do të inspektohet, duke garantuar një nivel të lartë të konfidencialitetit.

Ndryshe nga auditimi i sigurisë, inspektimet mund të përfshijnë testime, por në një masë të kufizuar.

2.1 Sfera e inspektimeve

Inspektimet duhet të ekzaminojnë, brenda normave të lejuara, implementimin e disa aspekteve të Programit Kombëtar të Sigurisë së Aviacionit Civil, duke përfshirë politikat tek të cilat ato janë bazuar.

Siç është përshkruar më lart, inspektimet e sigurisë kanë një sferë më të kufizuar sesa auditimet e sigurisë. Si rrjedhojë, ato përqendrohen në një lloj të veçantë operimi, në një pjesë specifike të

aeroportit, në një operator ajror specifik apo ndonjë entitet tjetër rregullator që kryen/ndërmerr masa të sigurisë.

Në çdo rast, inspektimi i sigurisë duhet të mbulojë një ose më shumë nga fushat e mëposhtme:

- sigurinë në aeroport;
- sigurinë e avionit;
- pasagjerët dhe bagazhet e tyre të kabinës;
- bagazhet e hambarit;
- dërgesat postare, shërbimi "korrier" dhe pakot "ekspres";
- kargoja dhe posta ajrore;
- materialet e transportuesit ajror (*co-mail* dhe *co-mat*);
- furnizuesit e aeroportit dhe furnizimet në fluturim;
- materialet e pastrimit, magazinat dhe furnizimet me këto materiale;
- furnizimet ushqimore, magazinat dhe artikuj të kësaj natyre;
- aviacioni i përgjithshëm;
- menaxhimin e përgjigjes kundrejt akteve të ndërhyrjes së paligjshme në Aviacionin Civil.

2.2 Autoriteti dhe kompetencat e inspektorëve të sigurisë në aviacion

inspektorët kombëtarë, kanë kompetenca të ndërthurura, duke përfshirë mundësinë, që:

- të kryhet inspektimi i një avioni të regjistruar në Shqipëri;
- të kryhet inspektimi i një avioni që operon në Shqipëri;
- të vëzhgojë në çdo seksion të aeroportit;
- t'i kërkojë një operatori ajror, një drejtuesi aeroporti apo edhe ndonjë entiteti tjetër të implikuar në çështje të sigurisë, për të dhënë informacion të vlefshëm për qëllime monitorimi;
- regjistrojë çdo operim, procedure apo instalim, në formë të shkruar, të fotografuar apo dhe elektronike. Përveç këtyre, inspektorët kombëtar duhet të kenë të mundur që të përdorin në zonat e kufizuara të sigurisë çdo lloj mjeti pune, aparaturë apo ndonjë pajisje tjetër që është e domosdoshme për përmbushjen e detyrave, duke përfshirë aparate fotografike, regjistrues video dhe audio, skaner dokumentesh etj.

Përveç sa u përmend më lart, inspektorët e sigurisë kanë kompetencë për të:

- kërkuar korrigjim/riparim të menjëhershëm të mangësive;
- lëshuar njoftime të zbatimit të detyrueshëm;
- ndalur/izoluar një avion për qëllim inspektimi.

Inspektorët e sigurisë e kanë obligim që rrjedh nga detyrat dhe përgjegjësitë profesionale të pozicionit të punës ushtrimin e kompetencave të tyre në lidhje me të gjitha elementet e PKSAC-së.

Aktivitete inspektimi duhet të ndërmerren në çdo kohë, duke përfshirë këtu festat publike, fundjavat apo dhe gjatë orëve të "qeta" (d.m.th., pa shumë aktivitet apo dyndje).

Në vijim të kompetencave ligjore të inspektorëve të sigurisë, do të përbënte një shkelje, nëse:

- në mënyrë të qëllimshme dëmtohet ose ndërpritet puna e inspektorit të sigurisë;
- nuk i jepet ose refuzon t'i jepet informacion një inspektori kombëtar të sigurisë;
- i jepet informacion i rremë apo shkatërrues një inspektori kombëtar të sigurisë;
- një punonjës hiqet si inspektor sigurie kur nuk është i tillë (auditues i rremë).

2.3 Kryerja e inspektimeve

2.3.1 Hapat kryesorë të procesit të inspektimit

Siç është përshkruar në kapitullin 6, procesi i inspektimit në tërësi duhet të përmbajë elementet e mëposhtme:

- fazën përgatitore;
- aktivitetin mbikëqyrës në terren;
- takimin mbyllës/shpjegues rezultatet e aktivitetit të kryer;
- raportimin/ruajtjen dhe arkivimin;
- procesin korrigjues dhe monitorimin e tij.

Kryerja e inspektimit të sigurisë do të përqendrohet në mbledhjen sistematike të informacionit sipas metodave, të:

- shqyrtimit të dokumentacionit;
- vëzhgimeve në terren;
- intervistimit;
- verifikimeve.

Një inspektim i sigurisë duhet të bazohet në vëzhgimin e implementimit të masave të sigurisë në aeroport, me sa më pak gjykim që të jetë e mundur me qëllim që grupi i inspektorëve të jetë sa më objektiv që të jetë e mundur.

2.3.2 Detyrat e inspektorëve të sigurisë gjatë një inspektimi

Siç u përmend dhe më lart, inspektorët e sigurisë i kanë të gjitha kushtet dhe mundësitë për kryerjen e detyrave të tyre. Sidoqoftë, ata duhet të marrin parasysh disa kufizime, në mënyrë që të

shmanget apo minimizohet ndërhyrja/interferenca në aktivitetin operacional të subjekteve të mbikëqyrura.

Për rrjedhojë, gjatë kryerjes së një inspektimi të sigurisë, është detyrë e inspektorëve të sigurisë, që:

a) të vëzhgojnë kriteret e sigurisë në aeroport (duke përfshirë operatorët ajrorë dhe operatorët e tjerë që ushtrojnë veprimtari në fushën e sigurisë) dhe të shfrytëzojë rrugët e posaçme të aksesit dhe të daljeve, dhe të jenë gjatë gjithë kohës të shoqëruar me shoqërues të akorduar nga autoritetet vendore;

b) të zbatojnë të gjitha rregullat e sigurisë;

c) të mos përdorin forcë për të garantuar aksesin tek avioni, godinat, punimet apo tek sipërfaqja tokësore;

d) të mos hapin dyert e jashtme të avionit, të mos prekin me dorë asnjë nga dyert e jashtme apo të futen brenda në avion, përveç rasteve kur janë të shoqëruar nga përfaqësues kompetent të operatorit ajror;

e) të mos ngasin automjete në zonën ajrore, pa autorizimin e domosdoshëm;

f) të mos përdorin/shfrytëzojnë kompetencat për të vonuar apo izoluar një avion përveç rasteve kur ka arsye të forta për të ndërmarrë një veprim të tillë (në raste të tilla, një bashkëpunim i plotë i autoriteteve të aeroportit dhe operatorëve duhet të zhvillohet);

g) të marrin të gjitha masat e arsyeshme për të mos tërhequr në mënyrë të panevojshme personelin nga detyrat e tyre primare gjatë kryerjes së intervistave.

Në situata të emergjencës, p.sh., pengmarrje e avionit apo kërcënimi për bombë, procesi i inspektimit pezullohet sipas kërkesës së autoriteteve vendore.

Për të shmangur keqkuptimet mbi rolin e inspektorëve, inspektorët e sigurisë nuk duhet të këshillojnë, korrigjojnë apo udhëzojnë personelin gjatë procesit të inspektimit, në veçanti personelin e sigurisë. Sidoqoftë, nëse konsiderohet e domosdoshme, inspektori duhet të informojnë supervizorët në lidhje me të metat e konstatuara, kjo në bashkëpunim me autoritetet lokale.

Përveç kësaj, ata nuk duhet të ndërmarrin ndonjë veprim të karakterit operacional, si p.sh., të merren me pasagjerët, me personelin apo të ndihmojnë trafikun.

2.4 Mangësitë/të metat

"Mangësi" ose "e metë" do të thotë një mospërputhje me parashikimet e Programit Kombëtar të Sigurisë së Aviacionit Civil.

Objektivi thelbësor i një inspektimi të sigurisë është identifikimi e mangësive dhe adresimi i tyre në mënyrën e duhur.

Ka dy mënyra për informimin e përfaqësuesve të entiteteve që janë objekt i inspektimit:

- komunikimi verbal në terren gjatë një seance postinspektim;
- raportet me shkrim në të cilët paraqiten më të detajuara mangësitë e konstatuara.

Për të analizuar nivelin e përputhshmërisë së procedurave dhe masave të sigurisë të observuara gjatë auditimit me dispozitat e Programit Kombëtar të Sigurisë së Aviacionit, grupi i inspektorëve do të përdorë sistemin e vlerësimit të përshkruar në kapitullin 6, për të përcaktuar:

- **në përputhje të plotë (kategori 4)**: që do të thotë se nuk është konstatuar asnjë mangësi. Fusha/aspekti i analizuar përmbush plotësisht kërkesat dhe dispozitat e Programit Kombëtar të Sigurisë;
- **në përputhje, por kërkohet përmirësim (kategori 3)**: që do të thotë se nuk është konstatuar asnjë mangësi. Fusha/aspekti i analizuar përmbush kërkesat dhe dispozitat e Programit Kombëtar të Sigurisë. Sidoqoftë, megjithëse asnjë masë zbatuese nuk ndërmerret, përmirësimi është i dëshirueshëm dhe praktikat më të mira duhet të konsiderohen;
- **papajtueshmëri e ulët (kategori 2)**: që do të thotë se janë konstatuar mangësi të vogla. Një konstatim i tillë përfaqëson një fushë/aspekt të vogël që kërkon korrigjim dhe përmirësim. Në këtë rast veprimi korrigjues duhet të ndërmerret nga entiteti i audituar për të riparuar apo korrigjuar mangësinë apo mangësitë e konstatuara. Masat për zbatueshmërinë mund të konsiderohen;
- **papajtueshmëri e lartë (kategori 1)**: që do të thotë se mangësi janë konstatuar serioze. Në ndryshim nga rasti i mësipërm, ky rast paraqet një mangësi serioze dhe mospërputhje me standardet e sigurisë të përshkruara në Programin Kombëtar të Sigurisë, dhe si i tillë ka ndikim të madh dhe të drejtpërdrejt në siguri. Për këtë rast, masa shtrënguese të zbatueshmërisë, në raport të njëjtë me rëndësinë dhe përmasat e shkeljes së procedurave të sigurisë, duhet të ndërmerren;

- **nuk konfirmohet**: që do të thotë një objekt i paverifikuar apo i paverifikueshëm (p.sh. kontrolli i dokumentacionit), ose i pavëzhguar (masë sigurie);

- **"nuk aplikohet"**: që do të thotë një masë apo procedure e sigurisë nuk ekziston ose nuk /aplikohet nga entiteti nën auditim (p.sh. regjistrimi jashtë aeroportit (*off-airport check-in*).

3. Raportimi dhe procedurat "postinspektim"

3.1 Raportimi

Siç është shpjeguar dhe më lart, ecuria e inspektimeve duhet të raportohet sipas mënyrës së interpretimit verbal përmes një seance shpjegimore "postinspektim" dhe raportimit me shkrim.

Pas përfundimit të inspektimit, një seancë dëgjimore shpjeguese organizohet me përfaqësuesit e lartë të entitetit që është inspektuar. Gjatë këtij takimi, inspektorët do të paraqesin konstatimet, pozitive dhe negative, dhe theksi vihet tek aspektet apo fushat e mospërputhjes që ndiqen nga aktet për zbatueshmërinë e dispozitave për sigurinë.

Pas kësaj faze, hartohet një raport i detajuar me konkluzionet përkatëse, brenda 15 ditësh nga përfundimi i inspektimit. Në këtë raport do të përfshihen të gjitha konstatimet e hasura, si dhe i tërë informacioni në lidhje me procedurat mbi korrigjimin e mangësive të konstatuara dhe akteve shtrënguese për zbatueshmërinë, nëse konsiderohet e pashmangshme.

Raporti duhet të përmbajë dhe një përshkrim të shkurtër të objektivit të masave dhe procedurave të sigurisë, të monitoruara nga grupi i inspektimit.

3.2 Procedurat "postinspektim"

Entitetit do t'i kërkohet që të dorëzojë pranë AAC-së një plan veprimi për të adresuar mangësitë e konstatuara, të përshkruara në raportin e inspektimit, në një afat jo më gjatë se 15 ditë nga marrja raportit. Së bashku me korrigjimet e bëra, një afat kohor për implementimin e masave të propozuara, në formën e një programi, duhet të përcaktohet dhe të dorëzohet tek AAC-ja për miratim. Në varësi të miratimit të planit të masave korrigjuese dhe afateve përkatëse, AAC-ja do të monitorojë implementimin e planeve korrigjuese.

3.3 Rekordet/arkivimi

Një kopje e shkruar e raportit i dorëzohet një personi të caktuar që përfaqëson entitetin e audituar në nivel drejtuesish. Pas kësaj, për të realizuar korrigjimet e propozuara, është nën përgjegjësinë e këtij personi që të vendosë mbi shpërndarjen brenda operatorit të raportit apo ndonjë pjese të tij, duke pasur parasysh që shpërndarja është e kufizuar në minimumin e kërkuar.

AAC-ja duhet të ruajë të gjitha përmbledhjet e inspektimeve dhe analizat e rezultateve, të cilat mund të jenë të disponueshme për organizata të tjera apo shtete të huaja, atëherë kur konsiderohet e lejueshme dhe e domosdoshme që të veprohet në këtë mënyrë.

4. Frekuenca e inspektimeve

Në aeroportet me një volum vjetor trafiku prej më shumë se 2 milionë pasagjerë, frekuenca minimale e inspektimit të të gjitha masave të sigurisë nga kapitulli 1 deri në kapitullin 6 të dokumentit 30, duhet të jetë të paktën një herë në vit, përveç rasteve kur është bërë një audit i përgjithshëm gjatë kësaj kohe.

Frekuenca e inspektimeve të masave të sigurisë të mbuluara nga kapitulli 7 deri në kapitullin 12 të dokumentit 30 do të përcaktohet nga AAC-ja, duke u zbatuar në një vlerësim të riskut.

ANEKSI C
METODOLOGJIA E STUDIMEVE TË SIGURISË

1. Përkufizimi dhe objektivat e anketimeve të sigurisë

Studim i sigurisë është një monitorim i operimeve me qëllim përcaktimin e nevojave të sigurisë, duke përfshirë identifikimin e pikave të dobëta të cilat mund të shfrytëzohen për kryerjen e akteve të ndërhyrjes së paligjshme ndaj aviacionit civil, pavarësisht implementimit të masave dhe procedurave të sigurisë, si dhe rekomandimit të masave mbrojtëse shtesë, të barabarta këto me kërcënimin për të adresuar ndonjë rrezik të identifikuar.

Një studim i sigurisë ndryshon nga një inspektim apo auditim i sigurisë përmes objektivave të saj dhe rrethanave nën të cilat kryhen këto sondazhe/anketime/studime.

Si rrjedhojë, një sondazh sigurie mund të ndërmerret vetëm nëse përmbushen kushtet 1 dhe 2, si më poshtë:

I. Modifikime të dukshme të sistemit në tërësi apo pjesërisht, që çojnë në një rritje të nivelit të kërcënimit apo pikave të dobëta të paparashikuara kundrejt operimeve në aviacionin civil.

P.sh.:

- një teknologji e re mundet që në mënyrë të fuqishme – ose është përdorur për të kërcënuar operimet në aeroport apo avionët; ose

- një nivel i rritur i kërcënimit mund të ketë impakt – ose ka provuar të ketë dhënë impakt – te një operator i caktuar (p.sh. operator i huaj i një vendi që mund të jetë në shënjestër të grupeve të njohura dhe të identifikuara terroriste); ose

- kushtet e përkohshme mund të kenë efekt lokal – është provuar të kenë dhënë efekt në nivelin e sigurisë.

II. Këto kushte të reja – të përkohshme apo të përhershme – nuk janë të përshkruara akoma në Programin Kombëtar të Sigurisë.

Për pasojë të këtyre rrethanave, pikat e reja të dobëta mundet që në nivel lokal apo global të ndikojnë në nivelin e sigurisë. Si rrjedhojë, objektivi i sondazheve/anketimeve/studimeve të sigurisë duhet të jetë:

- të identifikojë pikat e dobëta të cilat mund të shfrytëzohen për të ndërmarrë sulme apo akte të ndërhyrjeve të paligjshme;

- të përcaktojë nevojat shtesë për sigurinë nga entiteti që po analizohet/studiohet (për sa u përket procedurave, pajisjeve, burimeve njerëzore dhe financiare);

- të identifikojë nevojat për përmirësimin/ amendimin e rregulloreve kombëtare (Programit Kombëtar apo politikave në lidhje me këtë Program).

Gjatë një sondazhi/anketimi/studimi të sigurisë, përparësi duhet t'i jepet identifikimit të pikave të dobëta dhe nevojave të sigurisë që pasojnë rrethanat specifike të përshkruara më lart, pa marrë parasysh nivelin në tërësi të përputhshmërisë së masave të sigurisë të implementuara me dispozitat e Programit Kombëtar të Sigurisë. Sidoqoftë, çdo informacion i mbledhur gjatë sondazhit/ anketimit/studimit, që nxjerr në pah mangësitë apo të metat në lidhje me implementimin e rregulloreve kombëtare, duhet të merren parasysh dhe të raportohen në përputhje me rrethanat, siç mund të bëhen gjatë një auditimi apo inspektimi.

2. Përkufizimi/përshkrimi

Sfera e një studimi sigurie duhet të variojë nga një monitorim i shënjestruar (i një operatori të veçantë, ose një operimi specifik në aeroport) deri te një aktivitet i tërësishëm/i gjithanshëm monitorimi që përfshin, deri në masën e lejuar, të gjitha aspektet e masave dhe procedurave të sigurisë.

Si rrjedhojë, kohëzgjatja e studimit/sondazhit mund të variojë nga disa orë në një apo më shumë javë. Në rast të domosdoshmërisë së një vlerësimi në tërësi të pikave të dobëta potenciale, sondazhet/studimet mund të përfshijnë aktivitete testimi.

Një studim/anketim i sigurisë zakonisht i përket kategorisë së aktiviteteve të panjoftuara. Në këtë mënyrë, asnjë njoftim paraprak normalisht nuk duhet t'i jepet entitetit, procedurat e sigurisë të të cilit do të studiohen/monitorohen. Kur konsiderohet e domosdoshme, një njoftim mund të jepet te një numër shumë i kufizuar personash brenda entitetit që do të monitorohet, duke garantuar një nivel të lartë të konfidencialitetit.

2.1 Sfera e sondazheve/anketimeve/studimeve

Sfera e sondazheve të sigurisë përcaktohet nga vlerësimi i rrethanave të përshkruara më parë. Është detyrë dhe kompetencë e AAC-së për të përcaktuar se cilat entitete (operator ajror, operator i aeroportit, e të tjera), si dhe aspektet/fushat që do të përfshihen në studimin/sondazhin që do të kryhet.

2.2 Kryerja e sondazheve/anketimeve/ studimeve

Një studim/anketim/sondazh i sigurisë nuk ndryshon nga një auditim apo inspektim i sigurisë për sa i përket metodologjisë operacionale, por vetëm nga objektivat dhe rrethanat që çojnë në një vendimmarrje për të ndërmarrë një studim apo anketim. Si rrjedhojë, metodat e monitorimit nuk ndryshojnë me ato që aplikohen tek auditimi apo inspektimi, në varësi të sferës së anketimit/ studimit.

2.3 Mangësitë/të metat

Për sa u përket objektivave të saj/tij, anketimi / studimi i sigurisë nuk ka si qëllim prioritar identifikimin e mangësive apo mospërputhjeve, dhe në këtë aspekt i referohet rreptësishtë vetëm një dështimi total të implementimit të PKSAC-së apo politikave pasuese.

Sidoqoftë, siç përshkruhet dhe më lart, çdo lloj informacioni i mbledhur gjatë një studimi/ anketimi, që nxjerr në pah mangësitë apo mospërputhjet me PKSAC-në dhe politikat pasuese, duhet të merret parasysh dhe të raportohen në përputhje me rrethanat siç veprohet në rastet e auditimit apo inspektimit.

3. Raportimi dhe procedurat "postanketim"

3.1 Raportimi

Praktikisht, mënyra e raportimit nuk duhet të jetë e ndryshme nga metodologjia e përdorur për auditimet dhe inspektimet, megjithatë vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet pikave të dobëta të identifikuara gjatë anketimit/studimit dhe domosdoshmërisë për plan-veprim korrigjues. Plani i masave korrigjuese duhet të jenë në koherencë të plotë me rëndësinë e pikave të dobëta të nxjerra në pah. Këto çështje duhet të adresohen saktë dhe në vendin e duhur.

3.2 Procedurat "postanketim"

AAC-ja i kërkon entitetit të dorëzojë një plan-veprimi ku të adresohen të gjitha pikat e dobëta të përshkruara në raport dhe të propozojnë masa mitiguese. Së bashku me veprimet e propozuara, një afat kohor për implementimin e tyre duhet të dorëzohet në AAC dhe të marrë aprovimin përkatës. Në varësi të miratimit të masave dhe afateve në lidhje me këto masa, AAC-ja monitoron implementimin e këtyre masave.

3.3 Rekordet/arkivimi

Një kopje e shkruar e raportit i dorëzohet një personi të caktuar që përfaqëson subjektin e audituar në nivel drejtuesish. Pas kësaj, për të realizuar korrigjimet e propozuara, është nën përgjegjësinë e këtij personi që të vendosë mbi shpërndarjen brenda për brenda entitetit të tij, të raportit apo ndonjë pjese të tij, duke pasur parasysh që shpërndarja është e kufizuar në minimum e kërkuar. Vëmendje e veçantë duhet të tregohet për çështje të konfidencialitetit, në veçanti, për pikat e dobëta të identifikuara.

AAC-ja duhet të ruajë të gjitha përmbledhjet e inspektimeve dhe analizimet e rezultateve, të cilat mund të jenë të disponueshme për organizata të tjera apo shtete të huaja, atëherë kur konsiderohet e lejueshme dhe e domosdoshme të veprohet në këtë mënyrë.

3.4 Analizimi

Pas përfundimit të anketimit/studimit, AAC-ja analizon raportin për të shqyrtuar nëse është e domosdoshme të bëhen ndryshime në Programin Kombëtar të Sigurisë.

ANEKSI D
METODOLOGJIA E TESTIMIT TË SIGURISË

1. Përkufizimi dhe objektivat e testimeve të sigurisë

Një testim i sigurisë është një sprovë e masave të sigurisë, ku AAC-ja prezanton ose simulon kryerjen e një akti të ndërhyrjes së paligjshme, me qëllim ekzaminimin e efikasitetit dhe implementimit të masave ekzistuese të sigurisë.

Testet e sigurisë ndahen në dy kategori:

1. testet e fshehta që janë të panjoftuara;

2. testet e hapura që janë të njoftuara dhe shpesh në bashkëpunim me subjektin që do të kryhet.

Objektivat në përgjithësi të testimeve të sigurisë, duhet të jenë:

- testimi i efikasitetit të Programit Kombëtar të Sigurisë;
- testimi i procedurave të operimit për sigurinë të implementuara nga operatorë apo agjenci të tjera që kanë detyrime në lidhje me sigurinë në aviacion duke iu referuar PKSAC-së, duke përfshirë personelin e tyre;
- identifikimi i ndonjë mangësie apo mospërputhjeje me standardet dhe procedurat e sigurisë së aviacionit dhe për të garantuar që ato janë korrigjuar;
- dhe në masë të caktuar, të ndihmojnë në motivimin e personelit.

Në mënyrë më specifike, një testim ka si qëllim konfrontimin e një apo më shumë pjesëve të të gjithë sistemit të sigurisë së një aeroporti, një operatori ajror apo dhe ndonjë entiteti tjetër që ka detyrime në sigurinë e aviacionit, kundrejt një ngjarjeje të simuluar të një incidenti të sigurisë apo të një akti të simuluar të ndërhyrjes së paligjshme. Qëllimi kryesor është të vlerësojë efikasitetin dhe forcën/fuqinë e sistemit për t'u përballur me hasje të tillë reale.

Si përmbledhje, testimet kanë si qëllim kryesor të kolaudojnë nëse masat dhe procedurat e sigurisë, që janë pjesë e PKSAC-së, arrijnë/realizojnë objektivat e tyre, sesa të nxjerrin në pah nëse masat ekzistojnë.

2. Përshkrimi

Një testim i sigurisë, në parim, është një monitorim i shënjestruar, që ka të bëjë me një aspekt shumë specifik të sistemit të sigurisë. Si

pasojë, kohë-zgjatja duhet të jetë relativisht e shkurtër, në varësi të sferës së testimit (p.sh. futja një objekti të ndaluar në zonën e kufizuar të sigurisë nëpërmjet një pike kontrolli mund të marrë vetëm disa minuta etj.).

Testimet e fshehta nuk njoftohen asnjëherë te personeli i përfshirë direkt në këtë lloj testimi, përveç rasteve kur konsiderohet e domosdoshme, një drejtues i lartë i entitetit njoftohet, duke ruajtur konfidencialitetin në maksimum.

2.1 Sfera e testimeve

Është detyrë dhe kompetencë e AAC-së për të përcaktuar se cilën pjesë specifike të sistemit tërësor të sigurisë (cilin aspekt të sistemit tërësor të sigurisë), si dhe aspektet/fushat që do të përfshihen në testimin që do të kryhet.

Si pjesë e Programit Kombëtar të Kontrollit të Cilësisë së Sigurisë së Aviacionit Civil, testimet mund të ekzaminojnë çdo aspekt të PKSAC-së dhe politikat përkatëse.

2.2 Kryerja e testimeve

Një testim i sigurisë duhet të ndërmerret – ose duhet të kryhet nën mbikëqyrjen e një personi të autorizuar.

Në rastin e dytë, një ose më shumë persona emërohen nga AAC-ja apo nga personi i autorizuar përgjegjës për testimin, për të kryer testimin për llogari të AAC-së. Në të shumtën e rasteve, kjo ndihmon në shmangien e njëanësisë (kur audituesit e sigurisë janë të njohur mirë në aeroport). Do të jetë detyrë e personit të autorizuar për të garantuar se testimi është zhvilluar në përputhje të rreptë me procedurat standarde të hartuara nga AAC-ja për këtë kategori aktivitetesh, si dhe që të ruaj fshehtësinë dhe të kujdeset për të mos ekspozuar aktivitetin.

Për këtë qëllim, këtyre "testuesve të përkohshëm", do t'ju:

- Shpjegohet në formën më të detajuar nga personi i autorizuar mbi çdo testim që do kryhet se kush do të jetë personi që do të mbikëqyrë procesin e testimit, veçanërisht kur simulohet me armë zjarri apo me eksplozivë (shih: 2.2.1);
- Bëhet e qartë domosdoshmëria e mbartjes së dokumentacionit që konfirmon autoritetin e duhur për të kryer detyra të tilla.

2.2.1 Përbërja/përmbajtja e testimeve

Gjatë procesit të kryerjes së testimit të sigurisë, testuesit duhet të konsiderojnë, si në çdo aktivitet monitorimi, si detyrë:

Përveç rregullave që përshkruhen më sipër, duhet të konsiderohen të rëndësishme për garantuar që testimet:

- janë kryer në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit;
- nuk rrezikojnë apo dëmtojnë sigurinë e njerëzve, avionëve apo godinave dhe shërbimeve të ndryshme aeroportuale;
- të mos shkaktojnë asnjëherë dëmtime te prona private apo publike;
- të minimizohet në maksimumin e mundshëm ndikimi në operim, si dhe interferencë te publiku në tërësi apo persona që nuk janë pjesë e testimit.

2.2.2 Pjesët përbërëse të testimeve

Bashkëlidhur me përmbajtjen e testimeve të përshkruara më lart, janë përcaktuar kritere apo kërkesa specifike në lidhje me përdorimin e artikujve të ndaluara gjatë testimit.

Si pasojë, ku është e domosdoshme përdorimi i armëve të zjarrit për kryerjen e testimeve:

- vetëm armë të çaktivizuara, për të cilat nuk kërkohet certifikatë e posaçme për armët e zjarrit;
- këto armë duhet të jenë të zbrazura, të ambalazhuara në plastikë ose rrëshirë, ose të përdoren të çmontuara;
- pajisje testuese të simuluara që janë imitime eksplozivësh dhe artikujsh të ndaluar, që shfaqen me parametra si reale në pajisjet e sigurisë.

Në rastet kur është e domosdoshme të simulohet pajisje shpërthyese si pjesë e testimit, atëherë vetëm lëndë plasëse e neutralizuar/e mpirë do të përdoret, dhe në asnjë rast nuk mund të përdoret lëndë plasëse aktive.

2.3 Mangësitë/të metat

Në lidhje me përkufizimin dhe objektivin e testimit, mangësi apo mospërputhje do të thotë që testuesit kanë triumfuar ndaj një procedure të sigurisë gjatë aplikimit të metodave të standardizuara të testimit.

Kjo mospërputhje apo mangësi në implementimin e një procedure të caktuar të sigurisë, mund të jetë si rezultat i:

- mungesës së mundësive teknike, të disponueshme për arritjen e objektivave të masave të sigurisë;
- mungesës së udhëzimeve për stafin, përgjegjësi kjo e drejtuesve të entitetit;
- dobësisë në vetë procedurën ose në politikat në të cilat kjo procedure është bazuar;
- mungesës së trajnimit të personelit;

- neglizhencës ose ineficiencës nga ana e individit apo individëve.

Për të analizuar nivelin e përputhshmërisë së procedurave dhe masave të sigurisë të observuara gjatë testimit me dispozitat e Programit Kombëtar të Sigurisë së Aviacionit, është i aplikueshëm sistemi kalon/dështon, përkatësisht:

- dështon operatori kur testuesi arrin t'u kalojë kontrolleve të sigurisë pa u diktuar;
- kalon operatori kur testuesi dështon për të kaluar artikuj të ndaluar përtej kontrolleve të sigurisë.

3. Raportimi dhe procedurat "posttestim"

3.1 Raportimi

Pas përfundimit të testimit, një seancë dëgjimore shpjeguese organizohet me përfaqësuesit e lartë të entitetit që është testuar. Gjatë këtij takimi, inspektorët/testuesit do të paraqesin rezultatet e testimeve.

N.q.s. gjatë testimit është identifikuar "dështim" i procedurave, stafit të implikuar do t'i shpjegohet sesi testuesit kanë sfiduar procedurën e sigurisë dhe çfarë mund të ishte bërë për të ndalur një sfidë të tillë.

Pas kësaj faze, hartohet një raport i detajuar me konkluzionet përkatëse.

Në këtë raport, do të:

- shpjegohen objektivat e testimit të kryer;
- shpjegohen procedurat e ndjekura gjatë testimit (duke përfshirë një analizë të "shkallës së vështirësisë");
- raportohen në mënyrën më të detajuar observacionet dhe rezultatet;
- këshillojë dhe japë të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me procedurat e mëtejshme të korrigjimit dhe mbi sanksionet që pasojnë, nëse gjykohet e domosdoshme.

3.2 Procedurat ndjekëse/pasuese

AAC-ja i kërkon entitetit të dorëzojë një plan-veprimi ku të adresohen të gjitha pikat e dobëta të përshkruara në raport dhe të propozojnë masa korrigjuese, brenda një afati 10 ditë nga marrja e raportit. Së bashku me veprimet e propozuara, një afat kohor për implementimin e tyre duhet të dorëzohet në AAC dhe të marrë aprovimin përkatës. Në varësi të aprovimit të masave dhe afateve në lidhje me këto masa, AAC-ja monitoron implementimin e tyre.

3.3 Rekordet/arkivimi

Një kopje e shkruar e raportit i dorëzohet një personi të caktuar që përfaqëson entitetin e testuar në nivel drejtuesish. Pas kësaj, është në dorë të këtij personi që të vendosë mbi shpërndarjen brenda për brenda entitetit të tij, të raportit apo ndonjë pjese të tij, duke pasur parasysh që shpërndarja është e kufizuar në minimum e kërkuar për të realizuar korrigjimet e propozuara. Vëmendje e veçantë duhet të tregohet për çështje të konfidencialitetit, në veçanti për pikat e dobëta të identifikuara.

AAC-ja duhet të ruajë të gjitha raportet e testimeve dhe analizimet e rezultateve, të cilat mund të jenë të disponueshme për organizata të tjera apo shtete të huaja, atëherë kur konsiderohet e lejueshme dhe e domosdoshme të veprohet në këtë mënyrë.

ANEKSI E
METODOLOGJIA E NJË HETIMI TË SIGURISË

1. Përkufizimi dhe objektivat e hetimit të sigurisë

Një hetim i sigurisë është një ekzaminim i një incidenti të sigurisë dhe një shpjegim i shkakut të këtij incidenti, me qëllim shmangien e ripërsëritjes dhe marrjen e masave ligjore.

- Objektivat e hetimeve të sigurisë së aviacionit duhet të përcaktojnë:
- ku, si dhe pse ka ndodhur një shkelje e procedurave të sigurisë;
- ndonjë pikë e dobët që mund të ketë kontribuar në shkelje dhe/ose një shpjegim në lidhje me incidentin;
- kush ishte përgjegjës apo çfarë ishte shkaku i incidentit.

Gjithashtu, t'i rekomandojnë operatorit përkatës, në nivel drejtuesish:

- çfarë veprimi duhet të ndërmerret dhe nga kush duhet të ndërmerret që incidentet apo shkeljet të mos përsëriten;
- nëse një individ apo entitet duhet të konsiderohet për ndjekje penale.

Në ndryshim nga aktivitetet e tjera monitoruese, hetimi i sigurisë është një aktivitet monitorimi që ndërmerret pas ngjarjes/shkeljes/incidentit të ndodhur më parë.

2. Përshkrimi

Një hetim i sigurisë është qartësisht një monitorim i shënjestruar, që ka të bëjë me një apo

me një numër të kufizuar aspektesh të sistemit të sigurisë në vend, që janë të implikuar në incidentin e sigurisë. Për pasojë, kohëzgjatja e tij është relativisht e shkurtër, duke përjashtuar rastet kur në incident mund të jenë të implikuar potencialisht një seri aktivitetesh apo masash të sigurisë.

Në lidhje me hetimet, entitetet e implikuara potencialisht në incident, gjithmonë njoftohen paraprakisht. Por, nëse konsiderohet e domosdoshme për qëllimin e hetimit, mund të kryhen edhe disa aktivitete të panjoftuara si p.sh., testimet etj.

2.1 Kryerja e hetimeve të sigurisë

Hetimet e sigurisë përgjithësisht ndërmerren nga inspektorët/ audituesit kombëtarë të Sigurisë, mundësisht të shoqëruar nga kategori të tjera të personave të akredituar, si p.sh., oficerë të policisë, prokurorë etj.

Gjatë procesit të hetimit të sigurisë, hetuesit, duhet:

- të vëzhgojnë kërkesat e sigurisë në aeroport (duke përfshirë këtu operatorët ajrorë dhe ndërmarrjet e tjera partnere) dhe të përdoren rrugët /mënyrat e posaçme të hyrje-daljeve pa ndërprerë hetimin;
- të zbatojnë të gjitha rregullat e sigurimit fizik dhe teknik;
- të mos përdorin forcën për të pasur akses për tek avioni, godinat, vendi i punës apo në sipërfaqe tokësore;
- të mos hapin dyert e jashtme të avionit, të mos prekin pjesët kontrolluese të jashtme të avionit apo të hyjnë brenda avionit pa qenë i shoqëruar gjatë gjithë kohës nga një anëtar përgjegjës i personelit të operatorit ajror;
- të mos ngasin automjete në zonën ajrore, pa autorizimin e domosdoshëm;
- të mos përdorin/shfrytëzojnë kompetencat për të vonuar apo izoluar një avion përveç rasteve kur ka arsye të forta për të ndërmarrë një veprim të tillë (në raste të tilla, një bashkëpunim i plotë i autoriteteve të aeroportit dhe operatorëve duhet të zhvillohet);
- të merren të gjitha masat e arsyeshme për të mos tërhequr në mënyrë të panevojshme personelin nga detyrat e tyre primare gjatë kryerjes së intervistave;
- të mos interferojnë apo pengojnë ndonjë hetim penal, n.q.s. është rasti.

Përveç rregullave që përshkruhen më sipër, duhet të konsiderohen të rëndësishme për garantuar që hetimet:

- janë kryer në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit;
- nuk rrezikojnë apo dëmtojnë sigurinë e njerëzve, avionëve apo godinave dhe shërbimeve të ndryshme aeroportuale;
- të mos shkaktojnë asnjëherë dëmtime te prona private apo publike;
- të minimizohet në maksimumin e mundshëm ndikimi në operim, si dhe interferencë te publiku në tërësi apo persona që nuk janë pjesë e hetimit.

3. Raportimi dhe procedurat "posthetim"

3.1 Raportimi

Pas përfundimit të hetimit, një seancë dëgjimore shpjeguese organizohet me përfaqësuesit e lartë të entitetit që është hetuar. Gjatë këtij takimi, inspektorët do të paraqesin konstatimet, dhe theksi vihet tek aspektet apo fushat e mospërputhjes që ndiqen nga aktet për zbatueshmërinë e dispozitave për sigurinë.

Pas kësaj faze, hartohet një raport i detajuar me konkluzionet përkatëse, brenda 15 ditësh nga përfundimi i hetimit. Në këtë raport do të përfshihen të gjitha konstatimet e hasura, si dhe i tërë informacioni në lidhje me procedurat mbi korrigjimin e mangësive të konstatuara dhe akteve shtrënguese për zbatueshmërinë, nëse konsiderohet e pashmangshme.

Raporti duhet të përmbajë dhe një përshkrim të shkurtër të objektivit të masave dhe procedurave të sigurisë, të monitoruara nga grupi i hetimit.

3.2 Procedurat "posthetim"

Entitetit do t'i kërkohet që të dorëzojë pranë AAC-së një plan veprimi për të adresuar mangësitë e konstatuara, të përshkruara në raportin e hetimit, në një afat jo më gjatë se 10 ditë nga marrja raportit. Së bashku me korrigjimet e bëra, një afat kohor për implementimin e masave të propozuara, në formën e një programi, duhet të përcaktohet dhe të dorëzohet tek AAC-ja për miratim. Në varësi të aprovimit të programit dhe agjendës së tij përkatëse, AAC-ja do të monitorojë implementimin e planeve korrigjuese.

3.3 Rekordet/arkivimi

AAC-ja duhet të ruajë të gjitha përmbledhjet e hetimeve dhe analizimin e rezultateve, që mund të vihen në dispozicion të organizmave të tjerë përgjegjës apo shteteve të tjera sipas rasteve dhe siç mund të lejohet sipas marrëveshjeve apo ligjeve në fuqi.

SHTOJCA 1
FORMATI I RAPORTIT TË INSPEKTIMEVE/AUDITEVE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL I SHQIPËRISË

RAPORT I AUDITIMIT/ INSPEKTIMIT NË (EMRI I SUBJEKTIT TË INSPEKTUAR)

MUAJI / VITI

© Autoriteti i Aviacionit Civil i Shqipërisë 2022 – Të gjitha të drejtat e rezervuara.

	RAPORT I INSPEKTIMIT TË PANJOFTUAR TË FURNIZIMEVE TË AEROPORTIT DHE FURNIZIMEVE NË FLUTURIM, NË AEROPORTIN NDËRKOMBËTAR "NËNË TEREZA"	
	Zotëruesi	O4
	Dokumenti	FRM. 11.4

Bazuar në Planin e Punës për vitin 20__, inspektorët e Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Sigurisë në Aviacion/AAC, kryen më datë __.__.20__ një inspektim/audit të njoftuar/pa njoftuar të sigurisë në (subjekti i inspektuar). Qëllimi i këtij inspektimi ishte verifikimi i masave të sigurisë të zbatuara nga (subjekti i inspektuar) dhe procedurave në lidhje me (pika/masa e sigurisë e kontrolluar).

Në përputhje me Programin Kombëtar të Kontrollit të Cilësisë së Sigurisë në Aviacionin Civil të Republikës së Shqipërisë, objektivat e inspektimit, janë:

a) për të garantuar implementimin efektiv dhe eficiient të PKSAC, si dhe për të garantuar që masat dhe procedurat e kërkuara në sigurinë e aviacionit civil janë implementuar në vazhdimësi dhe në mënyrë standarde;

b) për të identifikuar të metat apo mangësitë në masat dhe procedurat e sigurisë së aviacionit dhe për të garantuar korrigjimin e tyre të shpejtë;

c) për të analizuar arritjen e standardeve, efikasitetin e politikave të sigurisë dhe masave të tjera bashkëlidhur me këto politika me qëllim përmirësimin e sistemit kombëtar të sigurisë së aviacionit.

Inspektimi i datës __.__.20__ përfshiu masat e sigurisë në lidhje:

Kryerja e inspektimit

1. Aktiviteti operacional i monitorimit; mbledhja sistematike e informacionit sipas metodave të observacionit/vëzhgimit; intervistave dhe ekzaminimit të dokumentacionit.

2. Inspektimi dhe verifikimi i implementimit të kërkesave të PKSAC-së, PKTSAC-së, aktet nënligjore të fushës së sigurisë së aviacionit civil dhe të Programit të Sigurisë së (subjekti i inspektuar), gjetjet dhe rekomandimet e inspektimeve të mëparshme.

3. Qëllimi i sigurisë në aviacion është mbrojtja dhe siguria e pasagjerëve, ekuipazhit fluturues, personelin që shërben në tokë, publikut në përgjithësi dhe avionit nga aktet e ndërhyrjes së paligjshme ndaj aviacionit civil që kryhen në tokë ose në fluturim.

Prezantimi i ekipit

Në fillim të inspektimit, grupi i inspektimit mori takim me përfaqësuesit e (subjekti i inspektuar), ku u prezantuan objektivat e inspektimit, dhe u paraqit Plani i Inspektimit.

Ekipi i inspektimit të AAC-së përbëhej, nga:

1. Znj./z. _____ _____ – drejtues;
2. Znj./z. _____ _____ – anëtar;
3. Znj./z. _____ _____ – anëtar.

Gjatë aktivitetit dhe në mbyllje, ekipi u shoqërua nga përfaqësues të (subjekti i inspektuar):

1. Znj./z. _____ _____ – pozicioni i punës;
2. Znj./z. _____ _____ – pozicioni i punës.

Takimi pas inspektimit

Në takimin përmbyllës (*debriefing*) inspektorët e DSMA/AAC paraqitën para përfaqësuesve të znj./z. _____ _____, mangësitë e konstatuara, si edhe dhanë rekomandimet përkatëse për korrigjimin e tyre (bashkëlidhur minutat e takimit të firmosura nga palët).

Aktiviteti operacional i monitorimit në vendndodhje

Mangësitë e identifikuara gjatë këtij inspektimi janë hedhur në formatin përkatës, bashkëlidhur këtij raporti.

Klasifikimi për përputhshmërinë me kërkesat e PKSAC, PKTSAC bazohet në sistemin e vlerësimit që përcakton kapitulli 6 i Programit Kombëtar të Kontrollit të Cilësisë së Sigurisë në Aviacionin Civil (PKKCSAC), miratuar me urdhrin e ministrit nr. 19, datë 26.2.2013.

1. Papajtueshmëri e lartë – kategori 1	**2. Papajtueshmëri e ulët – kategori 2**
3. Në përputhje, kërkohet përmirësim – kategori 3	**4. Në Përputhje të plotë – kategori 4**
5. Nuk aplikohet	**6. Nuk konfirmohet**

Për grupin e auditit/ inspektim / testimit

(Emri i drejtuesit të grupit)

Numri i papajtueshmërisë:	**GI- __/__**	**Periudha e auditit:**	
Referenca e dokumentit:	-	Protokolli i referencës së auditit:	
Lloji i papajtueshmërisë:	☐ *Papajtueshmëri e lartë - kat 1* ☐ *Papajtueshmëri e ulët - kat 2* ☐ *Në përputhje, kërkohet përmirësim - kat 3* ☐ *Në përputhje të plotë - kat 4*		Afati:
Papajtueshmëria:			
TEKSTI: REKOMANDIM:			

MASAT KORRIGJUESE – IMPLEMENTIMI DHE STATUSI:			
MASAT KORRIGJUESE TË PROPOZUARA/ ARSYEJA E PAPAJTUESHMËRISË		Subjekti/personi përgjegjës	Data e vënies në zbatim
Ekipi i inspektimit/ auditimit:		Data	
VERIFIKIMI I IMPLEMENTIMIT TË MASAVE KORRIGJUESE:			

URDHËR
Nr. 590, datë 12.12.2022

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E HUNGARISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës; në nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; si dhe në informacionin e përditësuar, të marrë nga faqja zyrtare e Organizatës Ndërkombëtare të Mbrojtjes së Shëndetit të Kafshëve (OIE),

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:
a) shpendëve të gjallë shtëpiakë dhe të egër;
b) zogjtë 24-orësh;
c) shpendë dekorativë;
ç) materialit biologjik të shpendëve;
d) vezët e shpendëve;
dh) mishi i shpendëve;
e) nënproduktet e shpendëve.

Nga shteti i Hungarisë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
1.	Bács-Kiskun	Kiskunmajsa	
2.	Bács-Kiskun	Kiskőrös	
3.	Bács-Kiskun	Kiskunhalas	
4.	Bács-Kiskun	Kecskemét	
5.	Bács-Kiskun	Kiskunfélegyháza	
6.	Bács-Kiskun	Jánoshalma	
7.	Békés	Orosháza	
8.	Csongrád-Csanád	Mórahalom	
9.	Csongrád-Csanád	Kistelek	
10.	Csongrád-Csanád	Szentes	
11.	Csongrád-Csanád	Szeged	

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë dhe të egër, zogjtë 24-orësh, shpendë dekorativë, materialit biologjik, vezët e shpendëve, mishi i shpendëve dhe nënproduktet e shpendëve, që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

URDHËR
Nr. 591, datë 12.12.2022

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E ITALISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës; në nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; si dhe në informacionin e përditësuar të marrë nga faqja zyrtare e Organizatës Ndërkombëtare të Mbrojtjes së Shëndetit të Kafshëve (OIE),

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:
a) shpendëve të gjallë shtëpiakë dhe të egër;
b) zogjtë 24-orësh;
c) shpendë dekorativë;
ç) materialit biologjik të shpendëve;
d) vezët e shpendëve;
dh) mishi i shpendëve;
e) nënproduktet e shpendëve.
Nga shteti i Italisë, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
1.	Emilia-Romagna	Ferrara	Ostellato
2.	Emilia-Romagna	Modena	Finale Emilia
3.	Emilia-Romagna	Modena	Modena
4.	Friuli-Venezia Giulia	Pordenone	Porcia
5.	Lombardia	Brescia	Isorella
6.	Lombardia	Brescia	Pavone Del Mella
7.	Lombardia	Brescia	Gottolengo
8.	Lombardia	Brescia	Milzano
9.	Lombardia	Brescia	Pralboino
10.	Lombardia	Brescia	Gambara
11.	Lombardia	Brescia	Remedello
12.	Lombardia	Brescia	Calvisano
13.	Lombardia	Brescia	Pozzolengo
14.	Lombardia	Brescia	Cigole
15.	Lombardia	Brescia	Quinzano d' Oglio
16.	Lombardia	Como	Sorico
17.	Lombardia	Cremona	San Giovanni In Croce
18.	Lombardia	Cremona	Casalmorano
19.	Lombardia	Cremona	Grontardo
20.	Lombardia	Cremona	Scandolara Ravara
21.	Lombardia	Cremona	Gussola
22.	Lombardia	Cremona	Solarolo Rainerio
23.	Lombardia	Mantua	Roverbella
24.	Lombardia	Mantua	Medole
25.	Lombardia	Mantua	Asola
26.	Lombardia	Mantua	Goito
27.	Lombardia	Mantua	Ceresara
28.	Lombardia	Mantua	Volta Mantovana
29.	Lombardia	Mantua	Guidizzolo
30.	Lombardia	Mantua	Pegognaga
31.	Lombardia	Mantua	Acquanegra Sul Chiese
32.	Lombardia	Mantua	Piubega
33.	Lombardia	Pavia	Arena Po
34.	Lombardia	Pavia	Galliavola
35.	Piemonte	Cuneo	Pianfei
36.	Sardegna	Cagliari	Cagliari
37.	Toscana	Florence	Scandicci
38.	Toscana	Florence	Campi Bisenzio
39.	Toscana	Prato	Vernio
40.	Toscana	Prato	Montemurlo

41.	Veneto	Padua	Lozzo Atestino
42.	Veneto	Padua	Santa Margherita d' Adige
43.	Veneto	Padua	Ponso
44.	Veneto	Padua	Ospedaletto Euganeo
45.	Veneto	Padua	Vighizzolo d' Este
46.	Veneto	Padua	Este
47.	Veneto	Padua	Casale Di Scodosia
48.	Veneto	Padua	Saletto
49.	Veneto	Rovigo	Lendinara
50.	Veneto	Rovigo	San Bellino
51.	Veneto	Rovigo	Porto Viro
52.	Veneto	Treviso	Silea
53.	Veneto	Treviso	Treviso
54.	Veneto	Treviso	Ponte Di Piave
55.	Veneto	Treviso	Orsago
56.	Veneto	Treviso	Volpago Del Montello
57.	Veneto	Venezia	Iesolo
58.	Veneto	Verona	Casaleone
59.	Veneto	Verona	Zevio
60.	Veneto	Verona	Isola Della Scala
61.	Veneto	Verona	San Bonifacio
62.	Veneto	Verona	Verona
63.	Veneto	Verona	San Giovanni Lupatoto
64.	Veneto	Verona	Ronco all' Adige
65.	Veneto	Verona	Erbè
66.	Veneto	Verona	Buttapietra
67.	Veneto	Verona	Salizzole
68.	Veneto	Verona	Bovolone
69.	Veneto	Verona	Zimella
70.	Veneto	Verona	Pescantina
71.	Veneto	Verona	Cologna Veneta
72.	Veneto	Verona	Veronella
73.	Veneto	Verona	Roverchiara
74.	Veneto	Verona	Bonavigo
75.	Veneto	Verona	Pressana
76.	Veneto	Verona	Isola Rizza
77.	Veneto	Verona	Nogarole Rocca
78.	Veneto	Verona	Cerea
79.	Veneto	Verona	Terrazzo
80.	Veneto	Verona	Mozzecane
81.	Veneto	Verona	Albaredo d' Adige
82.	Veneto	Verona	Cazzano Di Tramigna
83.	Veneto	Verona	Illasi
84.	Veneto	Verona	Oppeano
85.	Veneto	Verona	Trevenzuolo
86.	Veneto	Verona	Sorgà
87.	Veneto	Verona	Villafranca Di Verona
88.	Veneto	Verona	Angiari
89.	Veneto	Vicenza	Villaga
90.	Veneto	Vicenza	Noventa Vicentina
91.	Veneto	Vicenza	Montegalda
92.	Veneto	Vicenza	Castegnero
93.	Veneto	Vicenza	Albettone
94.	Veneto	Vicenza	Sossano
95.	Veneto	Vicenza	Orgiano
96.	Veneto	Vicenza	Campiglia Dei Berici
97.	Veneto	Vicenza	Longare
98.	Veneto	Vicenza	Camisano Vicentino
99.	Veneto	Vicenza	Pojana Maggiore

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë dhe të egër, zogjtë 24-orësh, shpendë dekorativë, materialit biologjik, vezët e shpendëve, mishi i shpendëve dhe nënproduktet e shpendëve, që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 493, datë 24.10.2022, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së Influencës Aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Italisë", shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

VENDIM
Nr. 576, datë 2.12.2022

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIN E UJËRAVE TË NDOTURA PËR SHOQËRINË UJËSJELLËS-KANALIZIME ELBASAN SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 21 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar (ligji nr. 8102); të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 539, datë 30.12.2021, "Për miratimin e metodologjisë dhe procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës-kanalizime",

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

Në mbledhjen e datës 2.12.2022, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike, mbi kërkesën e UK Elbasan sh.a. për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura, me anë të shkresës nr. 284 prot., datë 30.6.2022, me lëndë "Kërkesë për nivel të ri tarifor për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura", sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin nr. 8102 dhe vendimin nr. 539 të KKRR-së,

VËREN SE:

1. Paraqitja e kërkesës së shoqërisë UK Elbasan, për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura, është në përputhje me përcaktimet dhe procedurën e parashikuar në vendimin nr. 539, prandaj KKRR-ja, me vendimin 323, datë 14.7.2022, vendosi për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për ndryshim të tarifave të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Elbasan.

2. Ujësjellës-Kanalizime Elbasan, në dokumentacionin e paraqitur pranë ERRU me shkresë nr. 284 prot., datë 30.6.2022, "Kërkesë për nivel të ri tarifor për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura", propozon nivelet tarifore fikse dhe volumetrike për secilin shërbim, për periudhën rregullatore 5-vjeçare, sipas tabelës nr. 1.

Tabela 1. *Tarifat aktuale dhe të propozuara nga shoqëria UK Elbasan*

Kategoria e klientëve	Tarifat aktuale	Plani tarifor 5-vjeçar				
		2023	2024	2025	2026	2027
A. Shërbimi i FU-së	**lek/m³**	**lek/m³**	**lek/m³**	**lek/m³**	**lek/m³**	**lek/m³**
1. Klientë familjarë	38,35,25	42	48	54	58	60
2. Klientë publikë	115	140	140	140	140	140
3. Klientë privatë	130	160	160	160	160	160
B. Shërbimi i KUN-së	**lek/m³**	**lek/m³**	**lek/m³**	**lek/m³**	**lek/m³**	**lek/m³**
1. Klientë familjarë	8.3	9	10	11	11	11
2. Klientë publikë	25	25	25	25	25	25
3. Klientë privatë	30	30	30	30	30	30
C. Tarifë fikse shërbimi	**lek/muaj/ lidhje**	**lek/muaj/ lidhje**	**lek/muaj/ lidhje**	**lek/muaj/ lidhje**	**lek/muaj/ lidhje**	**lek/muaj/ lidhje**
1. Klientë familjarë	180	200				
2. Klientë publikë	500	500				
3. Klientë privatë	500	500				

Aktualisht janë në fuqi dy vendime për miratimin e tarifave, vendimi nr. 14, datë 27.12.2005, për zonën e qytetit të Elbasanit dhe komunën Bradashesh dhe vendimi nr. 19, datë 12.5.2015, për zonën e Elbasanit Fshat

3. Shoqëria, në relacionin e saj, e justifikon nevojën e ndryshimit të tarifave, sipas argumenteve të mëposhtme:

a) Aplikon për tarifa të unifikuara për zonën e qytetit dhe të fshatit, pasi janë në fuqi tarifat sipas vendimeve të mëparshme të KKRR-së për UK Elbasan qytet dhe U Elbasan Fshat;

b) Aplikon për tarifa pas një periudhe 17-vjeçare për zonën e qytetit dhe 7-vjeçare për zonën e fshatit, nga vendimet e fundit për tarifa;

c) Aplikon për nivel të ri tarifor, për shkak të rritjes së çmimeve/njësi të energjisë elektrike dhe materialeve, pasi 90% e ujit të prodhuar është me ngritje mekanike;

d) Nevoja për përmirësimin e performancës financiare, pasi, aktualisht, kostot operacionale mbulohen rreth 80%.

4. Gjatë procesit të analizës teknike ekonomike, sipas metodologjisë së llogaritjes së tarifave të përcaktuar në vendimin nr. 539, ERRU-ja ka kërkuar informacion të detajuar për të dhënat e raportuara në modelin e aplikimit dhe në planin e biznesit.

5. Në vlerësimin e tarifave të propozuara dhe në analizën ekonomike financiare janë marrë në konsideratë përmbushja nga UK Elbasan e kritereve të mëposhtme:

a) Kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe të akteve nënligjore dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë mbrojtjen e konsumatorëve nga çmimet monopol;

b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar (ligji nr. 9121), për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes nëpërmjet vendosjes, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të çmimeve të padrejta të shitjes apo të kushteve të tjera të tregtimit;

c) Kërkesave të ligjit nr. 9902, datë 17.4.2008, "Për mbrojtjen e konsumatorëve", të ndryshuar;

d) Kërkesave të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", veçanërisht sa i takon detyrimit të shoqërisë UK Elbasan për rishikim të tarifave pranë ERRU-së, pas riorganizimit;

e) Kërkesave të vendimit nr. 302, datë 11.5.2022, "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura";

f) Orientimin drejt mbulimit të kostove operacionale për shërbimet e furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura;

g) Tarifat e propozuara nuk sjellin për pasojë efekte negative në mjedis nga veprimtaria e operatorit në zonën e shërbimit që ato do të aplikohen;

h) Propozimin për miratimin e tarifave për të gjithë zonën për shërbimet e furnizimit me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura, ERRU-ja e gjen të justifikuar, por jo në nivelin e propozuar nga shoqëria, referuar analizës tekniko-ekonomike.

6. Në bazë të analizës, verifikimeve dhe komunikimit me stafin drejtues të shoqërisë, ERRU-ja ka vendosur detyra për t'u realizuar nga UK Elbasan:

a) Instalimi i matësve në burim *(bulk meter);*

b) Të kryejë vlerësimin e "Ujit të prodhuar", bazuar në regjistrimet ditore të prodhimit, në çdo pikë ku ai përftohet;

c) Të shfrytëzojë burimet ujore bazuar në kërkesën për ujë, për popullsinë e shërbyer;

d) Të organizojë task-forcën me ndihmën edhe të Bashkisë Elbasan, për evidentimin dhe eliminimin e lidhjeve të paligjshme në rrjetet e furnizimit për zonën urbane dhe rurale;

e) Të trajnojë stafin profesionist mbi njohjen, hartimin e bilancit të ujit me të dhëna sa më afër realitetit dhe përllogaritjen e komponentëve të tij sa më saktë, për të pasur situatë reale mbi UPA-në;

f) Të fokusohet në kryerjen e investimeve, për shkak të rrjedhjeve;

g) Të investojë në aparate ujëmatës, sidomos në zonat rurale ku shpërdorimi i ujit për vaditje dhe lidhjet e paligjshme mendohet të jenë në nivele të larta;

h) Të mirëmbajë sisteme të informacionit teknik dhe financiar, në përputhje me metodologjinë e vendosjes së tarifave, që të mundësohet verifikimi i të dhënave të parashikuara për t'u realizuar në vitin 2023;

i) Të hartojë planin e menaxhimit të aseteve dhe të mbajë në sistemet e kontabilitetit kostot e amortizimit të aseteve, sipas kërkesave të ERRU-së, referuar ndarjes që ka bërë në këtë model aplikimi, në mënyrë që të verifikohet realizimi i investimeve të parashikuara për t'u realizuar në vitin 2023;

j) Të ndërmarrë masa për përmirësimin e treguesit të normës së arkëtimit, si: monitorim i klientëve, ndërprerje të shërbimeve të klientëve që nuk paguajnë, gjithashtu, të shtohen qendrat ku paguhen faturat, pagesa bankare apo pagesa *online;*

k) Të kryejë studim mbi eficiencën e energjisë, në mënyrë që të operojë me kosto me efikase, duke ulur konsumin e energjisë elektrike apo të kimikateve gradualisht nëpërmjet reduktimit të ujit të prodhuar dhe të ulë numrin e punonjësve, duke bërë përpjekje për kosto eficiente, lidhur me kostot e punës.

Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi vlerësoi tarifat e propozuara nga operatori, mbi bazën e Metodologjisë së miratuar me vendim nr. 539, datë 30.12.2022, "Për miratimin e metodologjisë dhe të procedurës për miratimin e tarifave të shërbimeve ujësjellës-kanalizime", arrin në konkluzionin se tarifat e propozuara, sipas analizës së kryer janë të bazuara dhe në zbatim të kritereve ligjore referuese, lidhur me kostot e pranueshme dhe të justifikuara, si dhe përballueshmërinë, nuk janë të padrejta dhe të vendosura në kushtet e abuzimit me pozitën dominuese në treg të operatorit ekonomik në kuptim të ligjit nr. 9121, "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar, dhe ligjin nr. 9902, "Për mbrojtjen e konsumatorëve", për gjithë sa më sipër, në zbatim të neneve 13, 14 dhe 22 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Miratimin e tarifave për shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Elbasan, si më poshtë:

Tabela 2. *Tarifat e miratuara nga ERRU-ja për shoqërinë UK Elbasan*

Kategoria e klientëve	Tarifat sipas vendimit në zonën e shërbimit
A. Tarifa volumetrike për shërbimin FU	**lek/m³**
1. Klientë familjarë	40
2. Klientë publikë	130
3. Klientë privatë	130
B. Tarifa volumetrike për shërbimin KUN	**lek/m³**
1. Klientë familjarë	9
2. Klientë publikë	30
3. Klientë privatë	30

C. Tarifë fikse shërbimi	lek/muaj/lidhje
1. Klientë familjarë	200
2. Klientë publikë	400
3. Klientë privatë	400

2. Objektivat e Treguesve Kryesorë të Performancës për vitin 2023, për UK Elbasan, do të jenë:

Tabela 3. *Objektivat e Treguesve të Performancës për vitin 2023 sipas ERRU-së*

TKP	№	Emri i TKP-ve	Njësia TKP	Niveli i objektivit për vitin 2023 të përcaktuar nga KKRR-ja
Mbulimi me shërbim	1.1	Mbulimi me shërbimin e FU-së	%	77.45
	1.2	Mbulimi me shërbimin me KUN-në	%	60.16
TKP teknike	2.1	Uji pa të ardhura	%	70.61
	3	Niveli i matjes	%	86.80
	4	Vazhdimësia e FU-së	orë/ditë/popullsi	12.28
	5	Efikasiteti i energjisë për ujin	kwh/m³	0.48
	6	Eficienca e stafit	nr./nr./1000	2.35
Shërbimi ndaj klientit	7.1	Ankesat e klientëve	%	10.69
	7.2	Ankesat e klientëve që kanë marrë përgjigje	%	94.44
	7.3	Ankesat e klientëve që kanë marrë zgjidhje	%	8.95
TKP financiare	8.1	Norma korrente e arkëtimit	%	77
	8.2	Norma e përgjithshme e arkëtimit	%	108
	9.1	Mbulimi i kostos operacionale për FU-në	%	79.95
	9.2	Mbulimi i kostos operacionale për KUN-në	%	85.84
	10.1	Mbulimi i kostos totale për ujin	%	65.83
	10.2	Mbulimi i kostos totale për kanalizime	%	62.88

3. Pagesa rregullatore vjetore për shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Elbasan sh.a. do të jetë 0.6% e të ardhurave vjetore të parashikuara nga aktiviteti.

4. Lidhjen e kontratës me UK Elbasan, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit, sipas pikës 4, të nenit 22, të ligjit nr. 8102.

5. Shfuqizohet vendimi i KKRR-së nr. 14, datë 27.12.2005, "Për ndryshimin e tarifave, si rezultat i ndryshimit të çmimit të energjisë elektrike", dhe vendimi i KKRR-së nr. 19, datë 12.5.2015, "Mbi tarifat e ujit për konsum publik për shoqërinë U Elbasan Fshat sh.a.".

6. Ky vendim hyn në fuqi me datë 1.1.2023 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

VENDIM
Nr. 578, datë 2.12.2022

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME KORÇË SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar (ligji nr. 8102); të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence" (VKM nr. 958); si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar (Rregullore e licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 2.12.2022, pasi shqyrtoi çështjen me objekt "Mbi miratimin e vendimit 'Për licencimin e shoqërisë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Korçë sh.a.'",

KONSTATON SE:

1. Shoqëria rajonale Ujësjellës-Kanalizime Korçë sh.a., me shkresën nr. 517 prot., datë 2.11.2022, si dhe me plotësimet me anë të shkresës nr. 533 prot., datë 14.11.2022, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për licencim.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim të Shoqërisë Rajonale UK Korçë sh.a. në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe rregulloren e licencimit, "Për procedurat e dhënies dhe të rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM-së nr. 302, datë 11.5.2022, "Për politikat kombëtare për riorganizimin e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të Largimit, Trajtimit dhe Përpunimit të Ujërave të Ndotura" (VKM nr. 302).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) Shoqëria rajonale Ujësjellës-Kanalizime Korçë sh.a. (NUIS M24431001N) është themeluar më datë 12.7.2022, me aksionarë Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, me 51% dhe bashkitë Korçë me 28.29%, Kolonjë me 3.64%, Devoll me 7.76%, Maliq me 8.67%, Pustec me 0.63%.

b) Shoqëria Rajonale UK Korçë sh.a. ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 152 548 banorë të bashkive Korçë, Kolonjë, Devoll, Maliq;

c) Shoqëria Rajonale UK Korçë sh.a. ofron shërbimin trajtimit të ujërave të ndotura për 85 000 banorë të Bashkisë Korçë;

d) Drejtuesi teknik i shoqërisë, z. Pandi Qirinxhi, është diplomuar në Universitetin Politeknik, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, Dega Gjeodezi, në vitin 1985 dhe plotëson kërkesat e VKM-së nr. 958 mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion.

e) Drejtuesi teknik i shoqërisë për impiantin e përpunimit të ujërave të ndotura, z. Aleks Andoni, është diplomuar në Universitetin e Tiranës, në degën Kimi industriale, në vitin 1993 dhe plotëson kërkesat e VKM-së nr. 958 mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim për herë të parë ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e shoqërisë Rajonale UK Korçë sh.a., të:

a) Kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe të kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve, në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar (ligji nr. 9121), për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes, veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve;

5. ERRU-ja, në bazë të vlerësimit dhe të verifikimeve të kërkesës së Shoqërisë Rajonale UK Korçë, rekomandon:

- Shoqëria Rajonale UK Korçë të pajiset me akt miratime higjieno-sanitare për të gjithë zonën e shërbimit, duke përfshirë edhe Bashkinë Pustec.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin, se kërkesa e shoqërisë Rajonale UK Korçë sh.a. është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Korçë sh.a. me NUIS: M24431001N, në kategoritë:

a) kategoria A: "Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik";

b) kategoria C: "Për largimin e ujërave të ndotura";

c) kategoria D: "Për trajtimin e ujërave të ndotura".

2. Shoqëria rajonale Ujësjellës-Kanalizime Korçë sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara. me:

a) drejtues ligjor: Petrit Tare;

b) drejtues teknik: Pandi Qirinxhi;

c) drejtues teknik: Aleks Andoni.

3. Zonat e shërbimit të shoqërisë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Korçë sh.a. janë bashkitë Korçë, Kolonjë, Devoll, Maliq.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 2-vjeçare.

5. Vendimi i KKRR-së nr. 40, datë 27.1.2021, "Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Korçë sh.a.", shfuqizohet;

6. Vendimi i KKRR-së nr. 476, datë 9.12.2021, "Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Devoll sh.a.", shfuqizohet;

7. Vendimi i KKRR-së nr. 390, datë 21.10.2021, "Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Maliq sh.a.", shfuqizohet;

8. Drejtuesi ligjor i shoqërisë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Korçë sh.a detyrohet të nënshkruajë Kushtet e Licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

9. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Korçë sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

VENDIM
Nr. 579, datë 2.12.2022

PËR LICENCIMIN PËR HERË TË PARË TË SHOQËRISË RAJONALE UJËSJELLËS-KANALIZIME LEZHË SHA

Në mbështetje të neneve 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM nr. 958, datë 6.5.2009, "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence" (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar (rregullore e licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 2.12.2022 pasi shqyrtoi çështjen me objekt: "Mbi miratimin e vendimit 'Për licencimin për herë të parë të shoqërisë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Lezhë sh.a.'",

KONSTATON SE:

1. Shoqëria rajonale Ujësjellës-Kanalizime Lezhë, me shkresën nr. 68 prot., datë 7.11.2022, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për licencim.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim të Shoqërisë Rajonale UK Lezhë në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM nr. 958 dhe Rregulloren e licencimit "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM nr. 302, datë 11.5.2022 "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura" (VKM nr. 302).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) shoqëria rajonale Ujësjellës-Kanalizime Lezhë sh.a. (NUIS M28314503C) është themeluar më datë 9.9.2022, me aksionarë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë 51%, Bashkia Mirditë 5.88 %, Bashkia Lezhë 30.71%, Bashkia Kurbin 12.4 %;

b) shoqëria rajonale UK Lezhë aplikon për licencim për herë të parë si shoqëri e re, për shërbimin e furnizimit me ujë, largimit të ujërave të ndotura dhe trajtimin e ujërave të ndotura.

c) drejtues ligjor i shoqërisë rajonale është z. Zef Maçi i diplomuar në Universitetin Politeknik Tiranës, Fakulteti Inxhinieri Mekanike në vitin 1982;

d) drejtues teknik i shoqërisë është z. Petrit Bardhi i diplomuar në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike, në vitin 1994 dhe ka mbi 5 vjet përvojë në profesion, sipas kritereve të përcaktuara në VKM nr. 958;

e) drejtues teknik i shoqërisë për impiantin është znj. Suela Lekgjonaj (Simoni) i diplomuar në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Dega Hidroteknikë në vitin 2016 dhe ka mbi 5 vite përvojë në profesion, sipas kritereve të përcaktuara në VKM nr. 958;

f) shoqëria rajonale UK Lezhë deklaron se ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 117 000 banorë të bashkive Lezhë, Kurbin dhe Mirditë;

g) shoqëria rajonale UK Lezhë sh.a. ofron shërbimin e trajtimit të ujërave të ndotura për 50 000 banorë të Bashkisë Lezhë.

4. ERRU-ja në vlerësimin e kërkesës për licencim për herë të parë, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e Shoqërisë Rajonale UK Lezhë, të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102 si dhe kuadrit rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar (ligji nr. 9121), për moslejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve;

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e shoqërisë rajonale UK Lezhë është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Lezhë sh.a., me (NUIS M28314503C), në kategoritë:

a) kategoria A: "Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik";

b) kategoria C: "Për largimin e ujërave të ndotura";

c) kategoria D: "Për trajtimin e ujërave të ndotura".

2. Shoqëria rajonale Ujësjellës-Kanalizime Lezhë sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara, me:

a) drejtues ligjor: Zef Maçi;

b) drejtues teknik: Petrit Bardhi;

c) drejtues teknik: Suela Lekgjonaj.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Lezhë sh.a. është Bashkia Lezhë, Mirditë dhe Kurbin.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Vendimi i KKRR-së nr. 447, datë 23.11.2021, "Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Lezhë sh.a.", shfuqizohet;

6. Vendimi i KKRR-së nr. 379, datë 31.8.2022, "Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Kurbin sh.a.", shfuqizohet;

7. Vendimi i KKRR-së nr. 109, datë 18.9.2020, "Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Mirditë sh.a.", i ndryshuar, shfuqizohet;

8. Drejtuesi ligjor i shoqërisë rajonale Ujësjellës-Kanalizime Lezhë sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

9. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Lezhë sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani

KËRKESË
Nr. 603/10, datë 15.12.2022

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ujësjellësi i fshatit Duhanas, fshati Lapardha 1, Otllak dhe Orizaj", Berat, me vlerë totale paraprake të shpronësimit 137,025 (njëqind e tridhjetë e shtatë mijë e njëzet e pesë) lekë.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Berat.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohet sipas vlerësimit paraprak të llogaritur:

- Për pasuritë e llojit "arë" është bërë bazuar në VKM nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara, për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Bashkisë Berat, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 137,025 (njëqind e tridhjetë e shtatë mijë e njëzet e pesë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMEVE
Egra Ibrahimi

LISTA EMËRORE PARAPRAKE E PRONARËVE QE SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK, NGA PROJEKTI "UJËSJELLËSI I FSHATIT DUHANAS, FSHATI LAPARDHA 1 OTLLAK DHE ORIZAJ", BERAT

NR.	PRONARI			TË DHËNA HIPOTEKORE						VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM "ARË"			Vlera totale	SHËNIME (D+E) Kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë etj.)
	EMRI	ATËSIA	MBIEMRI	Fshati ose qyteti	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	"Arë" (m²)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)		
	A	B	C	Ç	Ç	D	E	F	G	L	M	N		Z
1	Sulo	Rexhep	Toska	Berat	1561	181/6	Arë	1200	1200	675	203	137,025.00	137,025.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
	SHUMA TOTALE PARAPRAKE												137,025.00	

KËRKESË
Nr. 681/7, datë 14.12.2022

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësim shpall "Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti 'Rikonstruksioni i linjës 35 kV Korçë–Bilisht'".

Subjekti kërkues i këtij projekti është Operatori i Sistemit të Shpërndarjes.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, "Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti 'Rikonstruksioni i linjës 35 kV Korçë-Bilisht'".

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat, të cilët preken por nuk figurojnë në këtë listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim.

Vlera totale paraprake e 700,285 (shtatëqind mijë e dyqind e tetëdhjetë e pesë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMEVE
Egra Ibrahimi

LISTA PARAPRAKE
E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN, PËR INTERES PUBLIK, NGA PROJEKTI "RIKONSTRUKSIONI I LINJËS 35 kV, KORÇË–BILISHT"

Nr.	PRONARI			TË DHËNA HIPOTEKARE										VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM												SHËNIME *(kufizime hipotekare, barrë mbi pasurinë etj.)*
														ARË			TRUALL			NDËRTESË			Vlerat e kulturave bujqësore dhe dru-frutorëve, sipas proces-verbalit të Drejtorisë së Bujqësisë		VLERA TOTALE (lek)	
				Fshati ose qyteti	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Arë (m²)	Truall" (m²)	Ndërtesë (m²)	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lek/m²)	Vlera (lek)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lek/m²)	Vlera (lek)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lek/m²)	Vlera (lek)	Vlera e kulturës bujqësore (lek)	Vlera e dru-frutorëve (lek)		
	A	*B*	*C*	*C*	*Ç*	*D*	*E*	*F*	*G*	*H*	*I*	*J*	*K*	*L*	*M*	*N*	*O*	*P*	*Q*	*R*	*S*	*T*	*U*	*V*	*Y*	*Z*
	Bashkia Korçë **ASHK Korçë**																									
	NB Korça																									
1	Shtylle ekzistuese			"																						
2	Doloreza	Ferid	Hoxhallari	"	**8561**	**9/288**	Truall	482		482							**49**	8537	418,313						418,313	
3	Musa	Ramadan	Kalemi	"	**8561**	**8/338**	Arë	863	863					**72**	100	7200									7200	
4	Shtet			"	**8561**	**10/169**	Arë	285	285					**56**												
5	Bujar		Qarri	"	**8561**	**10/47**	Arë	2816	2816					**42**	100	4200									4200	
6	Shtet			"	**8561**	**11/159**	Arë	23907.23	23907.23					**64**												
7	Shtet			"	**8561**	**11/159**	Arë	23907.23	23907.23					**64**												
Barç																										
8	Tushe	Refik	Likollari	"	**1101**	**214/21**	Arë	3900	3900					**30**	100	3000									3000	
9	Spiro	Jorgo	Ziko	"	**1101**	**214/8**	Arë	3521	3521					**30**	100	3000									3000	
10	Hekuran	Nexhip	Dapellari	"	**1101**	**695/6**	Arë	4495	4495					**30**	100	3000									3000	
11	Yrmet	Asllan	Xhakolli	"	**1101**	**202/28**	Arë	2000	2000					**30**	100	3000									3000	
12	Hysen	Hasan	Ceko	"	**1101**	**201/13**	Arë	7268	7268					**30**	100	3000									3000	
13	Qemal	Xhevdet	Dedelli	"	**1101**	**200/1**	Arë	3738	3738					**49**	100	4900									4900	
Dishnicë																										
14	Dëfrim	Mustafa	Prisoj	"	**1491**	**69/8**	Arë	4423	4423					**30**	170	5100									5100	
15	Dhori	Thanas	Androllari	"	**1491**	**71/23**	Arë	1485	1485					**30**	170	5100									5100	
16	Vajdin	Shaban	Alimi	"	**1491**	**72/5**	Arë	1356	1356					**36**	170	6120									6120	
17	PPV			"	**1491**	**484**	Arë							**30**												Pasuria nuk figuron e pasqyruar në HTR.
18	Shtet			"	**1491**	**30/23**	Arë	230	230					**36**												
Neviçisht																										
19	Nexhdet	Tefik	Xhaholli	"	**2783**	**271/88**	Arë	937.55	937.55					**36**	100	3600									3600	
20	Anila Elvi	Muhamer Gjergji	Agolli Agolli	"	**2783**	**271/73**	Arë	2480	2480					**36**	100	3600									3600	
21	Gëzim	Xhevair	Xhaholli	"	**2783**	**229/61**	Arë	1995	1995					**30**	100	3000									3000	
22	Shtet			"	**2783**	**553**	Arë	1600	1600					**72**												

Belorta																										
23	Adem	Sali	Benga	"	**1145**	**199/179**	Vreshtë	342	342					**36**	100	3600									3600	
24	Ismail	Seit	Xhialli	"	**1145**	**121/38**	Arë	264	264					**36**	100	3600									3600	
25	Viktor	Maliq	Dakolli	"	**1145**	**142**	Arë	2322	2322					**72**	100	7200									7200	
26	Ekuran	Zenel	Skotolli	"	**1145**	**130/92**	Arë	920	920					**30**	100	3000									3000	
27	Shtet			"	**1145**	**137/67**	Varreza	2700	2700					**56**												

Mbyllet me nr. rendor 27 *(njëzet e shtatë)*

LISTA PARAPRAKE
E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN, PËR INTERES PUBLIK, NGA PROJEKTI "RIKONSTRUKSIONI I LINJËS 35 kV, KORÇË–BILISHT"

Nr.	PRONARI			TË DHËNA HIPOTEKARE										VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM												SHËNIME *(kufizime hipotekare, barrë mbi pasurinë etj.)*
														ARË			TRUALL			NDËRTESË			Vlerat e kulturave bujqësore dhe dru-frutorëve. sipas proces-verbalit të Drejtorisë së Bujqësisë		VLERA TOTALE (lek)	
				Fshati ose qyteti	**Zona kadastrale**	**Nr. i pasurisë**	**Lloji i pasurisë**	**Sipërfaqja totale**	**Arë** (m^2)	**Truall** (m^2)	**Ndërtesë** (m^2)	**Volumi**	**Faqe**	**Sipërfaqja** (m^2)	**Çmimi** (lek/m^2)	**Vlera** (lek)	**Sipërfaqja** (m^2)	**Çmimi** (lek/m^2)	**Vlera** (lek)	**Sipërfaqja** (m^2)	**Çmimi** (lekë/m^2)	**Vlera** (lek)	**Vlera e kulturës bujqësore** (lekë)	**Vlera e dru-frutorëve** (lekë)		
	A	*B*	*C*	*C*	*Ç*	*D*	*E*	*F*	*G*	*H*	*I*	*J*	*K*	*L*	*M*	*N*	*O*	*P*	*Q*	*R*	*S*	*T*	*U*	*V*	*Y*	*Z*
	Bashkia Korçë																									
	ASHK Korçë																									
				Kuç i Zi																						
28	Asllan	Sherif	Hoxha	"	**2307**	**102/4**	Truall + Arë	1550	1550			5	141	**49**	100	4900									4900	
29	Agim	Qerim	Osmanlli	"	**2307**	**89/45**	Arë	1380	1380			7	250	**30**	100	3000									3000	
30	Shtet			"	**2307**	**90/37**	Pemëtore	1363	1363			4	39	**49**												
31	Henë Blerta Emanuela Admir	Resul Kurtali	Liço	"	**2307**	**91/93/8**	Are	600	600					**36**	100	3600									3600	
Plasë																										
32	Shtet			"	**2984**	**479**	Pyll	305170	305170					**30**												
33	Shtet			"	**2984**	**479**	Pyll	305170	305170					**30**												
34	Shtet			"	**2984**	**479**	Pyll	305170	305170					**36**												
35	Shtet			"	**2984**	**479**	Pyll	305170	305170					**49**												
36	Shtet			"	**2984**	**477**	Pyll	409893	409893					**30**												
37	Shtet			"	**2984**	**474**	Pyll	494945	494945					**30**												
38	Shtet			"	**2984**	**474**	Pyll	494945	494945					**72**												
39	Shtet			"	**2984**	**472**	Pyll	306175	306175					**30**												
40	Shtet			"	**2984**	**84/10**	Veshtë	2344	2344					**30**												
41	Maksut Almir	Sali Maksut	Isufi Sali	"	**2984**	**211/32**	Veshtë	400	400					**30**	170	5100									5100	
42	Shtet			"	**2984**	**481**	Pyll	39492	39492					**30**												

Zemblak																										
43	Rep. Shqipërisë *(B. Maliq)*			"	**3903**	**268/2**	Truall	4540		4540				**30**												Në bazë të VKM-së nr. 1154, datë 13.8.2008, kjo pasuri kalon n përdorim t Bashkisë Maliq, 18.1.2021
44	Shtet			"	**3903**	**282**	Rrugë	12150	12150					**30**												
45	Skender	Asllan	Kulla	"	**3903**	**143/13**	Arë	1177	1177					**36**	100	3600									3600	
46	Almir	Minir	Bregolli	"	**3903**	**153/3**	Arë	876	876					**72**	100	7200									7200	
47	Shtet			"	**3903**	**116/63**	Pa frutë	288	288					**49**												
48	Shtet			"	**3903**	**314/25**	Kënetë	2880	2880					**49**												
49	Minir	Nevrus	Bregu	"	**3903**	**314/11**	Arë	1420	1420					**30**	100	3000									3000	
50	Shtet			"	**3903**	**356**	Kullotë	19405	19405					**30**												
51	Bashkia Maliq			"	**3903**	**363**	Pyll	32217	32217					**30**												
52	Bashkia Maliq			"	**3903**	**361**	Pyll	81683	81683					**64**												
53	Bashkia Maliq			"	**3903**	**361**	Pyll	81683	81683					**49**												

Mbyllet me nr. rendor 53 *(pesëdhjetë e tre)*

LISTA PARAPRAKE
E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA PROJEKTI "RIKONSTRUKSIONI I LINJËS 35 kV, KORÇË–BILISHT"

Nr.	PRONARI			TË DHËNA HIPOTEKARE										VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM												SHËNIME *(kufizime hipotekare, barrë mbi pasurinë etj.)*
														ARË			TRUALL			NDËRTESË			Vlerat e kulturave bujqësore dhe drufrutorëve, sipas procesverbalit të Drejtorisë së Bujqësisë		VLERA TOTALE (lek)	
				Fshati ose qyteti	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Arë (m^2)	Truall (m^2)	Ndërtesë (m^2)	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m^2)	Çmimi (lek/m^2)	Vlera (lek)	Sipërfaqja (m^2)	Çmimi (lek/m^2)	Vlera (lek)	Sipërfaqja (m^2)	Çmimi (lek/m^2)	Vlera (lek)	Vlera e kulturës bujqësore (lek)	Vlera e drufrutorëve (lek)		
	A	*B*	*C*	*C*	*Ç*	*D*	*E*	*F*	*G*	*H*	*I*	*J*	*K*	*L*	*M*	*N*	*O*	*P*	*Q*	*R*	*S*	*T*	*U*	*V*	*Y*	*Z*
	Bashkia Devoll **ASHK Devoll** **Cangonj**																									
54	Idahet	Shaban	Bajraktari	"	**1355**	**118/2**	Arë	1200	1200					**36**	225	8100									8100	
55	PPV			"	**1355**	**281**								**49**												Pasuri e paidentifikuar
56	Shtet			"	**1355**	**110**	Pemëtore	92800	92800					**30**												
57	PPV			"	**1355**	**109**	Pemëtore							**72**												Pasuria nuk figuron e pasqyruar në HTR
58	Mustafa	Sami	Shehu	"	**1355**	**104/3**	Arë+Truall	1280	930	350	91			**30**	225	6750									6750	
59	Shtet			"	**1355**	**309/2**	Pyll	1549973.00						**36**												
60	PPV			"	**1355**	**69/1**	Pemëtore							**36**												Pasuria nuk figuron e pasqyruar në HTR
61	Shtet			"	**1355**	**158/1**	Pyll	329400						**30**												
62	Shtet			"	**1355**	**158/1**	Pyll	329400						**49**												
63	Shtet			"	**1355**	**57**	Pyll	86760						**30**												

64	Fuat	Haki	Mati	"	**1355**	**56/16**	Arë	538	538					**30**	225	6750									6750	
65	Azem	Fari	Çibuku	"	**1355**	**56/2**	Arë	3101	3101					**30**	225	6750									6750	
Vranisht																										
66	Subi	Mustafa	Taho	"	**3822**	**195/17**	Arë	3600	3600					**30**	168	5040									5040	
67	Shtet			"	**3822**	**489**	Kanal	15158	15158					**30**												Në seksionin C të kartelës ka shënimin: VKM nr. 557, datë 29.9.2021, "Për të drejtën e administrimit/përdorimit TAP AG Albania"
68	Arti	Ytbi	Koroli	"	**3822**	**208/314**	Arë	600	600					**30**	168	5040									5040	
69	PPV			"	**3822**	**206**								**30**												Pasuria nuk figuron e pasqyruar në HTR
70	PPV			"	**3822**	**249/2**	Arë	500	500					**49**												Pasuria nuk figuron e pasqyruar në HTR
71	Hasan	Ismail	Stergu	"	**3822**	**249/5**	Arë	6800	6800					**30**	168	5040									5040	
72	Dashi	Shyqyr	Hoxha	"	**3822**	**258/20**	Arë	2910	2910					**49**	168	8232									8232	
73	Fatmir	Sabri	Zizolli	"	**3822**	**258/5**	Arë	2600	2600					**36**	168	6048									6048	
Pilur																										
74	Setar	Bexhet	Kaprelli	"	**2959**	**258/20**	Arë	3459	3459					**36**	168	6048									6048	
75	Fatmir	Hysen	Spaho	"	**2959**	**340/10**	Arë	2008	2008					**30**	168	5040									5040	

LISTA PARAPRAKE
E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA PROJEKTI "RIKONSTRUKSIONI I LINJËS 35 kV KORÇË-BILISHT"

Nr.	**PRONARI**			**TË DHËNA HIPOTEKARE**										**VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM**												**SHËNIME** *(Kufizime hipotekare, barrë mbi pasurinë etj.)*
														ARË			**TRUALL**			**NDËRTESË**			**Vlerat e kulturave bujqësore dhe dru-frutorëve, sipas proces-verbalit të Drejtorisë së Bujqësisë**		**VLERA TOTALE (lek)**	
				Fshati ose qyteti	**Zona kadastrale**	**Nr. i pasurisë**	**Lloji i pasurisë**	**Sipërfaqja totale**	**Arë** (m^2)	**Truall** (m^2)	**Ndërtesë** (m^2)	**Volumi**	**Faqe**	**Sipërfaqja** (m^2)	**Çmimi** (lek/m^2)	**Vlera** (lek)	**Sipërfaqja** (m^2)	**Çmimi** (lek/m^2)	**Vlera** (lek)	**Sipërfaqja** (m^2)	**Çmimi** (lek/m^2)	**Vlera** (lek)	**Vlera e kulturës bujqësore** (lek)	**Vlera e dru-frutorëve** (lek)		
	A	*B*	*C*	*C*	*Ç*	*D*	*E*	*F*	*G*	*H*	*I*	*J*	*K*	*L*	*M*	*N*	*O*	*P*	*Q*	*R*	*S*	*T*	*U*	*V*	*Y*	*Z*
	Bashkia Devoll **ASHK Devoll**																									
	Eçmenik																									
76	Sotir	Nuri	Dragoj	"	**1588**	**25/7**	Arë	3435	3435					**30**	168	5040									5040	
77	Dervish	Selman	Malo	"	**1588**	**24/43**	Arë	2697	2697					**49**	168	8232									8232	
Bitinckë																										
78	Simo	Hysen	Bregu	"	**1202**	**469/26**	Arë	5000	5000					**30**	225	6750									6750	
79	SHTET			"	**1202**	**475**	Lumë	247900	247900					**30**												
80	Skënder	Abidin	Xhafi	"	**1202**	**464/5**	Arë	4000	4000					**30**	225	6750									6750	

81	Astrit	Haxhi	Kodra	"	**1202**	**478/6**	Arë	3824	3824					**30**	225	6750								6750	
82	Barjam	Suleman	Topalli	"	**1202**	**480/3**	Arë	5800	5800					**30**	225	6750								6750	
83	Djana Restina Xhoana Erdis	Ali Gëzim " "	Hysi " " "	"	**1202**	**481/3**	Arë	6232	6232					**30**	225	6750								6750	
84	Hytbi	Suleman	Sllogu	"	**1202**	**766/3**	Arë	6206	6206					**30**	225	6750								6750	
85	Elisa Eraldi Redina	Ismail " "	Mersuli " "	"	**1202**	**767/6**	Arë	7144	7144					**30**	225	6750								6750	
86	Urim Fabjola	Remzi "	Xhemo Taçelli	"	**1202**	**769/3**	Arë	6300	6300					**30**	225	6750								6750	
87	Sami	Sali	Xhemo	"	**1202**	**770/2**	Arë	4204	4204					**30**	225	6750								6750	
88	Avni	Reshat	Hysi	"	**1202**	**771/2**	Arë	3600	3600					**30**	225	6750								6750	
89	Ali	Ibrahim	Bujku		**1202**	**773/2**	Arë	5643	5643					**30**	225	6750								6750	
90	Erjon Arben Dritan	Remzi Tefik Dashmir	Revani Qorllari Bode	"	**1202**	**792/67**	Truall	1120	1120					**56**	357	19992								19992	
91	Shtet			"	**1202**	**827**	Truall	4100		4100				**72**											
SHUMA																**281,972**			**418,313**					**700,285**	

KËRKESË
Nr. 837/4, datë 14.12.2022

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësim shpall kërkesën "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtim argjinature mbrojtëse nga lumi 'Shkumbin' në Krastë, në kuadër të projektit 'Lungo Fiume', Elbasan".

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Elbasan.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen, sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, për pasuritë e llojit "arë" bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Bashkinë Elbasan, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 161,829 (njëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e tetëqind e njëzet e nëntë) lekë.

DREJTOR I PËGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMEVE
Egra Ibrahimi

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA PROJEKTI "NDËRTIM ARGJINATURE MBROJTËSE NGA LUMI 'SHKUMBIN' NË KRASTË, NË KUADËR TË PROJEKTIT 'LUNGO FIUME', ELBASAN"

NR.	PRONARI			TË DHËNA HIPOTEKARE											VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM												SHËNIME (D+E) (Kufizime hipotekare, barrë mbi pasurinë etj.)
															ARË			KULLOTË			PYLL			Vlerat e kultura bujqësore dhe dru-frutorëve sipas proces-verbalit të Drejtorisë së Bujqësisë		VLERA TOTALE (lek)	
	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshati ose qyteti	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Arë (m²)	Kullotë (m²)	Pyll (m²)	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lek/m²)	Vlera (lek)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lek)	Sipërfaqja(m²)	Çmimi (lek/m²)	Vlera (lek)	Vlera e kulturës bujqë-sore (lek)	Vlera e dru-frutorëve (lek)		
	A	B	C	Ç	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M	N	O	P	Q	R	S	T	U	V	X	Y	Z
1	Suzana Nevrez	Xhavit Xhavit	Maliqi Gjylbegu	Hajdaran Elbasan	1919	15/6/1	Pyll	9687	0	0	9687			0	0	0	0	0	0	423	85	35955	0	0	35955	Konfirmuar nga ASHK-ja
2	Refat	Met	Qefalia	Shushicë Elbasan	3445	210/1	Arë	4200	4200	0	0			258	222	57276	0	0	0	0	0	0	0	0	57276	Konfirmuar nga ASHK-ja
3	Mehmet	Zenel	Qefalia	Shushicë Elbasan	3445	210/4	Arë	7740	7740	0	0			309	222	68598	0	0	0	0	0	0	0	0	68598	Konfirmuar nga ASHK-ja Konfirmuar nga ASHK-ja Konfirmuar nga ASHK-ja Konfirmuar nga ASHK-ja
4	SHTET			Shushicë Elbasan	3445	213/4	Kullotë	582990	0	582990	0			0	0	0	29144	0	0	0	0	0	0	0	0	Konfirmuar nga ASHK-ja
5	SHTET			Shushicë Elbasan	3445	209/22	Arë	2687	2687	0	0			371	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	Konfirmuar nga ASHK-ja
6	SHTET			Shushicë Elbasan	3445	209/5/2	Arë	2177	2177	0	0			1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	Konfirmuar nga ASHK-ja
7	SHTET			Shushicë Elbasan	3445	209/7/2	Arë	1330	1330	0	0			90	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	Konfirmuar nga ASHK-ja
8	SHTET			Hajdaran Elbasan	1919	96/1	Arë	27000	27000	0	0			4603	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	Konfirmuar nga ASHK-ja. Sipas shkresës nr. 1144 prot., datë 4.4.2016 të ATP-së, kjo pasuri bllokohet në favor të ATP-së. Bllokim
9	SHTET			Hajdaran Elbasan	1919	93/1	Pyll	8812	0	0	8812			0	0	0	0	0	0	20	0	0	0	0	0	Konfirmuar nga ASHK-ja
10	SHTET			Elbasan	8527	306/68	Arë	9057	9057	0	0	4	155	2084	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	Konfirmuar nga ASHK-ja
11	SHTET			Elbasan	8527	306/71	Arë	1518	1518	0	0	4	157	445	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	Konfirmuar nga ASHK-ja
12	SHTET			Elbasan	8527	306/72	Ledh	118	0	0	0	5	13	0	0	0	116	0	0	0	0	0	0	0	0	Konfirmuar nga ASHK-ja
	SHUMA PARAPRAKE																								161829	

NR. REGJ. THEM.(41201-04241) 1182/2759, DATË 22.10.2021

VENDIM
Nr. 143, datë 20.10.2022

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës e përbërë prej:

Gjyqtare: Shpëtime Pitaku

Asistuar nga sekretarja Lulzime Sofka, në Durrës, më datë 20.10.2022 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura, çështjen civile nr. 1182/2759, datë 22.10.2021, regjistrimi, që i përket:

PADITËS: Ymer Lushakaj, i biri i Avdylit dhe i Zizes, i datëlindjes 3.4.1956, lindur në Fier dhe banues në Fier, me adresë: lagjja "29 Nëntori", Fier ose në hotel "Dolce Vita" te Shkëmbi i Kavajës, me arsim të lartë, i martuar, me 4 fëmijë, pensionist, adresa hotel "Dolce Vita" Golem, përfaqësuar nga av. Mirjan Moci, me nr. licence dhe nr. NIPT K31714511N, anëtar i Dhomës së Avokatisë Dega Durrës, në prani dhe në mungesë në të gjitha shkallët e gjykimit.

PALË E PADITUR: 1. Shoqëria "Fidens Project Finance", ortak në shoqërinë "Dyrrahu Konstruksion" sh.p.k., me NIPT K72215501C, me seli në lagjen 4, Rruga Skënderbeg, pallati 405, shkalla 7/1, Durrës.

2. Shoqëria "Dyrrahu Konstruksion", me adresë: lagjja nr. 4, Rruga Skënderbeg", pallati 405, hyrja 7/1, Durrës.

PALË E TRETË: 1. Qendra Kombëtare e Biznesit, dega Durrës.

2. Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës, me adresë në Durrës.

3. Avokatura e Shtetit, Zyra Vendore Durrës.

OBJEKTI: 1. Prishjen e shoqërisë "Dyrrahu Konstruksion" sh.p.k., NIPT L72215501C.

2. Likuidimin e shoqërisë "Dyrrahu Konstruksion" sh.p.k., NIPT L72215501C.

3. Urdhërimin e QKB-së për çregjistrimin e shoqërisë "Dyrrahu Konstruksion" sh.p.k., me NIPT L72215501C.

BAZA LIGJORE: Ligji nr. 110/2016, "Për falimentimin", dhe neni 99, i ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"; nenet 48, 51, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për QKB-në", i ndryshuar; ligji "Për procedurat tatimore", i ndryshuar.

Gjykata konstaton kryesisht se çështja bën pjesë në juridiksionin gjyqësor, sipas përcaktimeve të nenit 36 e vijues të K. Pr. Civile dhe, se në bazë të neneve 41 e 42 e vijuese të K. Pr. Civile, ajo është kompetente për shqyrtimin e saj.

Në përfundim të gjykimit të zhvilluar në prani të palëve ndërgjyqëse, këta kërkuan:

Pala paditëse – Pranimin e padisë.

Pala e tretë: Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës – I kërkojmë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës të marrë në konsideratë pretendimet e paraqitura më lart prej nesh, me qëllim përmbylljen sa më të shpejtë dhe në përputhje me parashikimet ligjore të procedurës së falimentit.

Gjykata, pasi shqyrtoi aktet dhe dëgjoi pretendimet e palëve në gjykim, lidhur me çështjen civile,

VËREN:

Më datë 22.10.2021, pranë kësaj Gjykatë është regjistruar për gjykim çështja civile nr. 2759, që i përket palës paditëse Ymer Lushakaj, me objekt: Prishjen dhe likuidimin e shoqërisë "Dyrrahu Konstruksion".

Në gjykim rezultoi e provuar, se:

Paditësi Ymer Lushakaj është ortak me 33% të kuotave në shoqërinë tregtare "Dyrrahu Konstruksion" sh.p.k., fakt që provohet me ekstraktin e QKB-së, si dhe me aktet e tjera të shoqërisë, të depozituara sipas ligjit në QKB. I padituri, shoqëria "Fidens Project Finance", është ortaku tjetër me 66%, një shoqëri e huaj me seli në San Marino. Paditësi, Ymer Lushakaj, prej disa vitesh ka humbur kontaktet me ortakun tjetër edhe me vetë administratorin e shoqërisë "Dyrrahu Konstruksion", të cilët kanë braktisur shoqërinë. Paditësi, edhe sipas ekstraktit historik të QKB-së, nuk është interesuar për mbarëvajtjen e shoqërisë, sepse pozita si ortak me 33% e ka vendosur në pozitën e pamundësisë së marrjes së veprimeve konkrete ligjore. Për këtë interes dhe për shkak të humbjes së kontakteve me palën e paditur, paditësi ka investuar një avokat të huaj, për të kërkuar të dhënat e njoftuara në Regjistrin Italian të Biznesit dhe nuk janë gjetur të dhëna në këtë regjistër, por avokati i huaj, ka gjetur të dhëna në San Marino për shoqërinë "Fidens Project Finance", e cila është

gjetur e falimentuar dhe e çregjistruar në vitin 2014, pasi kishte dhënë një hua prej 2.5 milionë eurosh.

Në këto rrethana, paditësi ka kërkuar të aplikojë në QKB, sipas statutit të shoqërisë dhe ligjit nr. 110/2016/2008, të ndryshuar, me qëllim zëvendësimin e administratorit, për të proceduar me shoqërinë. Ky fakt provohet me përgjigjen e QKB-së, sipas së cilës:

Asnjë veprim nuk mund të kryhet në regjistrin tregtar pa u përmbushur dy detyrimet, që janë konstatuar si kundërvajtje administrative:

1. Mosdorëzim i pasqyrave financiare për vitet 2013, 2014;

2. Mosdorëzim i statutit të ri të shoqërisë, sipas ndryshimeve ligjore.

Në këto kushte, paditësi i është drejtuar Gjykatës, me këtë kërkesëpadi, duke u mbështetur në analizën ligjore, si vijon:

1. Braktisja, largimi, humbja e kontakteve midis ortakëve, provon faktin se kjo ortakëri nuk mund të ekzistojë më;

2. Dhe si e tillë apo për rrjedhojë logjike dhe ligjore as shoqëria "Dyrrahu Konstruksion" sh.p.k. nuk mund të ekzistojë.

Pretendimet e Drejtorisë së Tatimeve Durrës janë, si më poshtë vijon:

Në përputhje me parashikimet e nenit 86, të ligjit nr. 110/2016, "Për falimentimin", konform parashikimeve ligjore të nenit 38, germa "d", administrata tatimore konsiderohet si kreditor i preferuar në këtë procedurë falimenti.

Neni 38

Kreditorët e preferuar

Janë kreditorë të preferuar ata që paraqesin pretendimet e mëposhtme:

a) pretendimet, që rrjedhin nga ndërprerja e kontratës së punësimit deri në 3 muaj përpara paraqitjes së kërkesës për falimentim, duke përfshirë pagën dhe rimbursimet shëndetësore, pagesat e lejes së lindjes, të cilat nuk kalojnë shumën 500 mijë lekë në total për çdo kreditor;

b) pretendimet për shpenzimet e jetesës, që lindin përpara fillimit të procedurës së falimentimit, kur debitori është një person fizik;

c) pretendimet e punonjësve të debitorit për dëme ndaj shëndetit, të shkaktuara gjatë punës;

ç) pretendimet për shpërblimin e dëmit ndaj jetës ose shëndetit, të shkaktuar nga veprimet e padrejta të debitorit përpara fillimit të procedurës së falimentimit;

d) pretendimet për detyrimet e lindura nga taksat dhe tatimet një vit përpara paraqitjes së kërkesës për fillimin e procedurës së falimentimit.

Shoqëria "Dyrrahu Konstruksion", NIPT K72215501C, person juridik, rezulton i regjistruar në organin tatimor, me objekt veprimtarie "Ndërtime civile dhe industriale, vepra arti, administrim baresh financim nëpërmjet dorëzanisë etj.", rezulton debitor ndaj organit tatimor, ku referuar të dhënave të administratës tatimore, pasqyruar në detyrimet në kohë reale, kapin vlerën 1.111.371 lekë, vetëm detyrimet e kontabilizuara, pa llogaritur këtu, deklaratat e padorëzuara të shoqërisë, të cilat, siç janë konstatuar nga vetë Gjykata, në procesin paraprak të përmbushjeve të kritereve ligjore për çeljen e procedurës, rezultojnë disa prej tyre ende të padorëzuara.

Për këtë arsye, i kërkojmë trupit gjykues të ngarkojë administratorin e falimentit, për marrjen e masave për deklarimin e këtyre deklaratave tatimore, të padorëzuara nga ana e tatimpaguesit. Gjithashtu, kërkojmë që nga ana e administratorit të falimentit të caktuar nga ana e Gjykatës, të behet verifikimi i aseteve totale të tatimpaguesit, si atyre materiale dhe atyre jomateriale, të kontaktohet me Agjencinë e Mbikëqyrjes Financiare (AMF) për të verifikuar, nëse në emër të këtij tatimpaguesi rezultojnë kredi apo dorëzani të regjistruara, sikundër dhe të kontaktohet me ASHK-në për të verifikuar ekzistencën ose jo të pasurive të paluajtshme, si dhe të hartohet plani mbi shlyerjen e detyrimeve tatimore që ky tatimpagues ka ndaj administratës tatimore.

II. Referuar nenit 64, të ligjit nr. 110/2016, "Për falimentimin", konstatojmë se legjislatori ka përcaktuar ekzistencën e përgjegjësisë së pakufizuar të ortakëve, mbi detyrimet që shoqëria e zotëruar prej tyre ka ndaj kreditorëve të mundshëm. Bazuar në këtë parashikim ligjor, i kërkojmë trupit gjykues të ngarkohet administratori i falimentit me verifikimin e shkaqeve që kanë çuar në ekzistencën e paaftësisë paguese të kësaj shoqërie, si dhe akumulimit të detyrimeve që ajo ka, si dhe përfshirjen e tyre në planin e shlyerjes së detyrimeve, si pasojë e zhvillimit të procedurës së falimentit.

Neni 64

Përgjegjësia e pakufizuar e ortakëve

1. Nëse procedura e falimentimit fillon për pasurinë në pronësi të një shoqërie të thjeshtë ose një shoqërie me përgjegjësi të pakufizuara, administratori i falimentimit ose administratori mbikëqyrës mund të pretendojnë përgjegjësinë personale të ortakëve ndaj detyrimeve të kompanisë gjatë procesit të falimentimit.

2. Padia paraqitet në gjykatën e falimentimit dhe çdo pasuri ose mjet monetar i marrë nga gjykimi i saj do të jetë pjesë e masës së falimentimit.

Në të njëjtën frymë dhe neni 10, pika 2, të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ka parashikuar, se themeluesit e një shoqërie tregtare, përgjigjen ndaj shoqërisë personalisht dhe në mënyrë solidare, për dëmet e shkaktuara nga mospërmbushja e detyrimeve ligjore apo detyrimeve ndaj palëve të treta, apo nga përmbushja e këtyre detyrimeve përtej afateve përkatëse.

Neni 10

Përgjegjësia e themeluesve

1. Personat që veprojnë në emër të shoqërisë, përpara se kjo të fitojë personalitetin juridik përgjigjen personalisht në mënyrë të pakufizuar e solidare për veprimet e kryera në emër të saj. Me fitimin e personalitetit juridik, të drejtat e detyrimet që rrjedhin nga këto veprime i kalojnë shoqërisë.

2. Themeluesit japin kontributet e tyre në shoqëri, në para ose në natyrë, sipas mënyrave e afateve, të parashikuara në statut dhe kryejnë formalitetet e themelimit, sipas kërkesave të këtij ligji dhe të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", themeluesit përgjigjen ndaj shoqërisë personalisht e në mënyrë solidare për dëmet e shkaktuara nga mospërmbushja e këtyre detyrimeve apo nga përmbushja e tyre përtej afateve përkatëse.

3. Përfaqësuesi ligjor i shoqërisë mund të ngrejë padi në gjykatën përkatëse për dëmin e shkaktuar nga mospërmbushjet e detyrimeve, sipas pikës 2 të këtij neni. Në rast mosveprimi të përfaqësuesit ligjor, brenda 90 ditëve nga marrja dijeni e mospërmbushjes, padia mund të ngrihet përkatësisht nga një ortak i shoqërisë kolektive ose komandite, nga një numër ortakësh të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuara apo aksionarësh të një shoqërie aksionare, të cilët zotërojnë jo më pak se 5 për qind të tërësisë së votave në asamblenë e shoqërisë. Padia mund të ngrihet, gjithashtu, nga çdo kreditor i shoqërisë tregtare. Ortakët, aksionarët ose kreditorët duhet të respektojnë procedurat e neneve 91, 92, 150 e 151 të këtij ligji. Paditë duhet të ngrihen brenda 3 vjetëve pas regjistrimit të shoqërisë tregtare.

Në rastin objekt shqyrtimi na rezulton se shoqëria "Dyrrahu Konstruksion", NIPT K72215501C, sipas detyrimeve në kohë reale të datës 7.11.2022, ka detyrime në shumën 1.111.371 lekë, vetëm detyrimet e kontabilizuara, sikundër dhe 26 deklarata të padorëzuara, të cilat jo vetëm që janë detyrim ligjor për t'u deklaruar, por në momentin e dorëzimit të tyre *online* do të prodhojnë penalitetet përkatëse. Për të provuar interesin tonë të ligjshëm mbi këto detyrime dhe në përmbushje të parashikimeve ligjore, bashkëngjitur po i vënë në dispozicion trupit gjykues detyrimet në kohë reale tek tatimpaguesit, datë 7.11.2022, si dhe detyrimet analitike, zë për zë, sipas llojit të tyre dhe datës së kontabilizimit të tyre në sistemin tatimor, me qëllim që të provojmë ligjshmërinë e kërkimit tonë mbi shlyerjen e detyrimeve të kontabilizuara te tatimpaguesit.

Të gjithë këta tregues na japin informacionin e mjaftueshëm se kjo shoqëri, në mënyrë që të përmbyllë procesin e falimentit, ka detyrim të shlyejë më parë detyrimet ndaj administratës tatimore, pasi mospërmbushja e këtij detyrimi, jo vetëm që pengon çregjistrimin nga organet shtetërore, referuar këtu nenit 45, pikat 3.4 dhe 3.5, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Neni 45

Çregjistrimi i subjekteve/tatimpaguesve

3.4 Qendra Kombëtare e Biznesit nuk mund të kryejë çregjistrimin e subjektit, në qoftë se në situatën e tatimpaguesit në kohë reale rezultojnë detyrime tatimore të papaguara të tatimpaguesit dhe deklarata tatimore të padorëzuara, si dhe në rast se ai nuk ka paraqitur pasqyrat financiare të mbylljes së aktivitetit deri në momentin e mbylljes. Në raste të veçanta, kur deklaratat apo pasqyrat financiare nuk janë dorëzuar nga subjektet, komunikimi ndërmjet organit tatimor dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit mund të bëhet me postë elektronike (e-mail) ose dhe me shkresë zyrtare.

3.5 Nëse në situatën në kohë reale të tatimpaguesit / subjektit nuk ka detyrime tatimore të papaguara, si dhe deklarata të padorëzuara, Qendra Kombëtare e Biznesit kryen menjëherë çregjistrimin e tatimpaguesit, duke njoftuar

menjëherë në rrugë elektronike administratën tatimore për datën e çregjistrimit të tij.

Në këto kushte i kërkojmë Gjykatës se Rrethit Gjyqësor Durrës të marrë në konsideratë pretendimet e paraqitura më lart prej nesh, me qëllim përmbylljen sa më të shpejtë dhe në përputhje me parashikimet ligjore të procedurës së falimentit.

Pasi analizoi në tërësi çështjen civile, pretendimet e ngritura në kërkesëpadinë për gjykim, aktet shkresore të paraqitura nga paditësi me cilësinë e provës dhe të administruara gjatë gjykimit dhe pasi u njoh me rezultatet e aktit të ekspertimit, gjykata vlerëson, se në këtë fazë duhet të hapen procedurat për falimentimin e shoqërisë "Dyrrahu Konstruksion", për këto arsye:

Në analizimin e çështjes gjykata ka parasysh ligjin nr. 9901/2008, të ndryshuar, i cili përcakton në nenin 3/1, si vijon:

1. Shoqëritë tregtare themelohen nga dy ose më shumë persona fizikë dhe/ose juridikë, që bien dakord për arritjen e objektivave ekonomikë të përbashkët, duke dhënë kontribute në shoqëri, sipas përcaktimeve në statutin e saj. Shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara dhe shoqëritë aksionare mund të themelohen edhe vetëm nga një person fizik dhe/ose juridik (shoqëritë me ortak apo aksionar të vetëm).

2. Neni 99, i ligjit nr. 9901/2008 përcakton:

Neni 99
Shkaqet e prishjes së shoqërisë

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuara prishet:

a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;

b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;

c) me hapjen e procedurave të falimentimit;

ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë, në përputhje me pikën 3, të nenit 43, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";

d) me vendim të gjykatës;

dh) për arsye të tjera të parashikuara në statut.

3. Neni 87/1 i këtij ligjit përcakton:

Neni 87
Marrja e vendimeve

1. Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në pikën 1, të nenit 86, të këtij ligji, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Çka do të thotë se kuorumi ka rëndësi të posaçme, sipas nenit 86 të këtij ligji, i cituar:

Neni 86
Kuorumi

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendose për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të këtij ligji, ajo mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3, të nenit 88, të këtij ligji.

Për sa më sipër, rruga e vetme për prishjen e ortakërisë dhe të shoqërisë mbetet rruga gjyqësore, sipas nenit 99, të ligjit nr. 9901/2008, të ndryshuar, i sipërcituar.

Në këto kushte, fakti rezulton i provuar, se:

1. Ortakëri me një shoqëri që nuk ekziston, nuk mund të ketë.

2. Me prishjen e ortakërisë del logjike, se nuk mund të vazhdojë as shoqëria "Dyrrahu Konstruksion" sh.p.k.

Pas depozitimit të kësaj kërkesëpadie, gjykata e falimentit, në referim të neneve 14 dhe 17, të ligjit nr. 110/2016, shqyrton përputhshmërinë e kërkesës me nenin 14 të këtij ligji, ku pas një rishikimi të përgjithshëm të dokumentacionit vërtetohet gjendja e paaftësisë paguese të debitorit.

Neni 14 i ligjit të sipërcituar parashikon, se:

"1. Kërkesa e debitorit për hapjen e procedurës së falimentimit mbështetet në paaftësinë paguese ekzistuese të debitorit ose në paaftësinë paguese në një të ardhme të afërt. Së bashku me kërkesën, debitori paraqet edhe dokumentacionin dhe informacionin në vijim:

a) raportin e debitorit, ku përcaktohen shkaqet e paaftësisë paguese dhe analiza e tij për të ardhmen e biznesit,

b) ekstraktin historik të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit për debitorin;

c) bilancin dhe pasqyrat financiare për tre vjetët e fundit të aktivitetit të debitorit. Nëse debitori ka ushtruar veprimtari për një periudhë më të shkurtër kohe, për aq sa kjo periudhë është;

ç) listën e pronave të luajtshme dhe të paluajtshme, përfshirë:

i. vlerën e çdo pasurie në momentin e blerjes;

ii. vlerën aktuale të tregut, në rast se këto pasuri kanë qenë objekt i rivlerësimit;

iii. vendndodhjen e pasurive; dhe/ose

iv. të dhënat e regjistruara në regjistrat publikë, nëse këto pasuri janë objekt i ndonjë procedure ligjore; dhe

v. nëse ndonjë nga këto pasuri është vendosur si garanci ose është objekt i ndonjë barre dhe, nëse po, vlera e kredisë së siguruar;

d) listë të bilanceve aktuale të parave në gjendje dhe burimet e të ardhurave;

dh) listë të kreditorëve, të cilët janë persona fizikë, përfshirë emrat e tyre, adresat, vlerën dhe burimin e detyrimeve;

e) listë të kreditorëve që janë persona juridikë, përfshirë emrat e tyre, adresat, selitë, emrat e përfaqësuesve të tyre ligjorë, nëse është rasti, si dhe vlerat dhe burimin e detyrimeve;

ë) listë të debitorëve të debitorit, qoftë këta persona fizikë ose juridikë, përfshirë emrat e tyre, adresat, selitë, vlerat dhe burimin e kredisë;

f) listë të të gjitha procedurave ligjore ku debitori është palë, si paditës ose i paditur.

2. Dokumentet, sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të jenë origjinale, të nënshkruara dhe/ose të vulosura në çdo faqe dhe të shoqëruara nga një deklaratë, ku shprehet se përmbajtja e dokumenteve shoqëruese është e plotë dhe e saktë. Nëse ka arsye të bazuara se përmbajtja e dokumenteve nuk është e plotë ose e saktë, duhet të përcaktohet shprehimisht në tekstin e deklaratës.

3. Në rastin e një shoqërie të thjeshtë, ku anëtarët nuk janë individë, kërkesat e parashikuara në pikën 1 të këtij neni do të zbatohen për anëtarët e organeve drejtuese të saj.".

Neni 17 i ligjit të sipërcituar parashikon, se:

"Shqyrtimi i kërkesës së debitorit

1. Nëse debitori paraqet kërkesë për fillimin e procedurës së falimentimit, gjykata e falimentimit shqyrton përputhshmërinë me kërkesat e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji. Në qoftë se, pas një rishikimi të përgjithshëm të dokumenteve, vërtetohet gjendja e paaftësisë paguese të debitorit, gjykata e falimentimit deklaron fillimin e procedurës brenda 5 ditëve, në përputhje me nenin 29 të këtij ligji. Nëse nuk vërtetohet gjendja e paaftësisë paguese, gjykata e falimentimit refuzon kërkesën.

2. Nëse dokumentet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji nuk janë të plota, debitori i plotëson ato brenda 5 ditëve. Nëse brenda kësaj periudhe debitori nuk plotëson kërkesën, atëherë kërkesa i kthehet e pashqyrtuar.".

Për të verifikuar aftësinë paguese të shoqërisë "Dyrrahu Konstruksion", gjykata mori provën me ekspert, në bazë të nenit 224/a të K. Pr. Civile, ekspertin kontabël Saimir Zalla, të cilit iu dhanë këto detyra nga gjykata:

1. Të verifikohet situata e kësaj shoqërie në marrëdhënie me shtetin, detyrimet që ka paguar dhe të papaguara, sa është vlera e detyrimeve të papaguara dhe kur kanë lindur ato

2. Të verifikohet situata e deklaratave të padorëzuara në tatime.

3. Të verifikohet nëse ka pasqyra financiare të dorëzuara për shoqërinë dhe kur është dorëzuar pasqyra financiare e fundit.

Sipas aktit të ekspertimit ka rezultuar, se: Organi tatimor ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 7266/1, datë 10.10.2022, ku cilësohet që detyrimet e subjektit më datë 10.10.2022 janë 1.108.973 lekë.

Në bazë të shkresës që organi tatimor ka kthyer përgjigje rezulton që subjekti ka të padorëzuar në organin tatimor:

1. Gjashtë deklarata të kontributeve shoqërore që i përkasin periudhës 03–08 të vitit 2014.

2. Gjashtë deklarata të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësoret që i përkasin periudhës 03–08 të vitit 2014.

3. Gjashtë deklarata të tatimit mbi të ardhurat nga punësimi që i përkasin periudhës 03–08 të vitit 2014.

4. Dy deklarata të tatimit mbi fitimin që u përkasin viteve 2013 dhe 2014.

5. Gjashtë deklarata të tatimit mbi vlerën e shtuar që i përkasin periudhës 03–08 të vitit 2014.

Në bazë të shkresës që organi tatimor ka kthyer përgjigje rezulton që subjekti ka dorëzuar bilance për periudhën 2007–2012, pra bilanci i fundit i dorëzuar është ai i vitit 2012.

Në këto pasqyra financiare, për vitet 2007–2012, te pasqyra e të ardhurave dhe e shpenzimeve nuk ka të shënuar asnjë shifër, gjë që nënkupton që kjo shoqëri për këtë periudhë nuk ka ushtruar veprimtari tregtare.

Aktivi i pasqyrave financiare rezulton vetëm me zërin parapagime, shpenzime të shtyra dhe të gjithë zërat e tjerë që mundësojnë likuiditetin e shoqërisë janë **zero lek,** për të gjithë periudhën 2007–2012.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata, bazuar në nenet 126 dhe 306 e vijuese të K. Pr. Civile e në nenet 14, 17, të ligjit 110/2016, "Për falimentimin", dhe në nenin 99 të ligjit nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar,

VENDOSI:

Hapjen sot, më datë 20.10.2022, të procedurës së falimentimit ndaj shoqërisë "Dyrrahu Konstruksion" sh.p.k., NIPT L72215501C, me administrator të shoqërisë, Aristide Benedetto.

Caktimin si administrator të falimentimit për shoqërinë "Dyrrahu Konstruksion" sh.p.k., znj. Arjeta Çumani, me adresë: lagjja "1 Maji", rruga "Skënder Muska", Fier, me nr. telefoni: 0692092483.

Në bazë të neneve 27, 141, të ligjit nr. 110/2016, "Për falimentimin", kreditorët e tjerë, që do të vihen në dijeni të këtij vendimi, duhet t'i paraqesin administratorit të falimentimit, pretendimet e tyre, brenda datës 8.11.2022. Njoftohen të gjithë personat që kanë detyrime ndaj shoqërisë "Dyrrahu Konstruksion" sh.p.k. që t'ia paguajnë dhe t'ia shlyejnë këto detyrime administratorit të falimentimit. Në bazë të nenit 28, të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002, "Për falimentimin", mbledhja e kreditorëve të shoqërisë "Dyrrahu Konstruksion" sh.p.k. për raportim do të zhvillohet në datën 19.12.2022.

Në bazë të nenit 28, të ligjit nr. 110/2016, "Për falimentimin", ngarkohet administratori i falimentimit, që brenda datës 19.12.2022 të paraqesë në gjykatë një raport analize në lidhje me veprimtarinë e shoqërisë "Dyrrahu Konstruksion" sh.p.k., për sa i përket mundësisë së vazhdimit të mëtejshëm të procedurës së falimentimit ndaj kësaj shoqërie.

Në bazë të nenit 28, të ligjit nr. 110/2016, "Për falimentimin", mbledhja e kreditorëve të shoqërisë për verifikim do të zhvillohet në datën 19.12.2022. Në bazë të ligjit nr. 110/2016, "Për falimentimin", referuar përcaktimeve të VKM-së nr. 197, datë 14.4.2007, administratori i falimentimit do të shpërblehet më masën fikse prej 50 mijë lekësh në muaj, e cila do të përballohet nga masa e falimentimit.

Në bazë të nenit 29, të ligjit nr. 110/2016, "Për falimentimin", vendimi i gjykatës, me anë të të cilit u vendos hapja e procedurave të falimentimit ndaj shoqërisë "Dyrrahu Konstruksion" sh.p.k., do të shpallet publikisht në këndin e njoftimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe në Fletoren Zyrtare.

Kundër këtij vendimi të ndërmjetëm të gjykatës mund të bëhet ankim i veçantë, brenda 5 ditëve nga e nesërmja e shpalljes së tij në Gjykatën e Apelit Durrës.

U shpall në Durrës, sot, më datë 20.10.2022.

GJYQTARE
Shpëtime Pitaku

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 642 (3965), datë 7.10.2022, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetases Valbona Tofik Jaliq, e lindur më 11.7.1971, në Shkodër, dhe banuese në Shkodër, si dhe vendosjen e saj nën kujdestarinë e shtetasit Shpëtim Ramo Dekovi.

KËRKESË

Shtetasi Gjovalin Mark Prendi kërkon, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, shpalljen e zhdukjes së shtetasit Sokol Mark Prendi, i datëlindjes 28.6.1970.

KËRKUES
Mark Prendi

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2022 - Numri: 170
Datë: 2022/12/20 15:45:08
023bb6b5-1bd6-42ca-8434-5ac70de23ba0

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 288 lekë